

Ali Pajaziti

Ali Pajaziti

LOGOS-A ■ ESE SOCIOLOGJIKE



Ese sociologjike



Copyrighted material



© LOGOS - A
2 0 0 3



S H K U P
PRISHTINE
TIRANE



mr. Ali Pajaziti



Ese sociologjike



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për qëllime personale dhe jo komerciale.
Kjo rikopimim mund të bëhet përmes rrjetit nëse nuk ka për qëllim të
kallëzimit në tregun e përgjithshëm. Por, nuk lejohet riprodhimi,
transmetimi ose kopjimi i këtij libri në format pa leje pa përjashtim të logonit.

mr. Ali Pajaziti



Ese sociologjike

mr. Ali Pajzeli
ESE SOCIOLOGJIKE

Batën, Logos-A

Për botuesin: **Adnan Ismaili**
Kryeredaktor: **Rusamedin Abazi**

Retemendi:
dr. **Etem Aziri**, dr. **Hasan Jashari**

Redaktor gjëhënor: dr. **Xhevat Uroshi**
Redaktor artistik & dizajni: **Edi Agajçishi**
Redaktor teknik & faqesë: **Azem Zaimi**

Mbikëqyrës i shtypit: **Imar Geguli**
Përgatitja kompjuterike: **Focus Pro - Shkup**
Shtypi: **Focus - Prishtinë**

Copyright © Logos-A, 2008

Shënim i CIP katalogut i këtij libri gjendet
në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare
ISBN 9989-58-049-9

www.logos-a.com



ALI PAJAZITI
ESE SOCIOLOGJIKE
Logos-A
Shkup, 2002

**Recensentë: Dr. Etem AZIRI Dr. Hasan
JASHARI**

Redaktura gjuhësore: Xhevat LLOSHI

ISBN 9989-58-049-9



Përmbajtja:

Përmbajtja:.....	3
Parathënie.....	6
Tranzicioni, demokracia dhe mediat nga fokusi i sociologjisë së politikës.....	12
Politika dhe morali.....	13
Mijëvjeçari i ri dhe realiteti shoqëror në vendin tonë.....	14
Mediat dhe zgjedhjet.....	16
Politika dhe vetëshkatërimi si fat i Homo Balkanicus-it.....	19
Shteti nacional – sfidë e modernitetit.....	20
Afërsi gjeografike, largësi njohjeje.....	23
Mijëvjeçari i ri dhe perspektiva jonë.....	25
Monizmi si “tejtë akiliane”.....	28
Maqedonia si unitas multiplex.....	29
Panta rei.....	30
Kondicionali si shkas.....	32
Nga konvencionaliteti në spontanitet.....	34
Socioeksegjeza e elitës intelektuale.....	41
Intelekti në shërbim të ideologjisë.....	42
Tranzicioni shoqëror dhe mendimtari i lirë.....	44
Mijëvjeçari apokaliptik.....	48
Kohezioni brendakombëtar si domosdoshmëri.....	52
Globalizmi.....	57
Skicë e pikëpamjeve planetariste-globaliste.....	59
Globalizmi - imperializëm pasmodern?!.....	61
Përfundim.....	64
Preambuliada.....	66
Feja në fokus.....	71
Rex publica, kultura dhe morali.....	80

(De)nacionalizimi i shoqërisë dhe paqja	84
Fenomenologjia e bashkëjetesës	88
Guerrizmi si patologji sociale.....	93
Anomalia e mosleximit, energjia pozitive dhe sikelizimi i mediave	97
Dialogu mes qytetërimeve	103
Harry Potter: libri i shfryrjes së fantazisë.....	107
Tranzicioni i dytë: më tutje si?	112
Tragjedia dhe intelektual i mirëfilltë	116
Bota bashkëkohore në udhëkryq.....	121
Dihotomia progresi(vizmi)-regresi(vizmi) ose modernizmi <i>versus</i> tradita.....	122
Nga soteriologjia shekullariste në epokën e krizologjisë pasmoderne	124
Përfundim	129
Misioni i universitetit <i>versus</i> përplasjeve të “elitës së miletit”	132
Sarajeva, atje ku dikur ka qenë?.....	138
Sociologjia e sportit	143
Sporti, neopaganizëm ose kuazireligjion!.....	144
Sporti i ekonomizuar	145
Sporti dhe dhuna	147
Sporti dhe nacionalizmi	148
Përfundim.....	149
E shenjtja dhe profania në opusin sociologjik të Durkheimit	151
Elita, elitizmi dhe shoqëria.....	157
Elita në shoqërinë tradicionale dhe në atë moderne	158
Lidhja organike në marrëdhënien elita-masa.....	160
Elitizmi i shndërruar në vetëvrasje kombëtare.....	162
Bibliografia	164

Parathënie

Libri *Ese sociologjike* i Ali Pajazitit paraqet një ndimesë të shquar nga lëmi i sociologjisë. Edhe pse në shikim të parë fitohet përshtypja se ky libër ngërthen tematika të ndryshme, që kanë të bëjnë me rrjedhat shoqërore aktuale në Maqedoni, shqyrtimi më i thelluar i lëndës së zbërthyer na jep të drejtë të vëmë në dukje, se në fakt bëhet fjalë për një tërësi mjaft homogjene, në të cilën sipas një kronologjie logjike autori bën ndriçimin e shumë dukurive shoqërore, që e shqetësojnë qenien shqiptare, si dhe ofrohen alternativa për tejkalimin e asaj, që e shikuar sipërfaqësisht, duket e patejkalueshme, me të vetmin qëllim që popullata shqiptare e Maqedonisë, ndaj së cilës dhjetëvjeçarë me radhë historia është sjellë më tepër si 'njerjë' sesa si 'nënë', ta gjejë vendin e vet në hapësirat demokratike evropiane e më gjerë.

Tekstet e paraqitura në këtë libër, të botuara më parë në *Lobi*, *Jehona*, *Fakti* dhe *Flaka*, analizojnë kryekëput dukuri shoqërore, të cilat kanë të bëjnë me periudhën e tranzicionit. Megjithatë, autori, duke u përpjekur që qëndrimet e tij të jenë sa më të argumentuara, kthehet herë pas here dhjetëvjeçarë më pas, por gjithmonë duke e pasur të qartë se sa më shumë merremi me të kaluarën, aq më të vogla janë gjasat për një ardhmëri më të sigurt. Me fjalë të tjera, Pajaziti ndodhitë e së kaluarës më të afërt ose më të largët i përmend jo aq për të ndërtuar mbi bazën e tyre ardhmërinë, por më tepër si dukuri shoqërore,

të cilat kanë dhënë ndihmesë në masë të madhe që të ndodhte e sotmja.

Tekstet e përfshira në veprën *Ese sociologjike* mund të ndahen në tre grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë tekstet me karakter të shprehur teorik shkencor nga lëmenjtë e shkencave humanitare, e sidomos nga sociologjia. Në grupin e dytë bëjnë pjesë tekstet nga përditshmëria shoqërore, shpesh të bazuara në mendimet e teoricienëve me emër botëror, ndërsa në grupin e tretë tekstet me karakter politik aktual.

Pajaziti në librin në fjalë përshkruan zëvendësimin e sistemit monist me atë pluralist shumëpartiak, i cili ndërmyet shqiptarëve të Maqedonisë zgjoi shpresa, se sipas një logjike shumë të shpejtë, do të krijohej një hapësirë manovrimi racionale, karakteristike për të gjitha shoqëritë që synojnë drejt demokracisë. Megjithatë, të gjitha analizat flasin se në Maqedoni qysh në start pluralizmi partiak u keqkuptua, ndërsa ajo që u pagëzua si 'demokraci e porsalindur', u dhunua nga ata që gjoja e lindën, dhe u shndërrua në lavire, së cilës tashmë prej një dhjetëvjeçari e më shumë, faktori i jashtëm po mundohet me ndërhyrje kirurgjike t'ia kthejë 'virgjërinë e humbur' dhe, po të gjendej mundësia, ta martojë si vajzë beqare.

Edhe pse në procesin e dhunimit kolektiv të demokracisë në Maqedoni morën pjesë në këtë ose në atë mënyrë pothuajse të gjitha subjektet politike, si përfaqësues të kolektiviteteve nacionale, do të kishte qenë e padrejtë të ndahej përgjegjësia në mënyrë drejtvizore, për vetë faktin se ata e ushtruan dhunimin nga pozita e pozicione të ndryshme. Ndërsa shqiptarët pluralizmin politik e partiak e kuptuan si perspektivë të përgjithshme ose për të gjithë, si luftë të ideve e mendimeve për një të ardhme më të sigurt e më të lumtur, bashkëvendësit e tyre maqedonas dukurinë e pluralizmit e kuptuan si vazhdim të

njëmendësisë në kushte e rrethana të reja, me pritje për institucionalizimin e marrëdhënieve, të cilat në emër të demokracisë një të tretën e popullsisë së Maqedonisë, që gjendet në trojet e veta etnike, t'i shndërronin në qytetarë të dorës së dytë dhe perspektiva e tyre të varej nga vullneti i mirë i pjesës tjetër të popullsisë me prejardhje etnike maqedonase, e cila e shpalli veten bartëse të sovranitetit shtetëror përmes aktit më të lartë juridik, që e solli me mbivotim, duke mos e përfillur votën e lirë dhe vullnetin e popullatës shqiptare në Maqedoni. Për fat të keq, e gjithë kjo ndodhte para syve dhe me ndihmën e inteligjencies, e cila duke mos qenë e vetëdijshme për rolin e saj në shoqëri, me inferioritetin që tregonte i ndihmonte ato procese, të cilat këtë vend ballkanik e orientonin drejt 'qorrsokakut'.

Nuk është e rastit që Pajaziti në këtë vepër një hapësirë të gjerë e ka rezervuar për personalitetin e intelektualit, e në veçanti të intelektualit shqiptar. Janë të qëndrueshme dyshimet e tij ndaj një kategorie të inteligjencies, e cila në periudhën e monizmit ka luajtur rolin e 'rojtarit besnik' të sistemit ekzistues dhe që nuk paraqiste kurrfarë force lëvizëse të marrëdhënieve shoqërore. Me të drejtë ai parashtron pyetjen për moralitetin e asaj inteligjencieje, e cila deri deri dje i mbronte me këmbëngulje vlerat e një sistemi dhe sot paraqitet si kritikuese e ashpër pikërisht e diçkaje, që vite më parë e mbronte fuqimisht. Është e logjikshme të parashtrohet pyetja: kur e thoshin të vërtetën ata 'intelektualë', atëherë apo sot? Megjithatë Pajaziti shpreh optimizëm për lindjen e një inteligjencieje të lirë, kritike, të çliruar nga bagazhi i së kaluarës, nga të gjitha llojet e komplekseve, që do të ishte bartëse e lëvizjeve shoqërore. Kur flet për inteligjencien, autori me keqardhje konstaton: "Ç'fatkeqësi që në kohën kur jemi duke përjetuar tranzicionin social, nuk

shohim xixat e një inteligjencieje të mirëfilltë, e cila krijon e shkruan duke ndjekur prirjet botërore, që gjërat i interpreton në përputhshmëri me premisat shkencore, madje që kohë pas kohe e befason opinionin me zbulime e inovacione nga fusha të ndryshme”. Sipas tij, dijetari i ndritur nuk është oportunist, nuk ka nevojë të kërkojë shenjtërim e bekim nga ‘gladiatorët e arenës politike’. Shumë dhjetëvjeçarë më parë Sen Simoni, ithtar i elitës së dijes, shkruante: “Mbijetesa e kombit francez nuk varet nëse do t’i humbë apo jo përfaqësuesit e shtëpisë mbretërore, fisnikët e ndryshëm, ministrat, këshilltarët, gjeneralët, klerikët më të lartë, gjykatësit, prefektët dhe njerëzit e tjerë të njohur. Edhe pse humbja e tridhjetë mijë personave, për të cilët mendohet se ishin më të rëndësishmit në shtet, francezëve do t’u kushtonte dhimbje të madhe, kjo nuk do të ishte gjymtim për shtetin, për shkakun se vendet e zbrazëta do të plotësoheshin lehtë, një numër i madh francezësh do të mësonte t’i kryente punët që i kanë kryer ata. Tragjike do të kishte qenë po qe se në ndonjë rast fatkeq Franca do të humbte pesëdhjetë fizikanët e saj më të mirë, kimistët, poetët, skulptorët, muzikantët, letrarët, mekanikët, mjekët, farmacistët, arkitektët, inxhinierët e degëve të ndryshme dhe shumë profesionistë të tjerë. Në atë rast Francën do ta mbulonte zia. Ajo do të mbetej si trupi i pashpirt, derisa t’i rritej sërish koka”. Pra, intelegjencia nuk është diçka që krijohet aty për aty; ajo lind dhe kultivohet brenda shekujve. I mjerë është ai popull që e nënçmon intelegjencinë e vet, por e mjerë është edhe ajo intelegjenci që nuk është në shërbim të popullit të saj.

Ali Pajaziti është ndër të rrallët që në shkrimet e veta erdhi në konstatim se diferencimi socio-ekonomik në baza etnike solli deri te trazirat e njëpasnjëshme brenda kësaj shoqërie dhe kulminoi me një konflikt të armatosur.

Domethënë, situatën konfliktuoze dhjetëvjeçare e analizon edhe për nga aspekti i dallimeve mjaft të shprehura sociale dhe ekonomike që ekzistojnë në mes dy etniteteve më të mëdhaja në Maqedoni. Qasja e këtillë e dëshmon pjekurinë e autorit i cili qartë vë në pah se popullata shqiptare në Maqedoni nuk është bartëse e kapitalit dhe ajo nuk posedon ndonjë pasuri të veçantë, ashtu siç duan t'i tregojnë gjërat autorët e ndryshëm maqedonas dhe ndoshta siç ëndërrojnë shqiptarët. Popujt që ekzistencën e vet e sigurojnë nga kurbeti nuk mund në bazë të asnjë parametri të mirëfilltë ekonomik të llogariten popuj të pasur.

Gati në çdo tekst autori i ka parasysh rrjedhat globale shoqërore. Me një racionalizëm modest angazhohet në drejtim të gjetjes së një hapësire për shqiptarët në familjen e madhe evropiane. Tendencat e tija intelektuale janë mjaft transparente dhe racionale-shqiptarët e demokratizuar në Evropën demokratike. Prandaj, ai thotë “kusht është që shpirti racional të arrijë të dominojë mbi atë emocional. Nëse ndodh kjo, lehtë do të vërehen gabimet, do të merret mësim nga e kaluara dhe do të gjenet rrugëdalje nga ky labirint”.

Edhe pas kritikave që mund t'i bëhen librit të Pajazitit *Ese sociologjike*, që gjithsesi do të kishin qenë të mirëseardhura, ky libër i ka vlerat e veta teorike dhe si i tillë paraqet një kontribut për ndriçimin e shumë fenomeneve shoqërore të përditshmërisë sonë. Aq më shumë në qoftë se e kemi parasysh se jetojmë në këto kohëra pa kohë ku mjaft i vogël është numri i intelektualëve shqiptarë të cilët kanë guxim t'i shprehin qëndrimet e tyre në lidhje me fenomenet e ndryshme shoqërore që e frenojnë zhvillimin e mirëfilltë të etnitetit shqiptar në Maqedoni. Vlen të potencohet edhe ajo se autori në asnjë moment nuk i vë në pyetje vlerat dhe perspektivën e etniteteve tjera.

Qëndrimet e veta autori i shpreh me një origjinalitet që është karakteristike për njohësit e mirë të shkencave shoqërore.

Mbetemi me shpresë se lexuesit e librit *Ese sociologjike* në masë të madhe do t'i mbështesin konstatimet tona se tekstet e përfshira në të paraqesin një pasqyrë reale për zhvillimin shoqëror dhe nivelin e demokracisë në Maqedoni.

dr. Etem Aziri

Tranzicioni, demokracia dhe mediat nga fokusi i sociologjisë së politikës

*“Të rrallë janë njerëzit të cilët në vetvete i bashkojnë
epërsinë e pozitës dhe vlerat morale”.*

Aristoteli

Sot si gjithkund në botë, ashtu edhe në vendet që janë duke e përjetuar fenomenin shoqëror të quajtur *tranzicion*, po bëhen përpjekje për jetësimin e një dukurie të mistifikuar, madje të mitologjizuar, të quajtur demokraci, si një nga mjetet politike më të parapëlqyera nga shoqëritë politike (shtetet) bashkëkohore. Se sa probleme sjell kjo periudhë kalimtare (tranzicioni) si në psikologjinë e individëve ashtu edhe në marrëdhëniet individ-i-individi, individ-i-shteti, institucionet-qytetari, më së miri e ilustron panorama *sui generis* e vendeve anëtare të ish sistemit, që për bazë merrte materializmin dialektik-historik. Ligj i natyrës është se për t’u bërë një ndryshim rrënjësor në jetë, duhen përjetuar dhimbje e vuajtje të vogla ose të mëdha. Po është më keq kur dhimbjeve u shtohen edhe ato, për të cilat faktor është vetë njeriu ose qytetari, kur ai shkakton shkatërrimin, që për finale ka vetëshkatërrimin. Ç’të mirë u sollën vëllezërve tanë shqiptarë përtej kufirit trazirat e vitit ‘97, pos humbjes së besimit se për frymëmarrjen e lirshme të qytetarëve kujdeset shteti. Dyzetepesë vjet shteti enverist, nëse do të shpreheshim me

fjalorin hobbesian, ishte një kuçedër (*Leviathan*), kurse në (kuazi)demokraci në kuçedra u shndërruan pjesëtarët e piratëve e plaçkitësve, të cilët gjuajnë momentin për ta ndryshuar me zor statusin shoqëror, për t'u bërë bosë e për të kaluar nga një shtresë më e ulët shoqërore në atë më të lartën. Ç'dua të them me këtë? Dua të them se ashtu si në art është "e rrezikshme" parulla *l'art pour l'art*, edhe në jetën shoqërore është e rrezikshme parulla *démocratie pour démocratie*. Respektivisht, demokracia nuk duhet të mbetet vetëm fjalë e thatë në gjuhët e politikanëve, por edhe masat njerëzore nuk duhet të presin çudira të menjëhershme, sepse demokracia është mjet politik, i cili kërkon kohë për të dhënë rezultatet e duhura. *Demokracia nuk është alkimi, e cila me metoda misterioze mund të krijojë nga metali i rëndomtë flori*, nuk mundet qytetarët për një natë t'i bëjë qytarë të *Utopi-së së Morit* ose *Civitas Solis-it* të Kampanelës. Ajo nuk duhet absolutizuar, zaten jetojmë në periudhën e pasmodernizmit, kur sipas mendimit të shquar anglez Ernst Gellner "mbi të gjitha mbizotëron relativizmi" (*Relativismus über alles*). Përndryshe, nëse nga ky mjet politik priten kulla të fildishta dhe zgjidhje të përnjëhershme të problemeve - si pasoje e thyerjes së shpresave dhe iluzioneve - në vend të demokracisë sundon anarkia, nga e cila nuk kanë dobi as vetë ata që e krijojnë, edhe pse nuk janë të vetëdijsëm për këtë.

Politika dhe morali

Zgjedhjet vendore ose ato kuvendore (parlamentare) si një nga mjetet e realizimit të demokracisë, po i përjetojmë tashmë disa herë. Kjo do të thotë se nuk jemi të

papërvojë, respektivisht se nuk na falen gabimet e hapave të parë të “fëmijërisë demokratike.” Por ç’ë do që në këtë drejtim nuk mund të lavdërohem si kemi marrë mësim nga e kaluara, se kemi fituar një kulturë pluraliste dhe të drejtimit: *Respekto tjetrin pa marrë parasysh bindjet politike dhe weltanschauung-un e tij, dije se me atë duhet ta ndash ajrin dhe të mirat e tjera, që Zoti ia ndau njeriut për të mbijetuar në sipërfaqen e tokës.* Zemërngushtësia dhe dëshira për pushtet e famë të pamërituar janë vetëm disa nga tiparet e njeriut. Ato mund të shmangen vetëm me edukatë e moral të lartë. Prej këtui vihet në përfundimin, se politika si një nga gjashtë institucionet themelore të shoqërisë (feja, kultura, edukata, politika, ekonomia dhe koha e lirë) është e lidhur ngushtë me etikën e qytetarëve. Etika e morali duhet të zbkurojnë çdo pore të shoqërisë, nga bariu e deri te kryetari i shtetit, nga zyra e rëndomtë deri te salla ku mbahen konferencat e shtypit, nga biseda në rrugë ose odë katundi e deri te diskutimi në foltore të parlamentit etj. Pra, për t’u realizuar një kohezion shoqëror dhe për të funksionuar demokracia e mirëfilltë, duhet që të kemi qytetarë të edukuar, respektivisht të edukuar e të arsimuar. Por duhet ditur se vetëm arsimi ose përcjellja e të dhënave “pa mbjellje” të kodeve të moralit e etikës nuk mjafton.

Mijëvjeçari i ri dhe realiteti shoqëror në vendin tonë

Sadoqë në botë është e pranishme polemika se kur fillon mijëvjeçari i ri, në çastet e para të vitit 2000 ose 2001, ne, duke u bazuar në faktin se shumica mbrojnë

tezën e parë, mund të themi se zgjedhjet e 10 shtatorit janë të parat në mijëvjeçarin e ri. Mijëvjeçaristët (*millenarianists*) pretendojnë se në pragun e çdo mijëvjeçari duhet të ndodhin gjëra të mëdha, presin shpëtimtarin, i cili në çast do ta ndryshojë gjendjen. Shoqëritë e *cargo cult*-it (kultit të ardhjes së ngarkesave) nuk janë shoqëri të vetëdijshme, por ëndërrimtare. Antropologët sintagmën *cargo cult*, e përdorin për shoqëritë me bindje dhe pikëpamje të thjeshta, të cilat jetojnë duke pritur anijen, e cila do t'u sjellë atyre të gjitha të mirat materiale e shpirtërore dhe me këtë gjendja e tyre do të ndryshojë për 180 gradë.

Nga politikanët në mitingjet parazgjedhore qytetarët e Maqedonisë dëgjojnë shumë premtime, prej të cilave ca realizohen e ca mbeten vetëm në kujtesën e qytetarit të rëndomtë, ndërsa politikanët vazhdojnë të bëjnë politikë. Fjalët e politikanëve janë shndërruar në 'onomatope njerëzore', të cilën çdokush e dëgjon, por rrallëkush i beson. Sipas analizave të bëra, këto zgjedhje elektorati i pret me mosinteresim dhe pa oreks. Pse? Mos vallë mbaroi demokracia? Mos vallë qytetari është bezdisur nga sandëqet, motot dhe pllakatet që stolisin çdo qoshe të përditshmërisë së tij? Nëse populli tregon mosinteresim për to, a mund të ndodhë që t'i rrezikohet ardhmëria e katër viteve të ardhshme? Këto pyetje mbeten të hapura dhe kërkojnë përgjigje nga vetë politikanët, politologët, analistët, si dhe dijetarët e degëve të jera.

Për një vend si Maqedonia, i paprekur nga luftërat e viteve '90 në trojet e ish Jugosllavisë,^{*} satisfaksion mund të jetë vetëm shmangia e gjakderdhjes dhe luftës qytetare. Por ç'e do që etnocentrizmi dhe nacionalizmi, mostoleranca ndëretnike shpesh dalin në skenë dhe i tregojnë dhëmbët e tyre të vërtetë. Që ky shtet relativisht i vogël

* Ky artikull është botuar në *Fakti* më 11 shtator 2000.

të mund të mbijetojë, duhet kultivuar respekti ndëretnik dhe ndërkulturor midis etnive që jetojnë në këtë nënqiell. Pra, detyrim parësor i funksionarëve të sotëm dhe atyre të ardhshëm politikë duhet të jetë përdorimi i aftësive të veta në drejtim të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit politik, krijimit të kushteve për kalimin nga çalimi ekonomik në një stabilitet dhe prosperitet social, ku qytetari nuk do të vuajë nga psikoza e papunësisë, nga pamjaftueshmëria e pagës mujore, ku i riu nuk do të hutohet nga mjegullnaja e ardhmërisë që e pret, ku studenti nuk do të vuajë nga standardi minimal, ku fshatari nuk do ketë kockëçarje se ku do ta tregtojë produktin e tij bujqësor, ku intelektualit nuk do të mendojë si të sigurojë kafshatën e gojës, por të merret me punën e tij hulumtuese etj.

Mediat dhe zgjedhjet

Mendimtari i njohur italian Umberto Eco thotë, se rolin propagandistik që në Mesjetë (në shoqërinë tradicionale) e ka luajtur Kisha, në shtetin modern ose në bashkëkohësi e luajnë mediat. Me këtë ai ka dashur të thotë se Kisha ka qenë bartësja dhe paraqitësja e informacioneve, gjykuesja dhe ekzekutuesja e njerëzve. E sot mediat, përveç rolit bazor që duhet ta luajnë (informimi i njerëzve), më tepër merren me formimin e kulturës masive dhe, për fat të keq, me gjëra që nuk përputhen me kodin e gazetarisë dhe njerëzores.

Përmes mediave sot në botë është arritur të krijohet pothuajse një kulturë unike ose, thënë më mirë, uniforme. Sot për afërsisht njësoj vishet amerikani me kinezin, shqiptari me suedezin, kolumbiani me turkun (Levi's,

Batta, United Colors of Benetton) etj. Pijnë të njëjtën pije (Coca Cola, Pepsi) dhe hanë ushqim të gatshëm (Mac Donald's, Burger King). Sot shumë pak ose në detaje dallohen mënyra e rregullimit të një banese të Mançesterit nga ajo e Sarajevës, ajo e Sidnejit me atë të Prishtinës, nga ajo e Rio de Zhaneiros e Detroitit dhe Kajros. Sporti dhe muzika janë ndër temat kyçe të rinisë anekënd botës. Në realizimin e të gjitha këtyre rol të rëndësishëm luajnë edhe mjetet e komunikimit masiv. Pra, ekziston një marrëdhënie e mirëfilltë ndërmjet globalizmit dhe mediave.

Sot përveç gazetarisë së ndërgjegjshme, ekziston edhe ajo që merret me indoktrinimin e masave të njerëzve, me shtrembërimin e së vërtetës, me vënien në qarkullim të informatave bombastike të pabaza, me akuza dhe ndihmë montazheve gjyqësore për ekskomunikime e të tjera.

Kur vijmë te marrëdhënia politika-mediat, lirisht mund të thuhet se në shumë raste radioja, televizioni dhe shtypi do s'do janë në marrëdhënie të pashmangshme me politikën dhe politikanët. Mediat në mes tjerash përcaktohen edhe si *story-telling and myth-making apparatus*. Domethënë, ato përveç që rrëfejnë, në të njëjtën kohë krijojnë edhe mite të profileve të ndryshme, të shkencëtarëve, politikanëve, këngëtarëve, sportistëve... Pra, ato mund ta legjendarizojnë një politikan të caktuar, por nëse dora politike e kalon dozën e normales, mediat mund t'i kthehen edhe si bumerang. Rënia e shumë diktatorëve të famshëm në shoqëritë bashkëkohore në mes tjerash është edhe rezultat i veprimtarisë së mas mediave.

Politika si mjet i udhëheqjes dhe sundimit, së bashku me institucionet e tjera shoqërore duhet të luftojë për të siguruar mirëqenien e qytetarëve. Në këtë drejtim ajo përdor mjete të ndryshme, në mesin e të cilave bëjnë pjesë edhe mas mediat. Kjo është edhe normale, kur kemi parasysh se ata që e drejtojnë shtetin (politikanët) por

edhe gazetarët janë njerëz me ndjenja e emocione, domethënë mund të jenë anëtarë ose simpatizues të njërës parti politike ose tjetrës. Sociologu gjerman Hans Freyer thotë që, edhe pse sociologu bën vetëm përshkrimin e dukurive shoqërore, ai nuk mund që t'i ikë aspektit të vet subjektiv dhe në trajtimet e tij gjithmonë do të ketë gjëra që pasqyrojnë individualitetin e tij në tërësi, duke filluar nga prirjet politike, bindjet fetare, psikologjia e tij etj. Pra, edhe nga ata që punojnë nëpër mediat, qofshin ato elektronike qofshin ato të shtypit, nuk mund të presim objektivitet absolut, por mund të presim *përpyjekjen* dhe *mundin* e tyre për të arritur deri te një “shoqëri racionale”, ku do të mbizotërojë bonsensi, mirëkuptimi, ndërrrespekti, ku qëllim parësor do të jetë lumturia e qytetarëve pa shikuar në ngjyrat dhe bindjet e tyre kombëtare, fetare, politike, profesionale etj., ku në vend të parullës së famshme *Bellum omnium contra omnes* (çdokush kundër çdokujt), do të mbizotërojë parulla “Paqe për të gjithë”.

Politika dhe vetëshkatërrimi si fat i Homo Balkanicus-it

*“Thelbi i sovranitetit shtetëror nuk është në monopolin
e dhunës dhe sundimit, por në monopolin e zgjidhjes”*

Karl Schmidt¹

Jetojmë në një kohë të çmendurisë, të anomalive dhe traumave psikike-shpirtërore individuale, që madje disa herë marrin edhe ngjyrimë kolektive. Njeriu i kohëve moderne bëri shumë zhurmë e rrëmujë, derdhi tepër gjak për të shkruar një faqe të re të historisë, duke kujtuar gjithmonë atë të bardhën dhe rozën, por ç’do që realiteti s’qe i tillë. Mesjetës iu vu damka e errësirës, mediokritetit, shkatërrimit e rënies. Në nënvetëdijen e njerëzve u krijua paranoja e së djeshmes dhe iluzioni i së ardhmes. Shumë u punua që koha e re (moderniteti) të jetë parajsë, por u voll mjaft vrer në këtë epokë, e cila fillon me zbulimin e kontinentit të ri (Amerikës) ose me kalimin e Konstantinopojës së atëhershme në duart e turqve osmanë.

Njëri nga problemet që solli me vete epoka moderne është çështja e kombit, e shtetit nacional dhe e nacionalizmit. Lidhur me këtë problematikë sociologjike me reflektime shumëpërmasore për shoqërinë “është harxhuar shumë bojë”; me qëllime të shumëllojshme, është

¹ Karl Schmidt, *Politikna ideologija*, прев. Светлана и Димитар Гелеви, Култура, Shkup, 1993, f. 21.

trajtuar nga këndvështrime të ndryshme shkencore, filozofike, gazetareske etj. Është interesant fakti që në disa pjesë të botës, nacionalizmi dhe ideja e skajshme për shtetin nacional, të cilin e përfytyrojnë si Leviathan (kuçedër) për të ngrënë “tjetrin” ose për t’im eliminuar “ata”, janë një prirje e dukshme, edhe pse pandërprerë flitet për globaliz(i)min e botës, kosmopolitizmin, relativizimin e kufijve shtetërorë dhe shndërrimin e botës në një *fshat global*.

Shteti nacional – sfidë e modernitetit

Sipas Valter Bagehot-it, historia e shekullit XIX është koha e krijimit të kombeve (*nations*).² Kjo krijesë e re e epokës moderne në fillim u pranua dhe u përtyp si diçka ideale e shpëtimprurëse, që do t’i mënjanonte të gjitha padrejtësitë dhe vuajtjet e njerëzimit. Nacionalizmi dhe shteti kombëtar si pjellë e Perëndimit të periudhës pas Revolucionit Francez (1789), më vonë do të shndërrohej në një ide dhe ideal, që do të përfundonte te një përbindësh të quajtur fashizëm-nazizëm, i cili në emër të krijimit të shtetit nacional universal (me përmasa botërore), do të bënte kërdi të paparë e të panjohur në analet e historisë së shkruar. Me nacionalizmin dhe krijimin e shtetit kombëtar, pozitivizmi shkencor i skajshëm u përzie me mitologjizmin, të cilin sociologët e quajnë fazë të parë në zhvillimin e vetëdijes njerëzore (pas saj pasojnë faza astrologjike, teologjike, filozofike dhe më në fund ajo shkencore). Filluan gërmimet në histori dhe prapakthimet ose

² Ерик Хобсбаум, *Нациите и национализмот*, прев. Метод Јовановски, Култура, Шкопје, 1993, ф. 5.

përsiatjet prapavajtëse historike të përfytyruara, kështuqë rrënjët e shteteve të ndryshme filluan të kërkohen në mjegullnajën historike, madje pati e akoma ka edhe të atillë, që flasin për “histori tetëmijëvjeçare.” S’do mend se linja e ekzistencës së njerëzimit vazhdon shumë prapa në të kaluarën e për të shkenca flet vetëm me supozime, por historia si *his story* është shumë e shkurtër, nga Herodoti e Plutarku e pasistematizuar, e prej shek. XIX e këndej në mënyrë të përpiktë sistematike, si shkencë sociale, kurse dalldisja nëpër mjegullnajat e së kaluarës përplot me hipoteza e paragjykime nuk shpie askund.

Me realizimin e ëndrrave shekullore për shtetin kombëtar, anët përcaktuese të njerëzve nuk janë më njerëzishmëria, cilësitë e ndryshme, por përkatësia kombëtare. U themelua një rreth përjashtues, që në njërin cep të vetëdijes së vet pranon edhe “tjetrin” si subjekt, ose nuk e pranon fare. Mbizotërues filluan të bëhen togfjalëshat: “Shteti im, kombi im, toka ime, e drejta ime, kush-tetuta ime, flamuri im...” Ndërsa më parë si barometër i të drejtave merrej e drejta e dhuruar nga Hyjnia ose e drejta natyrore, sipas së cilës të gjithë njerëzit janë të barabartë, me modernizmin mbizotëruese u bënë e drejta pozitive dhe dokumentet e ndryshme juridike me prejar-dhje laike-shekullariste, si *Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit*, *Deklarata universale për të drejtat e njeriut*, *Konventa e Evropës për të drejtat e njeriut* etj.

Ndërsa kombet perëndimore fazën historike të integritit dhe të formësimit kombëtar, ose të *kombëtarëzimit*, e kaluan kryesisht në shekullin XIX dhe në vigjilje të atij XX, etnitë e tjera që për shkaqe të ndryshme vazhdimisht kanë pasur ngecje – po ta shprehim me terminologjine e mekanikëve: “kanë ndezje të vonuar” - nëpërmjet imitimit të verbër të më të fortit ose “më të përparuarit” krijuan shtetet e veta kombëtare si “kulmin e ekzistimit

të vet si tërësi sociale.” Por ç’ë do që nga këto shtete ka edhe të tilla, që janë mjaft artificiale dhe shtete-hije. Lourensi i Arabisë “u ndihmoi” arabëve që të arrinin vetëdijësimin kombëtar dhe “të shpëtonin nga zgjedha shumëshekullore e osmanëve”; për pasojë lindën principata arabe, që rrahin gjoksin për shtetshmëri dhe sovranitet, kurse as në organizimin e garave me kuaj, të golfit ose të turneve të tenisit s’mund t’i shpëtojnë hijes së çadrës së huaj (perëndimore).

Po t’i hedhim një sy hapësirës gjeografike të quajtur Ballkan, dhe ta shikojmë nga optika e filozofisë së historisë, mund të themi lirisht se me largimin e osmanëve, gjegjësisht nga Kongresi i Berlinit e në veçanti pas Luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, bëhet fjalë për një pështjellim të vërtetë. Janë formuar shtete me kufij, të cilët me një fjalë mund të përshkruhen si një lëmsh; që shaktojnë probleme të nduarta, të cilave s’ua gjen dot zgjidhjen as më mendjeholli. Jeta shoqërore e kombeve të Ballkanit kaherë është shoqëruar me turbullime e zigzage, të cilat përvijohen deri në ditët e sotme. Shpeshherë s’mund të qëndrosh pa bërë pyetjet: Vallë, ç’po ndodh? Pse s’kanë të qetësuar valët e këtij deti? Pse ndodhin të gjitha këto fërkime e polarizime mes përfaqësuesve të etnive të ndryshme, tiparet dhe karakteristikat e të cilave duhet të paraqesin një larmi dhe pasuri për të gjithë e jo arsye për përleshje të vazhdueshme? Pse ballkanasit të mos e kenë ndejnjën për llojin e artit të quajtur mozaik? Pse të mos e kuptojnë realitetin, se janë të krijuar “për t’u njohur midis veti”, e jo për t’u kacafytur e për ta zhdukur tjetrin?

Është mjaft domethënëse e mësimdhënëse rasti kur ndërroi jetë mistiku i madh mysliman nga Konja, Mevlana Xh. Rumi. Ndërsa njerëzit po kryenin ceremonitë fetare para varrimit të tij, ia mbërrinë banorët e krishterë të këtij

qyteti dhe thanë: Edhe ne do të bëjmë një ceremoni për të; aq sa është juaji ai është edhe yni! Pra, vlerat dhe cilësitë humane universale janë mbi çdo matricë etnike, kulturore .

Afërsi gjeografike, largësi njohjeje

Ballkani, i mbiquajtur Fuçi Baruti, është një hapësirë gjeografike, lidhur me të cilën thuren e krijohen strategji të shumta të fuqive të ndryshme botërore. Kjo është një nga shkaqet pse ballkanasit vazhdimisht janë në kërkim e sipër. Ah, sikur të ishin, siç shprehet K. Jaspers, “vazhdimisht në rrugë” (duke kërkuar urtësinë, të vërtetën)!

Kur vijmë te problemi i shoqërisë së emërtuar Maqedoni, në rrafshin sociologjik hasim në një tablo shumëkulturore dhe shumëetnike. Xhamitë, kishat kanë bashkëjetuar pranë njëra-tjetrës shekuj me radhë, e poshtu edhe ithtarët e Islamit dhe krishterimit. Dy etnitë më të mëdha, shqiptarët dhe maqedonasit, fati i ka bërë fqinje dhe të tilla do të mbesin përherë.

Për fat të keq kohëve të fundit edhe përsikaj afërsisë hapësinore, midis tyre është krijuar një largësi emocionale. Kjo do të thotë se dy etnitë kryesore të këtij vendi të vogël ballkanik, apo thënë me ligjëratën pasmoniste, “vend i Evropës Juglindore”, gjeografikisht janë të afërta, por për fat të keq në psikikën, mendjen, zemrën e tyre, ka mbetur fare pak vend për tjetrin. Pra, bëhet fjalë për një largësi psikologjike. Bindja ekskomunikuese dhe përjashtuese e tjetrit sikur i ka mbështjellur qeniet, të cilat pa zgjedhjen e vet janë shqiptarë ose maqedonas. Sidoqoftë, përpjekjet e “ajkës” (inteligjencies) së të dy popujve duhet të jenë në drejtim të gjetjes së minimumit të

tolerancës dhe respektit ndaj tjetrit, që ka mbetur te të dy grupet sociale dhe të (ri)gatuaries së një buke, e cila quhet bashkëjetesë, që do të jetë e nevojshme madje edhe nëse dikur do të realizohet varianti më i skajshëm: ndarja. Iniciativa për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, për të qenë e suksesshme duhet të mbështetet nga të gjitha shtresat shoqërore. Por, elitat ose inteligjencia janë ato që më së tepërmi dhe më së shpejti mund ta shuajnë ose ndezin zjarrin, nga i cili do ta pësojmë të gjithë. Por si në çdo aspekt tjetër, edhe këtu ballafaqohemi me një prapësi të hapur.

Ka disa kohë që po ndjek artikujt e një profesori universitar të filozofisë, i cili paraqitet me shkrimet e tij në një të përditshme në gjuhën maqedonase. Me sa kam lexuar, të gjithë fjalorët e ndryshëm termin ‘filozofi’ e përkufizojnë si “dashuri ndaj urtësisë” dhe natyrisht, nga një profil i tillë pritja diç nga urtësia apo ajo të cilën grekët e vjetër e quanin *sophia, idea*, por për fat të keq rreshtat e “filozofit” në fjalë vlonin nga ashpërsia, vrazhdësia, thirrjet për larje të hesapeve me “palën tjetër terroriste”. Ç’mund të pritet në një vend, kur edhe “ajka shoqërore” e humb drejtpeshimin dhe orientimin?

Në titullin e këtij artikulli, qëllimisht përdora shprehjen vetëshkatërrim (autodestruktivitet) në bashkëlidhje me Homo Balkanicus-in, gjegjësisht e përdora atë të adresuar ballkanasit ose njeriut të këtij mjedisi a nënqielli, pa bërë ndarje kombëtare ose fetare. Kjo për arsye se shkatërrimi, humbja, vuajtja, ankthet, madje edhe nëse x etni e ka dëmtuar y -në, prapë i janë kthyer si bumerang edhe x -it. Ndonjëherë janë thurur këngë e epope për fitore, që shumë herë kanë qenë fiktive, bilanci i të cilave është parë e regjistruar shumë vite, dhjetëvjeçarë e ndoshta edhe shekuj më vonë. Dhe, përfundimi apo ironia gjithherë ka qenë: Si është e mundur që edhe fitorja, edhe humbja të ndahet me oponentin?

Një zë i brendshëm vazhdimisht prek ndërgjegjen e të mençurve: Përkujtoni dhjetë vjetët e fundit të trojeve të ish-Jugosllavisë, ose zgjateni kokën përtej avllisë dhe merrni mësim nga realiteti, se si përfundoi fqinjësia ish-jugosllave! Edhe pas të gjitha baticave dhe zbaticave, më së paku gjeografikisht do të mbeteni të afërt dhe deshët s'deshët, do të takoheni dhe kontaktoni!

Mijëvjeçari i ri dhe perspektiva jonë

Mijëvjeçari, ose shprehur perëndimorçe 'mileniumi' i ri, është bërë temë diskutimi për njerëzit e profileve dhe shtresave të ndryshme. Disa e kanë paraparë si pikë të kataklizmës universale, kurse të tjerët si një fazë kohore me të cilën do të lihen mbrapa të gjitha të këqijat, kur do të arrihet deri të gjëja më e dashur "kënaqësia-lumturia".

Por realiteti ynë aktual, me sa duket, është më afër tezës së parë, përkatësisht asaj pesimiste. Me të shkelur në vitin e parë të këtij mijëvjeçari, po na ndodh një nga dukuritë më të urryera për çdo njeri normal: lufta. Sa filluan njerëzit t'i bënin flad vetvetes se i shpëtuan më të keqes, ajo na erdhi në prag të shtëpisë. Të gjithë i kaploi frika nga përsëritja e faqeve të zeza të fundshekullit të mijëvjeçarit të dytë, si në Kosovë, Bosnje, Kroaci. Në kokat e të gjithëve po rrotullohen fotografitë e Reçakut, Bllacës, Srebrenicës, Vukovarit, ethet e vandalizmit dhe kanibalizmit të njeriut të epokës digjitale, multimedias etj.

Në kohën kur lexojmë shkrime e vepra të nduarta, ku flitet se epoka e politikës është duke perënduar ose tashmë ka perënduar, dhe se kemi hyrë në atë të *homo economicus*-it, te ne, udhëtarët e Ballkan Express-it, politika

është bërë temë numër një, çdo pore të jetës e kanë kap-
luar bisedat, polemikat dhe mosmarrëveshjet politike. Te
ne duket sikur thënia e Napoleonit të njohur: “Vitesse,
vitesse, vitesse”, është ndryshuar në trajtën: “Politikë,
politikë, politikë.” Por jo vetëm kaq, politikë e shpirtit
dionizian (luftarak). Sikur të ketë vdekur shpirti apoloni-
an (paqësor).

Politika si mjet i organizimit e i udhëheqjes shoqëro-
re dhe zëvendësim e kulturizim i ndjenjës kafshëror të
njeriut, si mjet që duhet të na mbrojë nga “lufta e të gjit-
thëve kundër të gjithëve”, në vend që të na shpjerë drejt
një jete më të lumtur, na ka prurë para dilemës kierke-
gardiane **ose-ose**, na ka prurë në një gjendje, kur tashmë
e ka humbur domethënien edhe shprehja, të cilën e përd-
dorte shpesh profesori im i pedagogjisë: *sweet distance*.
Demosit sikur i janë marrë mendtë.

Si të shpjegohet statizmi ideor për pandryshueshmë-
rinë e një akti juridik të formuluar nga njeriu dhe të mi-
ratuar pa dëshirën e tjetrit! Si të shpjegohet teologjia po-
litike dhe krahasimi i kushtetutës me Biblën, së cilës si-
kur t'i referoheshim, do të vërehej lidhshmëria midis da-
shurisë për fqinjin (tjetrin) me dashurinë për Zotin?

Si të shpjegohet retorika për “vendasit” dhe “ardha-
cakët”?

Si të shpjegohet segregacioni edhe në çështjet më të
imta të jetës?

Para ca ditësh isha në një farmaci shtetërore dhe me
të hyrë, vërejta se duhet të prisja ca kohë derisa të më
vinte radha. Dhe punonjësja, që duhet ta ketë bërë beti-
min e Hipokratit (ku përmendet mosdiskriminimi në ba-
zë nacionale, fetare, etj.), me buzëqeshje dhe mirësjellje
çdo klienti, bashkë me ilaçet i ofronte nga një qeskë, pa i
pyetur nëse kanë nevojë për të ose jo. Kur i erdhi radha
autorit të këtyre rreshtave, pasi i hodhi një sy recetës

(dhe hamendësoj, pasi në vetvete tha: Aha, ti qenke nga “ata”), m’u drejtua: A të duhet qeskë? Nuk e di, pse vallë ky rast m’u ngulit në mendje? Ose merrem me gjëra të imta, ose sjellja e punonjësës ishte vetëm pasqyrim i gjendjes aktuale në vend?

Nuk dua të profetizoj lidhur me ardhmërinë e këtyre trojeve, pasi asnjëherë nuk më kanë interesuar “nostradamët” e orakujt, edhe pse në horizont duken mjegulla të dendura, të cilat mund t’i largojë vetëm një erë e fortë që quhet **bonsens**. Një nga bindjet e mia jetike është se të dhënat dhe fshehtësitë lidhur me ardhmërinë i di vetëm i Gjithëdijshti, si dhe se njerëzit “duhen përgëzuar e nuk duhen dhënë lajme ogurzeza.” Për këtë arsye mbetem optimist për një të nesërme më të mirë.

P.S. Sipas një thënieje popullore turke “Pusi nuk mbushet me ujë nga jashtë”. Pra, të huajt (ndërmjetësuesit ose “lehtësuesit”) mund të na ndihmojnë në përmirësimin e situatës, por mundin kryesor duhet ta bëjnë banorët e vazhdueshëm të këtij nënqielli. Gjendja jonë nuk do të ndryshohet nëse nuk ndryshojmë diçka në vetveten tonë.

Monizmi si “tejzë akiliane”

Jetojmë në epokën e pasmodernizmit. Epokë kjo kur relativizmi ajnshtajnian i shkencave natyrore është pasqyruar në rrafshin shoqëror dhe kështu është përftuar një relativizëm tjetër (ai shoqëror), i shprehur më së miri nga sociologu anglez E. Gellner përmes sloganit *Relativismus über alles* (relativizmi mbi të gjitha). Në periudhën e pasmodernizmit hasim në një qarkullim të lirë të relativizmit; bëhen përpjekje që edhe *e vërteta*, e cila është absolute dhe një, të relativizohet. Me siguri e keni parasysh rastin, kur edhe kryedemoni i Ballkanit, i nxjerrë para gjyqit ndërkombëtar, pretendon për “të vërtetën dhe të drejtën e tij”?!

E vërteta është relativizuar edhe në rastin e problemeve që na përshkojnë që disa muaj; ekzistojnë “dy të vërteta.” Ajo e njërës dhe ajo e tjetrës palë. Të dyja kanë kënde të ndryshme nga i shikojnë gjërat. Në kokat e tyre ekzistojnë dy Maqedoni. Secila mbron idenë dhe vizionin e vet për mënyrën e organizimit e të funksionimit të kësaj shoqërie politike (shtetit). Disa, po ta shprehim me fjalorin e kimisë, “e shohin” si strukturë njëelementëshe, kurse të tjerët, si aliazh... si shtrat të shumëkulturësisë, shumëtnisë...

Maqedonia si *unitas multiplex*

Një ndër minuset më të mëdha që mund të vërehet në tabelën e negativiteteve, të cilat Maqedoninë e kanë prurë deri në këtë “derexhe”, është edhe ideja moniste e ngulitur thellë në mendjet e një pjese të popullatës së saj. Në filozofinë e tyre sociale, ajo që është mono, njëngjyreshe, njëtrajtëshe (uniforme) është mbizotëruese dhe deri para do kohe, aparati ose monopoli shtetëror, i drejtuar po nga ata, nuk lejonte që të flitej e lëre më të realizohet ekuilibrimi në sferën e të drejtave të qytetarit në përshtatje me realitetin shoqëror, që është i lidhur ngushtë me varietetet, shumësinë, me parashtesat “poli-” ose “shumë-”. Ndodh që këtë ta kenë nga “hasreti” shekullor për të themeluar “shtet”, i cili në asnjë mënyrë nuk është synim final, por vetëm mjet (Aristoteli) për një jetë të lumtur. Paradigma e gabuar për shtetin si *raison d'être* dhe nacional-romantizmi i skajshëm i socializuar, kanë shkaktuar shkeljen mbi tjetrin, i cili me qenien e vet ka dhënë ndihmesë për trupëzimin e këtij subjekti politik të ri, që për arsye të ndryshme, s’ia del dot të ngrihet më këmbë e të fillojë të ecë normalisht dhe ta gjejë vendin e vet në arenën ndërkombëtare.

Reale janë gjasat që monizmi të jetë një *tejsë* (thembër) *akiliane* e trashëguar nga ish sistemi i socializmit real, ku mbisundonte monizmi i vrazhdë në të gjitha sferat e jetës. Edhe pse kanë kaluar dhjetë vjet nga “lamtumira historike” me sistemin e monizmit titist të bazuar në materializmin dialektik, maqedonasit akoma nuk i kanë thyer prangat e njëngjyrshmërisë ideologjike. Deri dje ishin vetëm për një parti, sot janë vetëm për një komb shtetformues, vetëm për një gjuhë zyrtare ... Nuk janë për dialog (lexo: të mirëfilltë). Me mish e me shpirt luftojnë që skena të jetë vetëm e tyrja dhe të zhvillojnë një monolog,

nga i cili do të ishin të kënaqur vetëm ata, pra, do të përjetonin vetëkënaqjen permanente.

Kushti që ky vend të ketë ditë më të ndritura është çlirimi nga ky arketip artificial. Realiteti jetësor që na rrethon në të gjitha anët shkruan parullën objektive, e cila duhet të zërë vend edhe në kokat e shovenëve më ekstremë: *unitas multiplex*. Pra “uniteti në shumëllojshmëri” është formula magjike, që mund ta shpëtojë FYROM-in nga shpërbërja si zgjidhja më skajore, për të cilën *arbanët* nuk do të mbajnë kurrfarë përgjegjësie. Kjo ngase nuk kërkojnë gjë tjetër, pos barabarësisë në të gjitha poret e jetës, duke filluar nga politika, ekonomia, kultura, arsimit, jeta fetare etj.

Sllavomaqedonasit duhet ta edukojnë vetveten që mos t’u dhembnin veshët kur ta dëgjojnë etnonimin *shqiptar*. Duhet të përjetojnë një katars shpirtëror, i cili do t’i pastrojë nga vetëpëlqimi etnocentrik. Duhet të kalojnë nga pluralizmi fiktiv në atë real. Filozofi i famshëm grek Platoni, flet për idetë universale. Ndër to është edhe drejtësia. Ajo është një *conditio sine qua non* për mirëqenien dhe ekuilibrin e çdo shoqërie, sepse ato “mund të jetojnë me blasfemi, por në asnjë mënyrë pa drejtësi.”

Panta rei

Herakliti shumë shekuj më parë, mes tjerash ka shqiptuar edhe këto fjalë: *Panta Rei*. “Gjithçka rrjedh, gjithçka ndryshon.” (Kuptohet, me përjashtim të Demiurgut.) “Njeriu nuk mund të lahet në lumë dy herë në të njëjtin ujë.”

Dy nga premiset themelore sociologjike janë:

1. *Anthropos zoon politicon* (Njeriu është qenie politike ose shoqërore).

2. Ndryshimi social është i pashmangshëm.

Në rastin konkret, me rëndësi është ideja e Heraklitit dhe premisa e dytë sociologjike. Lëvizja, gjallëria, ndryshimi dhe dinamizmi janë elemente që vazhdimisht e përcjellin jetën e njeriut. Bile edhe njeriu i gjymtë, i ngjuar në karrocën e vet, është dinamik, nëse jo fizikisht, vazhdimisht bën fluturime e zbritje mendimore. Edhe shoqëria më statike s'mund t'i ikë ndryshimit shoqëror.

Maqedonia pasmoniste që nga marsi i këtij viti po përjeton dhimbje e vuajtje mjaft të rënda. Ka nevojë për diagnostikim dhe mjekim të ngutshëm, që varrat të shërohen e t'i kthehet linjës normale të jetës. Ajo ka hyrë në një rrugë që nuk ka prapakthim. E ardhmja e saj kurrë nuk do të mund të jetë ashtu siç e paramendojnë disa koka paranoike, e ngjashme me epokën para daljes në skenë të faktorit ushtarak shqiptar. Elementi maqedonas, sipas të gjitha gjasave, nuk do të ketë mundësinë për mbizotërim të padiskutueshëm. Periudha e të qenët të tij (elementit maqedon) *Caesar dominus est supra grammaticam* (Cezar që sundon madje edhe mbi gramatikën) është drejt perëndimit. Deri tani ky "cezar" përzihej edhe në normat gramatikore të shqipes letrare, kështuqë librat shkollorë botoheshin nga 'Prosvetno Dello në Skopje', "Liqeni i Ohridit ishte i pasur me peshq", flitej "për rrethin e Kiçevës" etj. Përzihej atje ku s'duhej, në vend që të merrej me problemet e veta, si p.sh. çështja e shkronjës "ë", e cila në gjuhën letrare maqedonase ndonjëherë zëvendësohet me apostrof (') e ndonjëherë nuk shkruhet fare, ose të edukonte pjesëtarët e elitës, që nuk do të formojnë shumës joletrar në trajtën *човекът*!

Duke u nisur nga botëkuptimi heraklitian, do të shpreheshim se të gjithë mund të lahemi në lumin e quajtur Maqedoni, por jo në ujin që ka shkuar.

Kondicionali si shkas

Kohë më parë më ra rasti të lexoj një artikull, në të cilin autori me një sy kritikë fliste për njëfarë “kondicionali shqiptar.” Sipas tij, politikanët dhe korpusi albanofon, opinionit maqedonas iu drejtuakan me mënyrën kushtore “nëse jo kështu (nëse nuk pranoni atë që themi ne), do të keni punë me UÇK-në”, kinse në ligjëratën e shqiptarëve paska ngjyrimë kanosëse, me të cilat po u krijoka një atmosferë e tensionimit më të madh të situatës, që çon deri në humnerë.

Autori në fjalë harron *akologjinë* maqedonase permanente. Me ditë të tëra popullatës së pafajshme i janë bërë thirrje përmes mediave për lëshimin e vatrave shekullore, ku më në fund pasonte sentenca: “Nëse nuk ndodh kjo...”; politikanët e zëdhënësit e partive të mëdha dhe të vogla maqedonase pandërprerë qeverisë, e me qejf më të madh shqiptarëve, u janë drejtuar e u drejtohen me “ako” (nëse, maqedonisht), pas së cilës pason fjalori militarist. Pastaj fjalia tashmë klasike: “Nëse nuk ju pëlqen një Maqedoni ashtu si e përfytyrojmë dhe e rregullojmë ne (maqedonasit), ja ku i keni fqinjët perëndimorë dhe veriorin, shpërnguluni atje, zaten jeni ardhacakë (!)”

Nuk duhen harruar as parashikimet që “nëse” shqiptarëve u jepen të drejtat e kërkuara prej tyre, në të ardhmen do të pasojë federalizimi dhe ndarja e këtij shteti. Mosbesimi që organet shtetërore ushqejnë ndaj një pjese të qytetarëve të vet është një gjë simptomatike. Është tregues se makro-subjekti nuk ka krijuar një atmosferë të besimit të ndërsjellë në marrëdhënien shteti-qytetari e *vice versa*, fundja, se ka bërë diç jolegjitime, që do të shkaktonte pakënaqësinë e pezmin e qytetarëve të vet dhe, për pasojë, pasigurinë e vetë shtetit gjegjës nga

mosbindja e kryengritja e një grupi shoqëror. FYROM-i (lexo: maqedonasit) nuk do të kishte pse të frikohej për ardhmërinë e vet, sikur të kish "punuar" për mirëqenien dhe barabarësinë e të gjithë qytetarëve në çdo pore të jetës, sikur të mos kish gjykuar me arshinë të ndryshëm, sikur mos të kish krijuar kurbetqarë të përjetshëm, që lënë kockat nëpër fshatrat e qytetet e ish-Jugosllavisë, Zvicrës, Gjermanisë etj., dhe banorë të getove si Dizhoni e Gazi Baba, sikur mos të kish keqtrajtuar brutalisht kasapë e berberë gostivaras, sikur mos të kish krijuar distancë sociale-ekonomike të tipit: disa shkojnë për verime në Halkidiki, Qipro e Opati, e disa të tjerë në ballkonet e shtëpive të veta, disa pronarë të markave më të reja të automjeteve e disa të tjerë të atyre nga Kragujevci e varrezat e makinave të Perëndimit, disa në kurse të gjuhëve të huaja e të kompjuterëve e disa pa kushte elementare për jetë normale, disa të vishen me Armani e Benetton e disa të tjerë në Bit Pazar. Atij që këto fjalë i duken trillime, i mjafton vetëm realiteti i dy Shkupeve: Shkupi i përtej Vardarit dhe ai këndeje Vardarit. Dy botë më vete, njëra me infrastrukturë moderne, tjetra me sokaqe të ngushta e shtëpiza të ngjitura njëra për tjetrën, shumë sish të mbuluara me teneqe...

Pushtetarët duhej ta dinin se balonit mund t'i fryhet deri në një masë të caktuar, e cila nëse tejkalohet çon deri te plasja e tij.

Sidoqoftë, realiteti është ky që është dhe mendjet më të kthjellëta të këtij vendi duhet të djersiten, që të gjendet zgjidhja solomoniane, e cila do të garantonte një ardhmëri më të mirë për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare ose fetare. Kushti është që shpirti racional të arrijë të mbizotërojë mbi atë ndjenjësor (emocional). Nëse ndodh kjo, do të vërehen më lehtë gabimet, do të nxirret mësim nga e kaluara dhe do të gjendet rrugëdalja nga ky labirint.

Nga konvencionaliteti në spontanitet

*“Sikur të mos sëmureshim fare, s’do ta dinim
ç’domethënie ka shëndeti. Sikur mos ta shijonim urinë,
s’do ta dinim ç’kënaqësi është të jesh i nginjur. Sikur
mos të kish luftëra, s’do ta konceptonim vlerën e
paqes...”*

Jostein Gaarder

I.

Hapësira: Një vend i vogël ballkanik, i pagëzuar “oazë e paqës”. Koha: dhjetëvjeçari i fundit i shekullit XX.

Jetë nën flatrat e *Pax Macedonica*-s. Praxis-i i gabuar dhe tendencioz politik si dhe *lujtimi* ekskluzivist i kolektivizuar në formën “shteti, jemi vetëm ne!”

Pasojat në prag të mijëvjeçarit të ri: Plumbi i parë, filmi i përleshjeve, vrasje, rrënime... Luftë! Gjak, lotë, rënkime, trauma, agoni... Pasqyrime të realitetit tonë anakronik. Dhe, pas një kohe bukur të gjatë, dialogu maratonik, debatet politike të kurorëzuara me një **marrëveshje, kontratë, konventë**, si kusht i domosdoshëm për kthimin e paqes dhe rehatisë së “qenies më të ndershme në sipërfaqen e tokës” të quajtur *njeri* dhe pjesës tjetër të qenieve, që e rrethojnë atë.

Tre sinonimet e përmendura më lart nënkuptojnë një gjendje, e cila metaforikisht mund të quhet “periudha pas shtrëngatës”, kur “furtuna ka mbaruar” (?) dhe duhet të fillonte konsolidimi, kur çdo pikë e “shiut të paqes” freskon zemrën e të përvuajturve. Fjalë këto mjaft shpresëdhënëse, sikur të kalohet në realizimin faktik të dokumentit të mistifikuar nga mas mediat.

Përskaj të gjithave, dialogimi i rrumbullakësuar me firmosje jep gjasa për kalimin nga dialektika në kohezionin shoqëror relativ, nga të qenët shoqëri dialogocentrike dhe e kontratës shoqërore (Rousseau) në shoqëri ku jeta zhvillohet **spontanisht**, sipas parametrave të natyrlshmërisë, pa komplekse e tabu.

Prej 13-shit të famshëm fillon një periudhë e re (paskonvencionale), kur jeta duhet kthyer në binarët e normales. Themi “normales” për arsye se lufta është një shkëputje e linjës së normalitetit. Me t’iu kthyer normales, duhet t’i shpëtojmë psikozës së bisedimeve - dialogut politik, ta “çlirojmë mendjen” tonë nga kushtëzimi psikologjik i quajtur **konvencionalitet**, nga nomenklatura juridike-kushtetuese, nga nocionet si: preambula, neni, amendamenti, kryetari, filan parti, filan zëdhënës... Duhet ta harrojmë timing-un e lajmeve e të ditareve, të harrojmë pamjet kur paraqitësit e mediave harrojnë që emisionet e veta t’i fillojnë me përshëndetjet “mirëdita” ose “mirëmbrema”. Me një fjalë duhet të kalojmë nga gjendja e “mendjes së robëruar” (Milosz), në gjendjen e mendjes së lirë dhe praktike (Kant)...

II.

Për të realizuar-jetësuar një kthim të vërtetë te ditët e jetës pa thashetheme “politike”, pa deklarata, ultimatumë, pamje trishtuese e shumë gjëra të tjera negative që na e

kanë përshkuar jetën tonë këta muaj, kujtoj se kemi nevojë për një ndryshim rrënjësor. Ndryshim në botën e ideve, apo thënë më mirë *revolucion*. Pra, shoqëria jonë ka nevojë për një revolucion ose katars ideor. Kjo për arsye se idetë janë rrjeta dhe plani i veprimeve të njeriut. Nëse arrihet të realizohet një kthesë rrënjësore në ndryshimin e “*vetëpërceptimit* (self-perception) të ashpër dhe amorf”, të gjithë do ta kemi më mirë dhe do të mund të marrim frymë më lirshëm. Çdo qytetar i kësaj shoqërie që ka kritere të zvetënuara duhet të ndryshojë vetveten. T’u kthehet vlerave të mirëfillta qytetërimore, morale, estetike, fetare...

Dihet fort mirë se shoqëritë ku humbet ndijimi për dallimin e së mirës nga e keqja, e së bukurës nga e shëmtuara, e mëkatit nga mirësia etj., janë shoqëri të paqëndrueshme, shoqëri që kanë marrë teposhtëzën, që shkojnë drejt greminës.

Çdo shoqëri e shëndoshë nxjerr mësim nga ndodhitë, dëshmitare e të cilave ka qenë. I vëren gabimet e bëra dhe distancohet nga mëkatet e idiotëve të kohës dhe kalorësve të apokalipsit. Në *kujtesën kolektive* të saj gjejnë vend vetëm vlerat pozitive, përjashtohen përbindëshat artificiale të pikturuar me të zezë nga Gëbelsat politike, hipokritët e fanatikët interesaxhinj, që gjuajnë në ujë të turbullt.

Shoqëria jonë ka nevojë për shërim nga skizofrenia sociale, ka nevojë për kalim nga pacifizmi sipërfaqësor e formal në atë real. Të dy grupet më të mëdha etnike duhet që t’u ikin paragjykimeve për *teori të komplotit* të përgatitur nga tjetri, duhet të përpiqen t’i këpusin zinxhirët e politikocentrizmit të imponuar dhe skepticizmit shterpë. Për një moment nevojitet shkëputja nga realiteti i brishtë dhe, siç thotë shkrimtari i mirënjohur brazilian Paulo Coelho në veprën e tij *Alkimisti*, “bota duhet shikuar jo ashtu siç është, por siç mendojmë se duhet të jetë”,³

³ Paulo Coelho, *Simyacı*, çev. Özdemir İnce, Can Yayınları, 32. Basım, Stamboll, 1997, f. 52.

pra të përfytyrojmë një botë me kushte më të mira jetësore. Poeti i njohur turk Yahya Kemal në një varg të tij thotë: “Njeriu jeton përderisa imagjinon!”⁴ S’duhet harruar se është imagjinata e bujshme ajo, nga e cila burojnë veprat dhe aksionet e mëdha frytdhënëse.

III.

Arthur Schopenhauer-i e përkufizon njeriun si *animal metaphysicum*. Hulumtimet e bëra kohëve të fundit nga sfera e sociologjisë tregojnë për një prirje të rritjes së shkallës së fetarisë të njerëzimit anekënd rruzullit tokësor. André Malraux thotë se “shekulli XXI ose do të jetë shekulli i së shenjtës-fetares, ose nuk do të jetë fare”.

Me sa duket, kjo prirje është pasqyruar edhe në nënqiellin tonë. Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për paqe politikanët përdorën një fjalor teocentrik. Njëri kërkoi ndihmë nga Perëndia, tjetri pohoi se marrëdhëniet shoqërore përveçse me aktet dhe ligjet të bëra nga njeriu, mund të rregullohen edhe me ligjet hyjnore, kurse i treti tha se jeta është dhunti e Zotit dhe askush, pos Tij, s’ka të drejtë ta marrë atë. Do të ishte me siguri e dobishme sikur liderhipi dhe stafi udhëheqës *Vox Populi*-t t’i përgjigjen në përputhshmëri me *Vox Dei*-n.

Shoqëritë e shëndosha kanë politikanë që vazhdimisht kontaktojnë me *logos*-in dhe karrierën (dhe jetën *in tutti*) e vet e rregullojnë sipas parimeve të kësaj logjike universale, e cila dikton harmoni në çdo rrafsh jetësor, që mëson dhe urdhëron jetësimin e parimit “dua ja tjetrit atë që ia do vetvetes dhe mos u sill me tjetrin ashtu si nuk do të kishe dashur që të tjerët të silleshin me ty.” Në rast se udhëheqja do të ishte e këtillë, edhe masa e gjerë

⁴ Ismet Ozel, *Tri çështjet*, përkth. Ali Pajaziti, Logos-A, Shkup, 1998, f. 35.

do ta pranonte kursin e tyre dhe nuk do të kishim tension të lartë, polarizime e agresivitet gjakatarësh e piromanësh. Si shoqëri nuk do të ishim kandidatë për të hyrë në listën e vendeve me nam të keq në botë. E përjavshmja e njohur amerikane 'Newsweek' para ca javësh dha tabelën e dhjetë vendeve *out*, vende këto ku jeta është pa perspektivë. Në mes tjerash ofroi edhe listën e tipareve negative të tyre, që i ka sjellë në atë pozitë: udhëheqësia shtetërore e korruptuar, mostoleranca në baza etnike dhe fetare, e kështu me radhë.

Nëse do të kishim udhëheqës e burokratë që "kujtojnë celestialen" (qielloren), d.m.th. të ndërgjegjshëm, nuk do të kishim raste që janë të ngjashme me këtë të mëposhtmin:

Në kohën e kolonializmit, pushteti francez veriafrikan hapi një konkurs për vende të reja të punës. Hyn një vendas në zyrën e nëpunësit të lartë francez, që zhvillon intervistat me kandidatët dhe pas përshëndetjes ulet. Burokrati parashtron pyetjet dhe pas një kohe të caktuar mbaron procedurën e vet. Pasi "i gjori" del jashtë, zotëria, "i nxehur" mjaft, këlthet: "Tepër i rrezikshëm, di të numërojë deri më dhjetë!"⁵

Vendi ynë s'do të ketë perspektivë derisa të ekzistojnë tipa dhe grupime që shohin fatamorganën e rrezikut nga individët e arsimuar prej radhëve të etnisë tjetër!

IV.

Lufta si vazhdim i politikës me mjete e metoda të tjera (Klauzevitz)⁶ është një fenomen shoqëror, që sjell

⁵ Fatih Okumuş, *Malik bin Nebi – Yirminci Asrın Şabidi*, Denge Yayınları, Stamboll, 1998, f. 124.

⁶ Ukshin Hoti, *Filozofia politike e çështjes shqiptare*, Rozafa, Tiranë, 1995, f. 13.

ankthe të shumta. Por në jetën tonë ekzistojnë shumë gjëra, që në shikim të parë na duken si tërësisht negative, të cilat prapaskenën e vet fshehin mirësi dhe dobi për individin e popullin në tërësi, dhe e kundërta, ekzistojnë shumë gjëra ose ndodhi, që na duken dobiprurëse, por nga të cilat më vonë vuajmë.

Një nga pasojat pozitive të luftës është kohezioni brendakombëtar, bashkimi rreth idealit dhe çështjes së njëjtë, solidariteti, forcimi i radhëve, shtimi i dashurisë dhe respektit midis pjesëtarëve të grupit të njëjtë etnik. Në kohërat e vështira njerëzit ndërgjegjësohen më tepër, u këndellen ndjenjat kombëtare, janë në gjendje që me “vëllanë” ta ndajnë edhe kafshatën e gojës. Në këto kohëra të kataklizmës në masë të madhe humb domethënien dhe fuqinë vepruese motoja ndjellakeqe “Divide et impera” (Përça e sundo!), e shfrytëzuar nga pala kundërshtare për të përçarë, dobësuar dhe ngadhënjyer mbi oponentin. Një dukuri tjetër me rëndësi në këto kohëra të vështira është edhe “mbetja mbi rërë dhe përpëlitja e peshqve të quajtur spiunë, farisenj, hipokritë, puthadorë-e-poltronë”, që për thuajse asgjë shiten dhe shesin të tjerët. Ata i kaplon një krizë e rëndë shpirtërore e fizike nga rreziku i papërcaktueshmërisë së vetvetes lidhur me atë, se cilit tabor i përkasin. Këta njerëz duhen shpëtuar nga kjo krizë, “duhen kthyer në ujë”, por me një vërejtje: *Pendimi nuk falet, nëse gabimi përsëritet!* Bota njih pendestarë, që kanë lënë pas vetes gjurmë të shkëlqyera!

Tani në vigjile të paqes dhe më tutje është koha e fundit që ne shqiptarët t’i rregullojmë radhët tona në të gjitha sferat e jetës, të bëjmë një “mobilizim” të përgjithshëm. Prej tani fillojmë që të shkruajmë një faqe të re të historisë dhe çdo gabim i bërë do të jetë fatal. Duhet që deri në maksimum t’i shfrytëzojmë potencialet tona në të gjitha sferat e jetës, si në arsim, politikë, ekonomi, kulturë,

etj. Duhet që në mikro- dhe makroplan të përpilojmë plane e programe, që do të na garantonin të nesërmen më të mirë për ne dhe brezat e ardhshëm. Me punë të palodhur të fshijmë nga kokat tona dhe të “tjetrit” arketipin për shqiptarin si pastrues, shërbëtor, punëtor krahu... Në praktikë të tregojmë se pos klasës jakëkaltër (punëtore), kemi edhe atë jakëbardhë (intelektuale), që di të ecë në hap me kohën, gjithmonë duke ruajtur vlerat autentike, duke mos u tëhuajësuar nga korpusi i vet kulturor.

Kushtet hap pas hapi po ndryshojnë për mirë. Për të arritur objektivat e synuar, çdo “hap” duhet bërë sipas një udhëzuesi, metodologjie, strategjie dhe sistemi të përpiluar paraprakisht. Përndryshe aksioni pa metodologji e sistem është pothuajse një hiç. Të gjithë duhet të bëjnë më tepër punë e më pak fjalë, sepse *verba volant, actum manent* (Fjalën e merr era, vepra mbetet.)⁷

⁷ Ferhat Polisi, “Mendime filozofike të rilindësve shqiptarë”, *Jehona*, 2000/1, f. 67.

Socioeksegjeza e elitës intelektuale

“Dituria është fuqi”

F. Bacon⁸

Sipas parametrave sociologjikë, çdo shoqëri ose bashkësi përbëhet prej tri shtresave: e larta ose elita, e mesmja dhe e ulëta. Pikëpamja për shoqërinë horizontale (pa shtresa e klasa) është iluzion ose soc-utopizëm. Fenomeni i shtresimit shoqëror në mënyrë pamore ilustrohet me një piramidë të ndarë në tri pjesë, duke shkuar nga lart-poshtë ose anasjelltas. Varësisht nga rregullimi dhe botëkuptimi zyrtar socio-politik, në pjesën e epërme të piramidës zënë vend inteligjencia, aristokratët, fisnikët, plutokratët (manjatët ekonomikë), autokratët etj.

Kur kemi të bëjmë me elitën, duhet theksuar se shpesh ndodh që të vihet shenjë barazimi mes këtij nocióni dhe tërësisë së intelektualëve (inteligjencies). Është fakt se në elitë shumë herë përfshihen edhe individë pa kurrfarë predispozicionesh intelektuale; pra mund të kemi elitë në sferë të ekonomisë, politikës, artit, sportit, elitë të forcave ushtarake etj. Nga ana tjetër, koncepti inteligjencie ka të bëjë me një tërësi individësh që merren me shkencë, mendim, që dinë të bëjnë hope ose mutacione ideore, që kanë ndjenjën dhe aftësinë *për t'i interpretuar*

⁸ Jostein Gaarder, *Sofi'nin Dinyasa*, 11. Basim, çev. Gülay Kutal, Stamboll, 1996, f. 230.

sistematikisht dukuritë e ndryshme... Pra, inteligjencia është një koncept më i ngushtë sesa elita.

Inteligjencia është një dukuri imanente për çdo shoqëri. Intelektualizmi paraqet një dukuri ose lëvizje shoqërore me përmasa ideologjike dhe është i lidhur me scientizmin. Në etapat më të lashta historike inteligjencien ose *trurin shoqëror* e kanë përbërë orakujt e ndryshëm, shamanët, klerikët, filozofët, dijetarët e oborrit mbretëror etj., kurse në kohën tonë, në veçanti njerëzit që kanë kaluar nëpër amfiteatrot universitare, individët me tituj shkencorë dhe në përgjithësi ata që krijojnë në fushën e shkencës dhe kulturës.

Intelekti në shërbim të ideologjisë

Vendi ynë në një periudhë kohore pesëdekadëshe që pjesë e sistemit të socializmit real. Kah fundi i viteve '80 dhe në vigjilje të atyre '90 të shekullit XX, ndodhi efekti domino (pllakat e para që në Glasnost dhe Perestrojka) dhe komunizmi shkoi gradualisht duke u rrënuar vend pas vendi, derisa u zhbë edhe pjesa e këtushme e kësaj ngrehine të pathemeltë. Fund tragjik i një ultra-dogmatizmi! Pushoi së jetuari humanizmi i bazuar në materializëm, e me këtë edhe paradigma epistemologjike e ontologjike e tij.

Një doktrinë që pretendonte të ishte shkencore përjetoj fiasko. Lidhur me këtë A. Camus qysh në vitet '60 ka pohuar se "marksizmi nuk është shkencor, por scientist. Socializmi s'është shkencor. Ai u ngjit dhe mbeti në evenimentet. ... është profetizues, dialektik dhe dogmatik. Për pasojë, i pasuksesshëm." Marksizmi i la në gjysmë të

udhës intelektualët që besnikërisht bënë apologjinë e tij; u tha klorofili i gjetheve të shkencës së ideologjizuar.

Siç çdo tjetër, edhe sistemi në fjalë ka patur *weltanschauung*-un (botëvështrimin) e vet, në saje të së cilit e rregullonte jetën shoqërore. Në bazë të këtij botëkuptimi i ka edukuar brezat dhe ka formuar klasën e vet intelektuale. Për këtë grupim elitist si edhe për të gjithë individët ka vlerë motoja mesjetare *Credo et intelligam!* (Beso e pastaj mendo!)⁹ Pra “beso” në ideologjinë mbisunduese, në skemat marksiste-leniniste, në *Kapital*-in, “Manifestin Komunist”, e më pastaj je i lirë të mendosh e krijosh?! Kuptohet, nëse nuk arrin në Gulag, Goli Otok, Spaç ose Burrell!

Elita jonë intelektuale e gatuar deri në fund të viteve '80 ka qenë emanacion i kësaj mendësie totalitare moniste. Ajo gjithçka e shihte nga fokusi i dialektikës, i luftës së klasave... Duke u nisur nga skema marksiste trumbetonte për “parajsën tokësore”, gjegjësisht shoqërinë komuniste të tipit të *Utopisë*, *Qytetit të Diellit* ose *Atlantidës së Re*, ku gjithçka do të ishte përsosurisht e rregulluar (?), ku nuk do të kishte pronësi private, familje, shtet, kufij, fe...

Ky grupim shoqëror ka qenë i tjetërsuar nga populli dhe kultura e vet. Lidhur me këtë mund të japim një shembull sociolinguistik: Në monizëm (kuptohet, me përjashtime) kemi patur pjesëtarë të klasës së arsimuar që *lingua franca*-n e shtetit jugosllav (serbokroatishten) dhe maqedonishten e kanë folur më lirë dhe më rrjedhshëm sesa gjuhën e vet amtare (shqipen). Madje edhe kur janë përpjekur të flasin e në veçanti të shkruajnë shqip, këtë e kanë bërë duke u nisur nga ndërtimet sintaksore të gjuhës zyrtare të atëhershme. Kjo deri diku vlen edhe për aktualitetin. Lidhur me këtë fenomen, një intelektual tiranas shpeshherë me ironi më thoshte përafërsisht këtë:

⁹ Interpretim i Martin Grabmann-it, cituar nga David Knowles, *The Evolution of Medieval Thought*, Longmans, 1965, f. 88.

Inteligjencia e këndejkufirit flet “sllavishte të shqipëruar” dhe se botimet shqipe të trojeve të ish-Jugosllavisë s’kuptohen dot nga auditori shqiptar i andejkufirit.

Ish-inteligjencia jonë marksiste ka qenë e socializuar në koniunkturën shoqërore mbisunduese, kurse asociale *vis-à-vis* bashkësisë së vet. Ajo ka mohuar *geist-in*, *transcendenten*, të *Vërtetën Absolute*, ka pretenduar për “të vërtetën” e vet. Sipas Hegelit, e vërteta është një gjë që i bën ballë dhe qëndresë historisë, d.m.th është mbihistorike. E vërteta e materializmit dialektik ishte jetëshkurtër, jetoj vetëm ca dhjetëvjeçarë. Për shkak të dobësisë së postulateve, intelektualizmi i monistëve u atrofizua dhe më në fund vetë ata u desh që të bëjnë zgjedhje ndërmjet ndryshimit rrënjësor paradigmatic ose mbetjes anakronikë e fosilë.

Tranzicioni shoqëror dhe mendimtari i lirë

Tash le të mundohemi të bëjmë një analizë të marrëdhënies ndërmjet periudhës së tranzicionit shoqëror dhe profilit të mendimtarit të lirë.

Me kalimin në pluralizëm, po ajo elitë që përjetoj kolaps intelektual, filloi që të thurte epope për kapitalizmin liberal, demokracinë, tregun e lirë (*free market*), nisimën e lirë (*free enterprise*), konkurrencën, hiper-produktivitetin dhe hiper-konsumimin, globalizmin etj. U bë mbështetëse e verbër e imitimit të *modus vivendi-t* liberalist-materialist të përmbledhur në parullat *Laissez faire!* dhe “Time is money!” Ç’paradoks! Nga një dogmatizëm në një tjetër. Nga madhërimi i ekonomisë (infrastrukturës) në madhërim të ekonomisë, nga një materializëm në një tjetër. Ithtarët e “feve shekullariste” kanë nevojë të

lexojnë diç nga J. Evola, R. Winter, R. Garaudy, R. Guenon, M. Marcus, T. Lindbom etj., literaturën e krizologjisë planetare dhe të bëjnë përzgjedhjen e gjërave nga hapësira ose subjekti, të cilit duan t'i përngjajnë dhe nga i cili duan të përvetësojnë diçka. Është gabim të shohësh vetëm njërin anë të medaljes dhe “të vishesh këmbë e krye me rroba të huaja”. Revolucioni japonez i viteve '40 të shekullit XIX i quajtur Meiji dha rezultate pozitive si pasojë e sinkretizmit të suksesshëm mes elementeve vendore tradicionale dhe racionalizmit evropian. “Kapitalizmi në letër” i vendeve ish-komuniste përfundoi me ekonomi të kyçur dhe popullata të mjeruara. Vetë inteligjencia dhe masat duhet të (ç)lirohen prej *Cargo Cult*-it malinezian për anijen përplot me të mira, që do t'i shpëtonte banorët e ujdhesës.

Në kohën kur po përjetojmë shndërrimin shoqëror dhe intelektual është më se i nevojshëm formimi i kalibrit të *mendimtarit të lirë*, i cili siç thotë A. Sheriati, njih *taksonominë kulturore* të grupit të vet social. Me taksonomi kulturore nënkuptojmë shpirtin që “qeveris” trupin e diturisë, tiparet, ndjenjat, traditat, pikëpamjet dhe idealet e pjesëtarëve të shoqërisë x . Mendimtari i lirë di të identifikojë llojin e shoqërisë në të cilën jeton dhe rrethanat historike ekzistuese. Ai është antinom i intelektualit formal, i cili nuk ka vend në mesin e masave të gjera popullore dhe nuk di të komunikojë me to. Mendimtari i lirë di të ndërtojë urë të qëndrueshme ndërmjet “ujdhesës së inteligjencies dhe bregut të masave”.¹⁰ Ai di t'i dallojë vlerat e mirëfillta dhe universale nga pseudovlerat. Ai është një tip, i cili ka përjetuar procesin që M. Weber-i e quan *shpëtim nga bestytmitë*. Mendimtari i lirë angazhohet në zbulimin, nxjerrjen e rafinimin e frymës jetëdhënëse

¹⁰ Për njohuri më të gjera shih: Ali Sheriati, *Ç'duhet bërë?*, përkth. Vullnet Poshka, Rumi, Tetovë, 1999.

dhe efektive të shoqërisë, për shmangien e zvetënimit moral e kulturor, injorancës, fërkimeve dhe përplasjeve brendashoqërore, për shpëtimin nga kursi i imitimit të verbër dhe asimilimit, “lufton” kundër zbehjes së identitetit të vet. Ai dallohet nga pseudointelektualët që rebelohen kundër historisë e traditës së vet dhe mundohen “ta përparojnë” veten dhe masat duke bërë amputime të disa shekujve të historisë.

Dijetari i ndritur nuk është oportunist, nuk ka nevojë të kërkojë shenjtërim dhe bekim nga “gladiatorët e arenës politike”. Mendimtari i lirë gjithmonë e ka parasysh “qiellin plot yje mbi vete dhe ligjin moral në vete” (Kant). Intelektuali i vërtetë ka unin, sistemin dhe kulluesin e vet, në saje të të cilit i filtron gjërat. Ai s’ia paraqet dot si aksiomë nxënësit ose studentit të vet idenë naive për koincidencën si fuqi krijuese, për antropoidin ose pretendimin e Lamarkut se “gjirafës i është zgjatur qafa duke u ushqyer nga degët e drurëve”.

Intelektuali duhet të jetë feneri i shoqërisë, faktor iluminizues i saj. Ai me të gjitha mjetet në disponim duhet të cytë dashurinë ndaj librit dhe fjalës së shkruar. U trondita një ditë, kur vizitova një shkollor tonin të punësuar në një institucion shkencor dhe në sirtarët e tij nuk pashë asnjë libër!

Mendimtari i lirë shfaq produktivitetin e vet intelektual duke përdorur metodologjinë më të sofistikuar shkencore, nuk mbyllet brenda lëvores së vet dhe ndjek vazhdimisht arritjet e *raciove produktive*. Ç’fatkeqësi që në kohën kur jemi duke përjetuar tranzicionin social, nuk shohim xixat e një inteligjencie të mirëfilltë, që krijon e shkruan duke ndjekur prirjet botërore, që gjërat i interpreton në përputhshmëri me premisat shkencore, madje që kohë pas kohe opinionin e befason me zbulime e inovacione nga fusha të ndryshme. Në faqet e shtypit, perodikut

dhe botimeve të tjera në gjuhën shqipe të vendit tonë nuk trajtohen fare e le më shkencërisht subjektet e kohës sonë, si *përplasja e qytetërimeve, fundi i historisë, dialogu mes qytetërimeve, Dallga e Tretë, inteligjenca artificiale, inxhinieria gjenetike* etj. Shtëpia e vetme botuese shtetërore në gjuhën shqipe “kënaqet” duke botuar kryesisht romane e poezi dhe aty-këtu vepra me tematikë nga gjuhësia dhe historia. S’jemi kundër artit e letërsisë, por kundër redukcionizmit, kundër marginalizimit të një pjese të mirë të shkencës. Ndoshta dikush do të pohonte se pak është krijuar shkencë në eterin tonë dhe shtrohet pyetja “Ç’ të botohet?!” Nuk duhet harruar se përkthimet cilësore kanë cytur dhe gjeneruar transformime të mëdha qytetërore. Gjithashtu për vërejtje është edhe thjesht “mbushja” e skemës programore të RTVM-së (redaksia në gjuhën shqipe), kryesisht me emisione për fëmijë, emisione muzikore dhe tryeza të diskutimeve politike. Përveç llojit të emisioneve të përmendura, opinioni ka nevojë për ndriçime nga sfera të tjera të jetës. Shterpësia e mas medias gjeneron varfërinë intelektuale të kosumatorëve të “produkteve” të saj. Për këtë arsye, nëpër mediat duhet të “gravitojnë” individë që janë specializuar në degën e gazetarisë dhe me kulturë të përgjithshme, e jo të atillë me njohuri të përcipta që përdorin tautologji të trajtës “Si zhvillohen zhvillimet këtu?” dhe “Albumi juaj është mirëpritur mirë”.

Gjendja momentale në sferën e jetës intelektuale nuk duhet të na bëjë pesimistë. Të punojmë në mënyrë të pandërprerë dhe të kemi parasysh thënien latine *per aspera ad astra* (nëpër therra deri në yje).

Mijëvjeçari apokaliptik

Përgjatë periudhës kohore prej Luftës së Dytë Botërore deri në shembjen e Murit të Berlinit bota ishte shndërruar në arenë të *luftës së ftohtë* ose bipolarizmit politiko-ushtarak, i cili sipas analistit me famë botërore Immanuel Wallerstein, ka qenë vetëm farsë. Sipas tij, konfrontimet mes dy superfuqive kanë qenë vetëm trajtësore - false e jo gjë reale,¹¹ kurse “marrëveshja e madhe historike e Jaltës” pas ngadhënjimit mbi fashizmin, në fakt ka qenë kontratë për ndarje të sferave të interesit. Teorikisht pas rënies së komunizmit dhe praktikisht pas Luftës së Gjirit, kur gjiganti mediatik CNN për herë të parë tërë botës ia përcolli *live* veprimet ushtarake të forcave amerikane kundër Irakut, me të cilat SHBA demonstruan fuqinë e vet, fijet e hegjemonisë botërore tërësisht kaluan në duart e *Uncle Sam-it*. Bipolariteti u zëvendësua me monopolaritet ose monopol mbi politikën botërore. U promovuan sintagmat *New World Order* (Rendi i Ri Botëror) dhe *American Way of Life* (Mënyra e të jetuarit amerikançe). Botën e kaploi puhia e *Pax Americana-s*.

Si çdo subjekt tjetër politik, ashtu dhe shtetet vigane, kanë edhe krahun e tyre shtytës strategjik-propagandistik-shkencor, në saje të të cilit i vënë në qarkullim tezat e veta. Një prej këtyre tezave mjaft interesante që bëri

¹¹ Immanuel Wallerstein, *Liberalizmden Sonra*, Metis Yayınları, Stamboll, 1998, f. 20.

bujë në përmasa botërore është edhe ajo e amerikanit të natyralizuar Francis Fukuyama mbi “fundin e historisë”.¹² Sipas tij, SHBA në të gjitha aspektet kanë arritur kulmin e kufirin e përparimit dhe e tërë bota është e detyruar ta ndjekë këtë stil jetik e linjë qytetërimore. Pas Fukuyama-s në skenë doli Huntington-i me artikullin e botuar në vitin 1993 në revistën *Foreign Affairs*,¹³ ku fliste për përplasjen e qytetërimeve, një teori kjo konfliktuale, që për-bënte një përpjekje për krijimin e armikut të ri të Gjigantit.

G. Bush ati, pas Luftës së Gjirit, kur u sigurua *koalicioni ndërkombëtar* përdori sintagmën “Rendi i Ri Botëror”, rreth së cilës është folur dhe shkruar shumë. (S’duhet harruar që pati edhe të atillë, të cilët u shprehën se në fakt bëhej fjalë për një “kaos të ri botëror”.) E vërteta që se gjatë periudhës 1991-2001 nuk u formua një rend i ri botëror, por u jetua periudha kalimtare drejt një *rendi të ri*.

Dhe, më 11 shtator të këtij viti ndodhi katastrofa, kataklizma, tragjedia... Nga lufta *live* në terror *live*. Tërë rruzullin tokësor e përshkuan pamje që të përkujtojnë *fundin e botës* - të cilin qytetërimi modern shekullarist mundohet ta dëbojë nga kokat e njerëzve. Kuadro televizive që i lanë pa tekst edhe regjisorët, dhe skenaristët më të famshëm të Hollywood-it. U sulmuan Panteoni i fuqisë ekonomike (World Trade Center) dhe ushtarake (Pentagon-i) të “padronit botëror”. U bënë hi e pluhur dy ndërtesat, që ishin simbol i megapolisit të mistifikuar të rivierës amerikane. Me këtë u thye tabuja e paprekshmërisë së një perandorie bashkëkohore, e cila në saje të miliarda dollarëve të harxhuar “ishte e përgatitur që t’i bënte ballë edhe cyber terrorit”.

¹² Shih: Френсис Фукујама, *Крајот на историјата и последниот човек*, прев. Драган Јакимовски, Култура, Шкопје, 1994.

¹³ Shih: Samuel Huntington, “The Clash of Civilisations”, *Foreign Affairs*, 1993, vëll. 72, nr. 3, f. 20-49.

Orson Welles-i famën më të madhe e ka fituar në v. 1938 me shfaqjen në radio të veprës së H.G. Wells-it *War of the Worlds* (Lufta e botëve), në të cilën banorët e planetit Mars e sulmojnë Amerikën. Wells-i këtë sulm ia kish përcjellë auditorit amerikan aq të besueshëm, sa që me miliona qytetarë të këtij shteti i kish kapluar paniku, duke menduar se bëhej fjalë për një sulm të vërtetë. Prej atëherë deri në sulmet në Nju Jork dhe Uashington ka kaluar shumë kohë, por edhe atëherë edhe sot njerëzit ishin të mbërthyer nga trishtimi, frika, paniku dhe hutimi. Dallimi qëndron se në vitin 2001 ndodhi sulm i vërtetë dhe nga pjesëtarë të racës së njëjtë nga po i njëjti planet. Atëbotë pasojë ka qenë vetëm tronditja psikologjike, kurse sot *realiteti apokaliptik*, vdekje të trishtueshme të mijëra njerëzve të pafajshëm dhe vuajtje të të afërmeve të tyre e të çdo individi të ndërgjegjshëm anekënd botës.

Shpërthimet që shkaktuan vdekjen e mijëra njerëzve të pafajshëm, thuajse shkaktuan edhe ndryshimin e pikëpamjes së tërë botës kundrejt Shteteve të Bashkuara. Tek amerikanët lindi sindromi i të qenët botërorë, të qenët banorë të kësaj bote. Sulmi kundër simboleve të Paqes Amerikan(ç)ë para së gjithash e ka tronditur sigurinë e modernizmit. Me të u lënduan të gjitha doktrinat e sigurisë, u tregua se sa lehtë mund të nokautohet makrosistemi ekonomik universal, por ajo që është më e rëndësishme, brenda disa minutave si kullë letrash u rrënuan dinamikat psikologjike të qytetërimit bashkëkohor.

Pas kësaj date u hapërua në një botë të re, lidhur me të cilën mund të bëjmë vetëm spekulime, sepse dimë shumë pak. Një gjë është bërë e qartë: fakti se kjo botë në çdo aspekt do të jetë e ndryshme nga bota e vjetër dhe në të nuk do të vlejné kriteret e sjelljes konvencionale. Edhe pse flitej për një botë të disiplinuar, si duket, jemi duke u njohur me një *botë kaotike*.

Wallerstein-i në veprën e titulluar *Fundi i botës që e njohim* i parasheh një jetë 50-vjeçare sistemit ose rendit ekzistues ose mbisundues botëror. Ai pohon se në gjysmën e parë të shekullit XXI gjithçka do të jetë më destruktive. Sipas tij, janë tri premisa që na shtyjnë të bëjmë një parashikim të këtillë:

1. Të gjitha sistemet historike janë të vdekshme. Pra, çdo qytetërim lind, zhvillohet dhe vdes.

2. Fillimi i degëzimit të sistemeve historike është shenjë e fundit të tyre.

3. Sistemi botëror ka hyrë në një krizë vdekjeprurëse.¹⁴

S'dimë nëse parashikimi futurologjik i këtij mendimtari të njohur do të realizohet ose jo, por një gjë është e qartë: Bota po përjeton një krizë të rëndë shumëpërmasore. Sikur është harruar 'passwordi', fjalëkalimi ose kodi i lumturisë. Siç thotë Damièle Hervie Lèger, racionaliz(i)mi dhe zhvillimi i shkencave teknike, në aspektin negativ të fjalës, e kanë befasuar botën.¹⁵ Praktika përgënjeshtroi formulën *më tepër teknologji = më tepër lumturi*. Te njeriu i bashkëkohësisë sikur është ritrupëzuar Neroni, që është në gjendje t'i vërë zjarrin edhe "shtratit, qytetit dhe botës së vet në përgjithësi".

Bota mund të hyjë në një fazë tepër kritike, nëse SHBA nën presionin e ndjenjës për hakmarrje kundër kryerësve të aktit terrorist, humbin kontrollin - gjë për të cilën qarqe të caktuara këmbëngulin - dhe bien nën kurthin e "ftesës për luftë totale" ose të asaj të projektuar nga Huntington-i, luftës ndërqytetërimore.

¹⁴ www.yenisafak.com

¹⁵ Intervistë me Hervie Leger, *Le Monde Arabe dans le recherche scientifique*, Institut du Monde Arabe, mars, nr. 8, 1997, f. 11.

Kohezioni brendakombëtar si domosdoshmëri

“Populli vuan, por me vuajtje ka vendosur të fitojë.”
Ukshin Hoti¹⁶

Historia e popullit shqiptar, si një nga më të vjetrit e siujdhesës ballkanike, shënon zigzage të shumta, me pasoja që pasqyrohen deri në aktualitet.

Që prej copëtimit politik të trojeve dhe korpusit shqipfolës, i cili për nga shpërndarja hapësinore formon një shumëkëndësh, ka shkuar paralel edhe procesi i ndarjes ideore ose shpirtërore mes “organeve të të njëjtit trup”. Kjo në veçanti vlen për “periudhën e drapërit, çekanit dhe yllit pesëcepësh.” Papra është zhvilluar fushata e ftohjes dhe largimit vazhdimtar të vëllezërve të të njëjtit gjak.

Makiavelizmi shfrytëzues sllav me makinerinë e vet propagandistike është përpjekur t’i vërë në gjumë shqiptarët jugosllavë në saje të parullës “vëllazërim-bashkim”, së cilës askush s’i ka besuar pos mendjelehtëve. Kjo për arsye se çdokujt i është bërë e qartë, se në mullirin e kujt ka shkuar uji. Sistemi monist në fuqi gjatë pesë dhjetëvjeçarëve është munduar që ta shkëpusë një pjesë të një tërësie dhe ta ngjisë diku tjetër ku s’e ka vendin. Është munduar t’i zvetënojë ose tëhuajësojë shqiptarët e këndejkufirit

¹⁶ Hoti, *op. cit.*, f. 195.

dhe prej tyre të krijojë pjesëtarë të kombit artificial jugosllav, t'ua ndryshojë vetëperceptimin dhe *unë-ndjenjën*, të krijojë klasën elitiste shqiptare që sytë do t'i ketë kah Beogradi, me një fjalë, të krijojë një hendek sa më të gjerë mes pjesëtarëve dhe bashkësive të etnosit të njëjtë.

Nuk është vepruar më mirë as në Shqipërinë politike të kohës së "enverizmit patologjik". Kombi shqiptar në një periudhë prej Luftës së Dytë Botërore deri në *ndryshimet demokratike* është kamshikosur nga klika sunduese shqipfolëse antishqiptare, vuajtje këto që dhembin më shumë se të shkaktuarat nga i huaji. Monizmi ekstremist ose socializmi militant - që kish krijuar kulturë me elemente të huaja, duke i pagëzuar fëmijët Marenglen (mos të hidhërohen as Marksi, as Engelsi e as Lenini), Vladimir, vendbanimet Qyteti Stalin (si mund të harrohet Stalini!), repetitorin në Dajti - Çam Pao Y (në shenjë përkujtimi vëllezërve kinezë), kooperativat Gjergj Dimitrov etj., i kish mbërthyer gjuhës sonë të ëmbël një fjalor ideologjik (ç'thoni për fjalët e një fshatari nga zona e Shkodrës: Dilnim në *zbor*), ndërsa të veten e kish lënë pas shpine duke eskomunikuar figura të mëdha të shqiptarisë - nga koka e qytetarit të Shqipërisë kish fshirë ide në se edhe matanë kufirit jeton pothuajse gjysma e shqipfolësve dhe se ndarja politike nuk do të thotë edhe shkëputje dhe mohim i tërësishëm i një pjese të rëndësishme të trungut kombëtar. Terrori shtetëror nuk kish mëshiruar as emigrantët shqiptarë nga ish-Jugosllavia, të cilëve u kish ardhur deri në hundë etnocidi e kulturocidi sllav dhe kishin marrë rrugën për te mëma Shqipëri, ku shpesh i priste ekzekutimi nën pretekstin e të qenët ud-bashë, titistë, spiunë, revizionistë etj.

Për fat të keq ndarja, largësia dhe kundërvënia artificiale mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të ish-Jugosllavisë akoma po vazhdon të ekzistojë. Gjatë qëndrimeve

tona të shumta në Shqipëri në vitet '90, në bisedat me njerëz të profileve të ndryshme, madje edhe intelektualë, shpesh rastisnim përmendjen e triadës: shqiptarët, kosovarët dhe maqedon(a)sit, madje edhe në dihotominë *ne, shqiptarët dhe ju, kosovarët* që “hapni gropë në mes të Tiranës nën pretekstin se do të ndërtoni hotel, që na shisni makina të kalbura, që i keqpërdorni çupat tona...” Ç’fatkeqësi që punët e shëmtuara të disa individëve të pandërgjegjshëm kishin krijuar një shembëllim të keq për tre milionë shqiptarë të këndejkufirit. Të theksojmë edhe atë, se shpesh na duhej të reagonim në gojën plot të shumë korçarëve e tiranasve: *Ju, maqedonsit...* dhe t’u shpjegojmë fije për fije dallimin sociologjik mes shprehjeve *maqedonas* dhe *qytetar shqiptar i Maqedonisë*.

Erozioni shpirtëror te shqiptari ka shkaktuar rrënim të dukshme edhe në shkallaren e vlerave. Ndërsa këndej njerëzit janë kalbur nëpër burgje për hir të simboleve dhe vlerave kombëtare, një pjesë e shqiptarëve të Shqipërisë flamurin e quajnë copë bezeje, nënvleftësojnë dokumentin e vet të identifikimit dhe “vdesin” për një pasaportë italiane, greke, ndërrojnë përkatësinë kombëtare dhe fetare për një grusht dhrahmi ose lireta etj. Është për t’u shënuar se fenomeni i ndryshimit të përkatësisë kombëtare ose fetare në shkencën e psikologjisë, i quajtur *conversion*, është mjaft me peshë, i realizueshëm vështirë, rrallë dhe në momente specifike, madje kur kemi të bëjmë me kombin, i pamundshëm. Vëllezërit tanë s’çajnë kokë për një gjë të tillë, sepse “lekët janë të rëndësishëm”, për një gjë shkëputen prej shumë gjërave me vlerë jetike, si tradita, kultura, historia etj. Shto kësaj edhe problemin e të qenët jabanxhi ose i natyralizuar, i painte-gruar, problemin e socializimit në shoqëritë e huaja etj.

Duke iu afruar mijëvjeçarit të ri, të gjithë filluam të mendojmë se pasojnë ditë më të mira për shqiptarin. Por

ç'e do që problemet nisën të radhiten si në shiritin e filmit. Kriza piramidale, anarkia, pirateria, lufta në Kosovë pastaj edhe në Maqedoni. Një tablo neveritëse, apo jo?

Edhe përskaj të gjitha këtyre katrahurave, kombi shqiptar duhet të gjejë fuqi të mëkëmbet dhe ngrihet shpirtërisht, të krijojë *unin dhe identitetin e vet kolektiv*, t'i shijojë të mirat e vendosjes së demokracisë dhe konkurrencës së ideve e të mirave tjera, të shpëtojë nga kthe-trat e çoroditjes nacionale, të krijojë një *albkulturë* (kulturrë gjithëshqiptare) të mirëfilltë, themele të së cilës janë *mendësia dhe gjuba*, ajo që Hegeli e quan *Volkgeist* (shpirti i popullit), përmes saj t'i shpëtojë kundërvënies së tipit "ju, kosovarët matrapazë" dhe "ju, shqiptarët e Shqipërisë rebelë, kusarë", t'i mbajë vitale lidhjet me mërgatën nga të katër anët e botës, e cila tregoi një pjekuri të madhe në dy krizat e fundit që na përshkuan.

Pra, si çështje me rëndësi na paraqitet fenomeni i *kombëtarizimit*, përkatësisht formimi ynë si komb në kup-timin e plotë të fjalës, duke braktisur vërtitjen në rrethin me cen të divergjencave anësore. Në kuadër të këtij fenomeni një pjesë e bashkëkombasve tanë duhet ta përjetojë procesin, të cilin U. Hoti e quan "rishqiptarizimi"¹⁷, të marrin rugën e atdhetarizmit të vërtetë, të kalojnë nga axhamillëku politik në pjekuri e vetëdije të plotë socio-politike dhe t'i ndiejnë rënkimet e një pjese të popullit e të reagojnë ndryshe, e jo të dalin para opinionit botëror me prononcime (p.sh. lidhur me krizën në Maqedoni) që s'dallojnë fare nga ato të politikës serbe (ODS*-së).

Ne, shqiptarët, duhet të kalojmë nga të qenët *objekt*, pozitë kjo që ka vazhduar një kohë relativisht të gjatë, në *subjekt* të cilit do t'i dëgjohet fjala në eterin evropian dhe botëror, t'i shpëtojmë zgjedhës së etatizmit manipulues

¹⁷ *Op.cit.*, f. 175.

* Opozita Demokratike Serbe

dhe diletantizmit individual, të punojmë pandërprerë që me sukses ta realizojmë kalimin *nga shoqëria bujqësore në atë të informacionit*, edhepse na mungon një hallkë: të jetuarit në shoqërinë e teknologjisë; duhet t'i shfrytëzojmë përparimet nga kushtet e krijuara me zbehjen e kufijve politikë, si pasojë e hyrjes në epokën e globalizmit pasmodern, i cili mundëson qarkullimin e lirë të ideve dhe kapitalit, hapjen e rrugëve për komunikim më të lirë në çdo fushë të jetës, si në politikë, ekonomi, shkencë, kulturë etj.

Për të arritur më lehtë deri te pikësynimet e caktuara, gjithmonë duhet mbajtur para sysh harmonizimi i tre treguesve madhorë të ngritjes dhe përparimit njerëzor, që i thekson Gandhi: intelekti (dija), aksioni (veprimi aktiv) dhe besimi (feja dhe vendosmëria).

Globalizmi

“Natyrisht, duhet pasur frikë nga degjenerimi që i pret kulturat e përziera në njëra-tjetrën dhe nga zvetërimi, të cilin e sjell përpjekja për përshtatje.”

“Të hapurit kah bota nuk do të thotë përshtatje asaj.”¹⁸

E. Morin

Nëse ndalemi një moment dhe hedhim një sy mbi nomenklaturën bashkëkohore, do të shohim se ajo vlon nga koncepte, terma e nocione të reja, gjenerimin e përshtatuar të të cilave është e vështirë ta ndjekim. Ka kohë që flitet për një term mjaft interesant: *globaliz(i)mi*. Ky term edhe pse në aspektin leksikor është bashkëkohor, në aspektin semantik ka një histori të lashtë.

Kuptimet e kësaj shprehjeje janë botërorizim/i, hapja kah bota e jashtme ose hapje në korniza botërore. Në këtë kontekst globalizmi është antonim i lokales, vendores dhe provinciales. Supozohet se karakteri i mbyllur dhe introvert i lokalizmit mund të tejkalohet me anë të kësaj prirjeje. Mirëpo parashtrohet pyetja, a është e mundur që dallimet dhe diversitetet të zbriten në **një abstrakt/e?! Përgjigjja është se një gjë e tillë mund të jetë punë e filozofisë, kurse realiteti shoqëror nuk pranon një**

¹⁸ Edgar Morin, *Avrupa'yi Düşünmek*, Afa Yayınları, 2. Baskı, çev. Şirin Tekeli, Stamboll, 1995, f. 220, 261.

abstraksion të këtillë. Sipas sociologut turk Y. Sezen, realiteti shoqëror është barrierë që pengon hulumtimin dhe kuptimin monolit të botës (njerëzimit).

Globalizmi, nga njëra anë, është sulmuar mjaft, nga ana tjetër, është mistifikuar, madje i janë dhënë edhe konotacione mesianike. Reth këtij subjekti organizohen në botë tribuna, konferenca shkencore, simpoziume, në të cilat diskutohet gjërë e gjatë për aspektet e ndryshme të këtij koncepti, si dhe rolin e tij në sferën e marrëdhënieve brendashoqërore, ndërkombëtare etj.

Nëse kthehemi në histori dhe bëjmë një qasje nga prizmi i filozofisë së historisë, do të shohim se shoqëritë e para njerëzore të organizuara, të quajtura **polis**, **civitas** ose **cit **, kanë qenë shoqëri të mbyllura për të gjitha elementet njerëzore jashtë tyre, gjegjësisht jashtë qytetit përkatës. Athinasit e vjetër njerëzit jashtë qytetit të vet i kanë quajtur barbarë. Shumica e qyteteve të para të historisë njerëzore kanë qenë kala ose pak më të zgjeruara, por prapë të rrethuara me mure të larta. Pra, shoqëritë e para njerëzore kanë qenë të mbyllura dhe deri diku xenofobe. Por nga këto shoqëri të mbyllura (poliset), me bashkimin e tyre lindën perandoritë, të cilat në strukturën e vet ngërthenin elemente të ndryshme. Perandoritë kishin synime globaliste, donin të sundonin botën. Forca shtytëse që i injektonte dinamizëm Perandorisë Osmane ishte ‘*cih n h kimiyyeti mefk resi*’ (ideali për sundim në korniza botërore).

Skicë e pikëpamjeve planetariste-globaliste

Qysh nga kulturat më të vjetra njerëzore poashtu siç hasim në pikëpamje mikrokozme, hasim edhe ato makrokozme.

Në hebraizëm hasim pikëpamjen për “popullin e zgjedhur”, i cili duhet të sundojë dhe udhëheqë botën. Njerëzit që nuk janë çifutë duhet të jenë shërbëtorë të këtyre të parëve, në saje të të cilëve do të arrihet mirëqenia e tërë botës (?). Pra, në hebraizëm hasim në një egocentrizëm dhe etnocentrizëm të shquar çifut me karakter të hegjemonisë mbarëbotërore.

Krishterimi është një fe, e cila nisët nga ideja për gjenezën e përbashkët të njerëzimit (uniteti i njerëzimit), por tërheq një vijë, e cila i bashkon edhe besimtarët krishterë nga gjithë bota. Kjo fe planetar(ist)e mundohet ta shpjerë njerëzimin deri te një gjendje, ku do të sundojë mbretëria e Krishtit. Kjo mbretëri e mirëqenies është tërë bota. Botëkuptimi për ekumenizmin, sadoqë ka të bëjë me dialogun ndërkristian, ka edhe konotacionin e dytë, atë mbarëbotëror.

Vetë fjala ‘katolik’ do të thotë universal, mbarëbotëror. Kisha ortodokse me seli në Stamboll pretendon për gjithëbotërorësi.

Në Islam ideja global(ist)e bazohet në parimin themelor për Njëshmërinë e Zotit (*tevhîd*), i cili si refleksion të vetin ka edhe unitetin e njerëzimit në përgjithësi dhe besimtarëve muslimanë nga gjithë bota në veçanti. Rrafshi tokësor i parimit të njëshmërisë e shpreh veten në devizën për “ngritjen e Fjalës së Zotit”. Në botën bashkëkohore islame hasim në idenë ummetiste. Ummeti është bashkësia shpirtërore e besimtarëve muslimanë. Ummetizmi në fjalorin oksidental shprehet nën sintagmën ‘integritizmi islam’.

Në historinë më të re të botës, ashtu sikur kemi përpjekje për realizimin e një globalizmi pozitiv, siç janë kozmopolitizmi i mirëfilltë, të drejtat themelore-universale të njeriut, etika globale (Hans Küng), dialogu mes qytetërimeve dhe feve etj., kemi edhe ato negative, të cilat për fat të keq, disa herë janë bërë realitet ankthprurës, me pasoja trishtuese. Shembullin më mbresëlënës të një globalizmi negativ e kemi në fashizmin-nazizmin gjerman të udhëhequr nga Hitleri, i cili ideologjinë e vet e kish nxjerrë nga mendimtarë si Gobineau, Hegeli dhe Niçja. Edhe nazizmi gjerman nisej nga paradigma për 'popullin e zgjedhur,' popull ky që mendohej ta zhdukte një popull tjetër "të zgjedhur" (hebrenjtë). Gjermanët si "pjesëtarë më të zgjedhur të racës ariane" duhej të formonin shtetin e tyre me kufij botërorë.

Këtu duhet cekur edhe ideja globaliste e socializmit, e shprehur në parullën "Proletarë të gjithë botës, bashkohuni!"

Pas Luftës së Dytë Botërore, me sa duket, për të mos iu përsëritur historia e përgjakur njerëzimi kish vendosur të organizohej në korniza globale dhe u formua Organizata e Kombeve të Bashkuara, e cila nëpërmjet përpjekjeve për realizimin e programeve të veta do të mendohej që ta mbronte njeriun në tërësi dhe gjithçka që ka të bëjë me mirëqenien e tij. Pas mbarimit të periudhës eksplicite të kolonializmit perëndimor, në çerekun e fundit të shekullit XX, në skenë doli një globalizëm i ri nën parullën **New World Order**.

Në fund të mijëvjeçarit të dytë mendimtari amerikan me prejardhje japoneze, Francis Fukuyama, paraqiti teorinë e vet për "Fundin e Historisë." Sipas tij, historia e njerëzimit me kapitalizmin liberal ka arritur pikën kulmore dhe të gjitha pellgjet kulturore-qytetëruese duhet t'i nënshtrohen atij perëndimor. Njeriu, i cili duhet t'u shërbejë

si yrnek njerëzve joperëndimorë, është Homo Occidentalis Oeconomicus Axiomaticus. Çështja e tezës së Fukuyama-s është diskutuar në katër anët e botës. Një numër i konsiderueshëm i mendimtarëve perëndimorë janë të mendimit se bëhet fjalë për “mbarimin e kapitalizmit e jo të historisë së njerëzimit, sepse sistemi kapitalist i bazuar në materie i ka sjellë njeriut vetëm më tepër materie (dikujt realisht e dikujt në iluzione) e jo edhe lumturinë, për këtë arsye nuk ka edhe pse të ndiqet nga të tjerët në të gjitha aspektet e tij.”

Globalizmi - imperializëm pasmodern?!

Sipas Alvin dhe Heidi Toffler, epoka e revolucionit bujqësor e atij industrial kanë mbaruar dhe ka filluar **vala e tretë**, epoka e shoqërisë së dijes-diturisë (*societe d'information*), epoka e **shoqërisë kibernetike**. Sipas tyre, vala e tretë nuk ka të bëjë vetëm me teknologjinë dhe ekonominë, por ndikon edhe mbi moralin, kulturën dhe idetë e njerëzve.

Në një fjalor të sociologjisë thuhet se teoria e globalizmit e studion një sistem kulturor me përmasa botërore. Sipas kësaj teorie, zhvillimet kulturore nxorën në skenë kulturën globale, tiparet e veçanta kryesore të së cilës janë: sistemi satelitor i informacionit, interneti, lindja e matricave globale të konsumimit, zhvillimi i jetës kozmopolite, zhvillimi i ngjarjeve sportive të rëndësishme si lojërat olimpike, kupa botërore në futboll dhe turnetë ndërkombëtare në tenis, dekadencia e shtetit kombëtar, lindja e një sistemi ushtarak ndërkombëtar, ballafaqimi me probleme ekologjike, probleme shëndetësore si SIDA,

themelimi i organizatave si Kombet e Bashkuara, kompanitë ndërkombëtare-shumënacionale, veprimtaritë komplekse ndërmjet feve botërore, njëtrajtësia në veshje, ushqim etj.¹⁹

Sadoqë lidhur me këtë dukuri u përmendën shumë aspekte, fitohet përshtypja se më shumë bie në sy faktori ekonomik. Këtë mendim ka intelektual i frëng Alain de Benoist. Sipas tij, me daljen në skenë të kompjuterit dhe elektronikës, lëvizjet tregtare-afariste ndërkombëtare kanë arritur pothuajse shpejtësinë e dritës. Si një aktor i ri në skenë kanë dalë edhe kompanitë ndërkombëtare-shumënacionale. Në vitin 1970 numri i tyre ka qenë 7 mijë, kurse sot 40 mijë. Bëhet fjalë për aq kompani të mëdha, saqë vetë General Motors me bilancin vjetor ia tejkalon Indonezisë, Ford-i, Turqisë, Toyota, Portugalisë, Unilever-i Pakistanit, kurse Nestle, Egjiptit.²⁰ Kapitali dhe ndërmarrësit veprojnë lirisht nëpër çdo kënd të botës. Por ajo që është edhe më interesante, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore recetat e aplikuara në vendet e industrializuara ua imponojnë vendeve në zhvillim e sipër dhe me këtë luajnë rolin e mjetit për realizimin e një globalizmi sipas tekave të kompanive gjigante shumëkombëshe. Lidhur me këtë duhen cekur protestat e paradokohshme në kryeqytetin e Çekisë, Pragë, kundër FMN-së dhe Bankës Botërore. Por ç'është do që këto protesta ishin të organizuara prej anarkistëve nga shumë vende të botës, prej tipash të anomikë, me të cilët vendet e tyre kanë probleme të shumta. Kontrast, apo jo? E keqja dhe padrejtësitë (kuptohet, nëse globalizmi sjell gjëra të tilla, siç pretendojnë anarkistët) mund të luftohen vetëm nga njerëzit e mirë, sepse vetë fjala 'anarkist'

¹⁹ Gordon Marshall, *Sosyoloji Sözlüğü*, çev. Osman Akınhay-Derya Kömürcü, Bilim ve Sanat Yayınları, Ankara, 1999, f. 449-450.

²⁰ *Doğudan Batıdan Uluslararası Konferanslar Dizisi III*, Stamboll, 1998, f. 192.

ka karakter hiper-negativ, nga anarkia nuk mund të vihet në harmoni dhe prosperitet të njerëzimit.

Sipas Benoist, Perëndimi nuk shet më vetëm objekte, por edhe simbole (fetishizmi i markave dhe logove), zë, fotografi dhe logjikë 'westerniste'. Pra, njerëzve u ofrohet një botë monolite e iluzionit. Në vitet '60 të shek. XX shoqëria konsumuese jetonte vetëm me autovetura dhe mjete elektronike. Sot stili jetësor ka ndryshuar, vendin e tyre e kanë zënë parku Eurodisney, kanalet muzikore, filmat e Hollywood-it dhe interneti. Një proces, i cili duke i tejkaluar traditat dhe kulturat shpirtërore, çdo gjë e sheh si objekt shfrytëzimi, madje edhe produktet intelektuale e artistike.

Paramendoni dallimin që ka mbetur ndërmjet një pakete cigaresh dhe trupit të një femre që punon në shtëpi publike. Sistemi lëndë-boshtor edhe bisedën, në të cilën njeriu tradicional e ka shfaqur dhe kënaqur veten, mundohet ta materializojë: Një ngrënie mëngjesi e kaluar në bisedë me futbollistin e famshëm holandez Johann Cruyff kushton 100 mijë \$. Princesha Diana u bë fli e garës së gazetarëve për të nxjerrë lajme bombastike për revistat për të cilat punonin. Pra, për qarqet e ndryshme edhe jeta e njeriut, edhe ajo që duhet të mbetet e fshehtë midis personave, është bërë temë interesante dhe fitimprurëse. Një gjerman u bë temë filmi duke ofruar gruan e tij për kënaqësi njënatëshe për një milionë DM?!!

Kompanitë shumëkombëshe, të cilat nuk njohin kufij kombëtarë, bëjnë presion dhe ua imponojnë rregullat e veta shteteve e qeverive të ndryshme. Pra, globalizmi në të njëjtën kohë është një element antidemokratik. Kjo pikëpamje bazohet në ekonominë botërore, në një organizëm tregtar gjigant dhe rregulla të një tipi. Globalizmi, i cili sipas Benoist është një dukuri egoiste e materialiste, u injekton njerëzve mendimin se aspiratat e momentit të

caktuar janë pika e fundit, të cilën ata mund ta arrijnë në sipërfaqen e tokës. Njeriu i kohës së globalizmit e humb ndjenjën e realitetit dhe fillon të jetojë në një botë artificiale. Sipas Benoist, globalizmi nuk është botërorizim i mirëfilltë, por botërorizim i tregut, pra, është një lloj imperializmi. Qëllimi i përçuesve të kësaj ideje është një botë pa kufij dhe një tip i ri i njeriut, i cili nuk do të punojë, nuk do të jetë qytetar i X shtetit, një njeri i cili do të lidhet në internet, një konsumator i varur që do të shkojë në supermarket dhe do të ndajë fatin e mjegullt të njerëzimit.

Përfundim

Në letër synimet e globalizmit janë afrimi i botës, ngushtimi dhe shndërrimi i saj në një **fshat global** (global village), ku një gjë që ndodh në njërin skaj të botës, në të njëjtin moment ose një çikë më vonë do të merret vesh në skajin tjetër të saj, komunikimi më i frytshëm ndërmjet njerëzve, si dhe këmbimi i të mirave mes tyre. Sa është arritur një gjë e tillë? Në aspektin e informimit janë bërë hapa viganë, por e njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe për arritjen e një ekuilibri ekonomik në përmasa botërore. Ndërsa sipas 'Newsweek' amerikanët kanë probleme me ushqimin e tepërt (mbi 70 % të amerikanëve shkojnë nëpër klube të fitnesit për zbritjen e kilogramëve të tepërt ose mbajnë dietë në ndonjë mënyrë tjetër) dhe me rrezikun që u kanoset nga XXL-generations (brezat e njerëzve tepër të trashë), ndërsa diskutojnë për kaloritë, kolesterolin e ushqimeve të ndryshme (hamburger i madh, i mesëm, i vogël, me patate ose pa to...), diku tjetër në botë hasim në fëmijë që bredhin rrugëve duke

kërkuar ushqim nëpër kazanët e mbeturinave, në katër anët e botës vdesin me mijëra njerëz nga mungesa e ushqimit, e ujit të pijshëm të pastër, e medikamenteve etj. Ndërsa fëmijët e dikujt lundrojnë në internet, në vende të ndryshme të botës fëmijët nuk kanë as kushte elementare për shkollim, mbeten analfabetë...

Globalizmi nuk mund t'i shlyejë në asnjë mënyrë as dallimet kombëtare e as të krijojë një komb ndërkombëtar, nuk do të arrijë t'i shlyejë kulturat e nënkulturat e ndryshme, sepse ato janë diçka natyrore. Çdo përpjekje për krijimin e artificiales në sferën e kulturës është e gjykuar me kolaps; shembull konkret për këtë kemi gjuhën esperanto, e cila shumë pak ose fare nuk gjen vend midis njerëzve. Ngjyrat e ndryshme të mozaikut kulturor gjithmonë do të ekzistojnë: Anglezët do të vazhdojnë ende ta ruajnë me rojë speciale llojin e zogut, për të cilin besojnë se ruan vazhdimësinë e mbretërisë angleze, në vende të ndryshme do të festohet Hidrelezi, aborigjenët do të jetojnë jetën e vet tradicionale, indianët nuk do të konsumojnë mishin e lopës...

Filozofi spanjoll Ortega y Gasset në veprën e tij *El Tema de Nuestro Tiempo* flet për një koncept të ri: **perspektivizmi**.²¹ Gasset-i shprehet se perspektivizëm do të thotë: Realiteti ose përfundimi i arritur nga vëzhgimi i gjërave, dukurive dhe ngjarjeve varet prej perspektivës ose këndvështrimit, nga i cili shikohen të njëjtat. Pra, lidhur me gjënë e njëjtë nga njerëz të ndryshëm mund të përpunohen veçanti, që dallojnë pak apo diametralisht nga njëra-tjetra.

Kur kemi parasysh qëndrimet *pro et contra* globalizmit, parashtrohet pyetja: Vallë, teza e Gasset-it për perspektivizmin, mund të zbatohet edhe mbi globalizmin?

²¹ Ortega y Gasset, *Këtu tërësi e Isyanit*, çev. Nejat Muallimoğlu, Bedir Yayınları, Stamboll, 1992, f. 9.

Preambuliada

Neologizmi, që po përdorim në titullin e këtij shkrimi, ka kuptimin e lojërave, lajkave, manovrimeve, taktizimeve, manipulimeve dhe hesapeve të prapaskenës e nëntokës lidhur me pjesën hyrëse të aktit më të lartë juridik të një shteti, preambulën e RM-së, me një fjalë, përshkrimin e atmosferës që u krijua rreth saj.

Një periudhë kohore goxha të gjatë çdo qoshe e vendit tonë kundërmon kushtetutë, e në veçanti preambulë, tekst ky që është shndërruar në rreth me cen, ku sillet karvani politik i Maqedonisë, popullata e këtij vendi dhe bashkësia ndërkombëtare. Do të jetë interesante të shohim se sa kjo e fundit do të mund t'i durojë sjelljet mikroborgjeze të një numri të caktuar pjesëtarësh të skenës sonë politike!

Në fillim ishte lufta, e para saj *fjala* dhjetëvjeçare e padëgjuar! Dhe, nën trysinë e “të huajve” stafi i përbërë prej katër kryetarëve të partive më relevante të Maqedonisë arriti kompromisin dhe firmosi një dokument të quajtur Marrëveshja Kornizë. Faktori ushtarak shqiptar çoi në vend premtimet e veta, madje bëri edhe diç të papritur, përmbushi premtimin pa u përmbushur pjesa e premtimeve të palës tjetër. Më pas filluan sjelljet nazeqare e zigzaget e bllokut politik maqedonas, të mishëruara në deklaratat e liderëve e deputetëve të ndryshëm, në propozimin e

partive më të vogla që të organizohet referendumi, të pyetet populli, por që është irrituese, vetëm ai maqedonas?!

Dhe pas pluhurit e tymit që u ngrit për mosndryshimin e preambulës, një ditë, me shpejtësi zëri, arriti Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian dhe u mor vendimi që ajo të marrë një trajtë tjetër - një çorbë prej fjalësh që s'e kënaq shijen estetike të askujt, pasi është e përvijuar me përsëritje të fjalëve të njëjta (tautologji) - ku shqiptarët, të cilët deri para Ndodhisë (konflikteve të armatosura, të cilat s'mund të quhen ndryshe pos luftë) ishin minoritet, u shndërruan në "pjesë e popullit shqiptar që jeton në Maqedoni." Fasadë e mirë, apo jo? Madje me këtë preambulë u "popullzuan" (?) grupe shoqërore që as në ëndërr s'e kishin parë se mund të fitojnë një status social të tillë, pa kaluar fazat e duhura dhe pa përmbushur kriteret për të arritur epitetin popull!

Nga preambula e re u pa se ç'rëndësi ka njohja e Wittgenstein-it dhe e filozofisë së gjuhës, ku presjet e lidhëzat luajnë rol të rëndësishëm, përcaktojnë fate individuale, etnosesh, bashkësish fetare!

Deri te preambula e re, të cilën dikush e sheh si zgjidhje optimale, dikush si numërim në vend, e të tretët si tradhti kombëtare, u arrit nën pretekstin e trysnisë së madhe të opininit publik maqedonas, që ky komb mos të fshihet nga pjesa jonormative e kushtetutës. Kërkesa e këmbëngulja e masës së gjerë popullore mund të arsyetohen deri diku, po politikanët maqedonas? Mos vallë dikush u bëri magji në Ohër, apo ua mori sytë riviera e bukur e liqenit?! Si është e mundur, siç tha dikush, që "të bëjnë dasmë e ta harrojnë nusen?" Një nga profesorët e mi shpesh përsëriste një thënie të vrazhdë të E. Morin-it, që ma vriste veshin: "Politika është lavire!" Këtë fjalë as sot s'e firmos dot nga aspekti se politikën si "art i udhëheqjes së masës dhe shtetit drejt mirëqenies", nuk e kup-

toj në sensin makiavelian, ku qëllimi arsyeton mjetet, si shumëfaqësi legjitime, si fushë ku nuk ka vend për parime morale, por si veprimtari të ndërgjegjshme, si dhe nga respekti për politikanët e vërtetë që s'dinë apo për shkaqe të ndryshme s'bëjnë hipokrizi, të cilët kanë shkruar faqe të ndritura në histori me veprimtarinë e vet frytdhënëse. Pra, s'e parapëlqej reduktimin e kuptimit të koncepteve edhe përskaaj konotacionit negativ që disa prej tyre sot kanë marrë. Por, si t'i pagëzosh vërtitjet e kthimet për 180 gradë, gënjeshttrat e kulluara, pabesnikërinë?!

Nuk e di pse dikush mundohet të kthejë veten dhe të tjerët në *status quo*-në e kohës para Ndodhisë. Sikur asgjë s'ka ngjarë! Sikur s'u eksperimentua me qërimin e hesapeve në front. Të habit fakti se, përveç ca snobëve koleksionues autogramesh, që thonë se duhet luftuar, se s'ka ç'na bën bashkësia ndërkombëtare kur "kemi domate e specat me bollëk", ka edhe individë prej inteligjencies maqedonase që duke folur për këngët epike të thurura për ndodhurat e fundit, duke u joshur me nacional-shovinizëm, mundohen ta çojnë më përpara teorinë konfliktore për marrëdhëniet shoqërore, në vend të asaj integruese, në vend të kontratës shoqërore rusoiane favorizojnë idenë hobsiane për "luftë të të gjithëve kundër të gjithëve", pas së cilës vetëm Zoti e di se ç'do të mbetet nga ne dhe shteti ekzistues!

Në librin e fundit që jam duke lexuar, më la përshtypje sentenca e shkruar në një pllakatë të ngjitur në muret e një universiteti të famshëm amerikan, me të cilën synohet afrimi i bursistëve që vijnë nga të katër anët e botës, nga Zaireja, Porto-Rikoja, Jordania, Polonia, Shqipëria, Mali, Kina etj. Në një ambient ku sytë shohin të gjitha racat e botës, ku përfshihen njerëz me bindje, tradita, pikëpamje të ndryshme, shumë me vend janë fja-

lët: *"Humphrey fellows: Build bridges no walls!"*²² (Bursistë të Hamfrit, ndërtoni ura e jo mure!). Sa mirë do të ishte që kjo fjali me një retushim të vogël të varej në hollet e parlamentit tonë: "Politikanë: ndërtoni ura e jo mure!", e në veçanti të ngulitej në kokat e tyre.

Ç'e do që edhe me preambulën e propozuar prej presidentit prapë është ngritur një mur, sado i vogël qoftë ai, që ndan demosin e këtij vendi në "padronë" dhe "të huaj që kanë rastisur në nënqiellin e këtij shteti." Preambula dhe amendamenti rreth nenit 19, i modifikuar sipas tekave të KOM-it*, janë tregues se maqedonasit, si bashkësi që ka probleme me psikologjinë kolektive *vis-à-vis* vetes dhe të tjerëve, nën mbresat e atmosferës dhjetëvjeçare të etnocentrizmit, linguocentrizmit dhe konfesio-centrimit, me shumë vështirësi lëvizin prej vendi. Ngurtësia dhe zemërngushtësia janë faktorë që këtë vend e prunë deri te konflikti, dhe përsëritja e gabimeve të njëjta mund të shkaktojë pasoja të njëjta. Brengosës është fakti se një pjesë e maqedonasve po hebreizohen, jo në kuptimin se po pranojnë judaizmin si fe, por në botëkuptimin e vet kanë ngulitur kryefjalët (motot) boshte të ideologjisë jetike hebreje për "popullin e zgjedhur" dhe "tokën e premtuar". Një ditë nga foltorja e parlamentit dëgjuam predikimin se maqedonasit janë "popull biblik" dhe se pakicat duhet të krenohen që jetojnë pranë tyre dhe në tokën e tyre?! Edhe pse dikush tashmë po ia qep vetes petkat e izraelitëve, dhashtë Perëndia që të mos bëhemi paralele e kontureve dhe situatës që mbretëron në Lindje të Afërt! Dihet se barrierat më të mëdha para komunikimit ndërkulturor janë paragjykimet dhe vetëpëlqimi!

Në kohën kur ballafaqohemi me një realitet sterrë të zi, kur sundon histeria kolektive, na mbetet të shpresoj-

²² Ylli Pango, *Amerika*, Korbi, Tiranë, 1996, f. 11.

* Kisha Ortodokse Maqedonase

më për ditë më mira, të shpresojmë te vënia në përdorim e mendjes së shëndoshë *à propos* (në momentin e vërtetë), e cila nga amullia do të na shpjerë në “shoqërinë e ekuilibruar” dhe gjithë kjo dramë të përfundojë me një happyend, ku në vend të preambuladës, e cila “lind” vetëm abstraksione negative, do të ndjekim gjërat nga jeta konkrete, do të merremi me ekonominë politike, çështje të kulturës, si dhe shumë çështje të tjera, që do të na ndihmonin në krijimin e shtetit funksional në linjë të standardeve ndërkombëtare dhe në gjetjen e “nektarit të paqes dhe lumturisë.”

Feja në fokus

Me mbarimin e Mesjetës dhe daljen në skenë të Humanizmit, Rilindjes, Iluminizmit dhe pozitivizmit shkencor, filluan të lindin edhe tezat për fundin e fesë si një nga institucionet kryesore të shoqërisë. Në emër të shkencës u marginalizua dhe u mallkua thënia e Shën Augustinit “*Esse credimus Dei*” (Në Zot duhet besuar!). Madje pati edhe të atillë, si Comte, që kishin paraparë se tempujt do të zëvendësoheshin me fabrikat ose uzinat dhe kishin thënë se besimi fetar ishte vetëm një fazë kalimtare e vetëdijes njerëzore, që me zhvillimin e përparimin shoqëror drejtvizor do të bëhej histori, respektivisht “do të mbyllet kapitulli i së shenjtës”.

Por, rrjedhat shoqërore i përgënjeshtroan hipotezat e tilla dhe feja, shoqëruese kjo e fatit njerëzor që nga *homo primigenius-i* (njeriu i parë), e cila sipas F. Bacon-it është “*praecipuum vinculum societatis*” (zinxhiri më i fortë shoqëror),²³ vazhdoi të ekzistojë, madje të forcohej edhe më tepër dhe të luante rol mjaft me vlerë në kornizat shoqërore.

Në fund të shekullit XX sociologjia dhe psikologjia sociale përmjet metodologjive dhe teknikave të veta shkencore arritën deri te përfundimi, se një dukuri me rëndësi që dukshëm ndikon në zhvillimet shoqërore, është ajo e “kthimit të së shenjtës” (*return of the sacred*).

²³ Hans Freyer, *Din Sosyolojisi*, çev. Turgut Kalpsüz, Ankara, 1964, f. 37.

Në këtë linjë, vend të veçantë zënë fetë monoteiste, abrahamiane ose fetë e librave të shenjta: Islami, krishterimi dhe judaizmi.

Islami, si një nga fetë planetare, zë vend të çmuar në analet e historisë botërore. Ai vazhdimisht është në fokusin e qarqeve të ndryshme anekënd botës, në thjerrëzën e dijetarëve-shkencëtarëve, letrarëve, analistëve, publicistëve, grupeve të nduarata të interesit etj. Prej tij janë frymëzuar ose ndikuar Aligieri, Gorki, Tolstoj, Gëtja, Defoi, etj. Aq është interesant, saqë pjesa kryesore e disiplinës shkencore të themeluar në shekullin XIX të quajtur orientalistikë, merret me studimin e Islamit, elementeve të kulturës dhe traditës që janë produkte të këtij botëkuptimi universal.

Sot jemi dëshmitarë se dita-ditës po shtohet interesi për dukurinë e quajtur Islam, e cila po përhapet me shpejtësi marramendëse. Ndërsa në pesëdhjetë vitet e fundit numri i ithtarëve të krishterimit në përmasa botërore është shtuar për 47 %, ai ithtarëve të budizmit për 63 %, numri i muslimanëve është shtuar për 500 %.²⁴

Interesi për Islamin, qoftë nga kureshtja, nga motive të strategjisë ose asosh shkencore, në veçanti është shtuar pas ngjarjes së 11 shtatorit të vitit 2001. Muajt e fundit lidhur me këtë fe janë shkruar me qindra ese, artikuj shkencorë, janë botuar libra, shkrime të përshkuara nga profeci... Përskaaj gjërave objektive shpeshherë janë hedhur edhe ide e mendime, që as për së afërmi e as për së largëti s'kanë të bëjnë me Islamin autentik.

Pothuajse të gjitha institucionet shkencore me emër dhe dijetarët objektivë anekënd rruzullit tokësor janë njëzëri të mendimit, se bota ka nevojë **ta njohë** më për së afërmi këtë fe.

²⁴ WAMY, UN, *CLA World Facts Book*.

I prirë nga kjo, Instituti për Hulumtime Sociologjike dhe Politiko-Juridike nga Shkupi më 14 nëntor 2001, në lokalet e veta organizoi një tribunë shkencore nën titullin **“Filozofia politike e Islamit”**, ku pos ligjëruesve, morën pjesë edhe përfaqësues profilesh të ndryshme nga jeta publike.

E pamë të udhës të mundohemi që atmosferën dhe fjalën e thënë atje t’ia përcjellim në pika të shkurtra lexuesit tonë.

Ligjëruesi i parë, Stefan Kostovski, sociolog, diskutimin e vet e filloi me fjalët e Henry Bergson-it, i cili shprehet se “si në të kaluarën ashtu edhe sot mund të ketë shoqëri pa shkencë, pa art e pa filozofi, por në asnjë mënyrë nuk mund të ketë shoqëri pa fe”.²⁵ Më tutje foli për karakterin universal të religjionit, për simbolet fetare që i gjen kudo, për faktorët që e shtyjnë njeriun të jetë besimtar, për filozofinë e religjionit që fesë i qaset nga spektri ontologjik dhe gnoseologjik, për sociologjinë e religjionit si një disiplinë që studion marrëdhëniet fe-shoqëri dhe anasjelltas, ndikimin e fesë ndaj institucioneve të tjera si shteti, familja, ekonomia, kultura, koha e lirë etj. Theks të veçantë vuri mbi rolin e rëndësishëm që feja luan në qelizën kryesore të çdo shoqërie - familjen, për ruajtjen e saj, si dhe në sistemimin e marrëdhënieve bashkëshortore.

Ai poashtu foli edhe për rolin e feve në zbatimin e pushtetit, trajtoi faktin se disa prej feve në këtë aspekt janë aktive e disa për shkak të strukturës së vet e shpërfillin tërësisht politikën dhe pushtetin, siç është budizmi - i cili sipas shumë dijetarëve të historisë së religjionit nuk është fe, por një disiplinë spirituale ose ideologji - që synim përfundimtar ka kalimin në Nirvanë.

²⁵ Henry Bergson, *Ahlak ve Dinin İlk Kaynağı*, çev. Mehmet Karasan, Ankara, 1962, f. 127.

Sipas Kostovskit, protestantizmi është për ndarjen e fesë nga shteti, pra është për një shekullarizëm ose laicizëm social, kurse Islami ngulmon për shtetin teokratik.

Ky qëndrim i Kostovskit është i gabuar, ngase teokracia përkufizohet si “sundim i klasës priftërore” (*clerge*), kurse në Islam sipas një thënieje të Muhamedit (a.s.) “nuk ka priftëri”. Në fenë islame mund të flitet për një teokraci në kuptim të sundimit të nomosit (ligjit) hyjnor, që s’i përngjan fare teokracisë mesjetare perëndimore.

Më pas Kostovski foli edhe për lirinë e individit në shtetin Islam dhe, duke u shprehur në formë aksiomatike, pohoi se “Islami nuk i jep të drejtë individit”, që për mendimin tonë prapë është një e pavërtetë. Si mund të flitet për mungesë lirie në një botëkuptim, ku njeriu i rëndomtë prej masës mund ta ngrejë shpatën dhe t’i drejtohet kryetarit të shtetit (kalifit) me fjalët: “Nëse lajthit, të drejtojmë tehun e shpatës!”, ose të drejtën e gruas që t’i bëjë oponentë vendimit të kalifit, të zhvillojë me të një polemikë që do të përfundojë me fjalët e udhëheqësit shtetëror: “Ka gabuar Omeri, të drejtë ka gjuaja!”

Më tej foli edhe për rrezikun e lidhjes së nacionales me fetaren, respektivisht për krijimin e “kombit islam”, që në nomenklaturën islame njihet si ‘ummet’. Edhe këtu duhet të theksojmë se kombi klasik bazohet në vijën gjenetike, gjuhësore e kulturore të një bashkësie, kurse Islami është mbinacional, formon bashkësi shpirtërore shumëkombëshe, shumëgjuhëshe etj., që në asnjë mënyrë s’mund të pagëzohet “kombi islam”.

Ligjëruesi i dytë Hasan Xhilo, teolog, pas trajtimit të etimologjisë së fjalës *Islam* (përkushtim, nënshtrim, paqe, rehati, prehje), theksoi se Islami nuk është një kategori trans-historike, por është pjesë substanciale e historisë botërore. Islami, si ligj hyjnor, kërkon nga njeriu besim e bindje në Zotin dhe respekt ndaj Tij, përrulje e nënshtrim

të shprehur përmes adhurimit (*ibadet*). Ai paraqet afirmim të së mirës dhe mohim të së keqes, të dëmtshmes për qenien njerëzore dhe ekzistencën në tërësi. Pos këtyre dy përmasave (besimore dhe praktike), Islami ka edhe atë sociologjike, pra formon një bashkësi të besimtarëve, të quajtur ummet, që do thotë bashkësi e ithtarëve të idealit të njëjtë, atij islam.

Sabahudin Mahmudi, teolog, trajtoi pikëpamjen juridike të Islamit, gjegjësisht u orvat të parashtrojë në pikat kryesore ligjin islam të quajtur *shariat*. Pas përkufizimit etimologjik dhe terminologjik të fjalës *shariat*, foli për vendimet e këtij ligji (*ahkâm*), bëri dallimin mes shariatit dhe fikhut (shkenca mbi të drejtën islame), u shpreh se përkundër apologjetikës islame (*ilmu't-tebid* ose *ilmu'l-ke-lam*) që merret me lëmin besimor të Islamit, fikhu merret me atë të praxisit, respektivisht me trajtat e zbatimit të besimit në praktikë, të quajtura *ibâdât* (adhurime). Mahmudi tha se e drejta islame ka korpusin e vet juridik, me të cilin rregullon marrëdhëniet ndërnjerëzore, transaksionet e ndryshme mes tyre (*muâmelât*), marrëdhëniet martesore, bashkëshortore (*munakehât*), ka ligjin penal (*ukûbât*) etj. Ai vuri në spikamë edhe ndarjen e drejttimeve ose shkollave juridike të *ehl-i sunnetit* në atë hanefite, malikite, shafiite dhe hanbelite, dhe ceku se shkolla juridike hanefite, së cilës i takojnë kryesisht muslimanët e Ballkanit, i jep përparësi shfrytëzimit të mendimit ose opinionit të lirë (*re'j*).

Ai më pas foli për konceptin e pushtetit në Islam dhe shtoi se në sunizëm pushteti përkufizohet në vijën horizontale, kurse në shiizëm në atë vertikale (Zoti-imami).

Sllavenko Sasajkovski, sociolog, trajtoi subjektin e fundamentalizmit islam. Mes tjerash theksoi se fundamentalizmi dhe ekstremizmi nuk janë specifike vetëm e një pjese të muslimanëve, por edhe e shumë pjesëtarëve

të botëkuptimeve, feve, ideologjive, kulturave të tjera. Si shembull më të dukshëm për këtë ai ceku konservatorizmin protestant.

Në vend të sintagmës së famshme “fundamentalizmi islam” (pjesa e parë e së cilës /fundamentalism/ për herë të parë është përdorur lidhur me pjesëtarët e krishterimit), ai parapëlqen atë të islamologut të njohur përrëndimor Esposito, *revivalizmi* ose *rizgjimi islam*.

Ai ceku përkufizimin e dijetarit të njohur boshnjak, ithtarit të reformizmit dhe modernizmit islam, Husejin Džozo rreth xhihadit, si përpjekje për mbrojtjen, prosperitetin dhe mbarësinë e individit ashtu dhe shoqërisë, ngritjen e jetës, sigurimin e ardhmërisë më të mirë për jetë në paqë, lumturi dhe mirëqenie, instancë themelore e të cilit është lufta për ta aftësuar njeriun profesionalisht, teknikisht dhe shkencërisht, për të formuar personalitet të shëndoshë e të fortë shpirtërisht e moralisht, që do të dijë ta kryejë misionin e jetës.²⁶ Sasajkovski përmendi edhe pikëpamjet nga kjo sferë të islamologut të njohur Osman Nuri Hadžić.

Sipas tij, pos atyre që ndaj Islamit ushqejnë *bona fide*, ka edhe të atillë që, si ksenofobi Miroljub Jeftiq, i njohur për mendimet e veta kuturu lidhur me Islamin, të shprehura në veprën e tij *Džihad kao savremeni rat*, për shkaqe të ndryshme mundohen që të pikturojnë një tablo të zezë lidhur me këtë qytetërim madhor, duke folur për “mostolerancën dhe militarizmin islam.” Ai theksoi se rreziku më i madh nuk rrjedh prej vetë feve, por prej ideologjizimit të tyre.

Antoanella Petkovska, filozofe, tha se të gjitha fetë si elemente kulturore, paraqesin *botëkuptime*, narracione ose rrëfime për hierarkitë. Ajo, e ndikuar nga teoritë

²⁶ Husejin Gjozo, *Islami në kohë*, Meshihati i BI të Maqedonisë, Shkup, 1993, f. 154, 155.

konfliktuale, arriti në përfundimin se nga periudha e luftës mes klasave kemi kaluar në atë të luftës (ndër)fetare-(ndër)qytetërimore.

Pande Lazarevski, drejtor i Institutit organizator të kësaj tryeze, foli për fushatën globale antislame dhe rrëfeu për dy letra, që pas 11 shtatorit i kishin ardhur nga SHBA-të dhe Izraeli, të cilat sipas tij vlonin me emocionalitet e mllef kundër Islamit dhe s'ngërthenin asgjë të argumentuar sipas parametrave shkencorë.

Zlatko Zhoglev, sociolog, tha se pas leximit të Kur'anit në gjuhën maqedonase, ka ndryshuar rrënjësisht qëndrimi i tij lidhur me Islamin. Në të ka gjetur shumë elemente të ngjashme me ato të krishterimit, vlera pozitive për të cilat sot njerëzimi ndien etje. Zhoglevi pohoi se duhet "larë" truri nga stereotipat, nëse duam ta kuptojmë drejt këtë fe, të cilën sipas tij, disa nga pamjaftueshmëria e dijes e quajnë muhamedanizëm, në vend të trajtës së drejtë Islam, kurse ithtarët e saj muhamedanë, në vend t'i quajnë muslimanë. Ai citoi fjalët Norbert Winner-it: "Për të qenë i suksesshëm në një gjë, duhet të jesh i informuar mirë."

Zhoglevi foli edhe për rritjen e interesit në botë për Islamin, përmendi rastin e një udhëheqësi të njohur nga një kanal televiziv amerikan, i cili në emisionin e vet kish propozuar hapjen e kurseve për mësimin e drejtë të Islamit.

Nazmi Maliqi, defentolog, theksoi se fetë janë element afries e jo përçarës e as krijues kundërshtish. Shumëngjyreshmëria fetare është pasuri e jo mangësi. Kemi shembuj, kur fetë me shekuj të tërë jetojnë afër njëra-tjetrës pa u shënuar kurrfarë përplasjeje mes tyre. Këtë e ilustroi me shembullin e multikonfesionalitetit të popullit shqiptar, përkatës të Islamit, katolicizmit dhe ortodoksisë, mes ithtarëve të të cilëve historikisht nuk është shënuar

ndonjë fërkim ose mosmarrëveshje. Sipas Maliqit, keqpërdorimi dhe keqinterpretimi i feve shpien në konflikt.

Manipulimi i masave duke prekur ndjenjat fetare për synime politike është marketim i shëmtuar. Maliqi foli edhe për përpjekjet shterpe të disa qarqeve islamofobe për ta paraqitur konfliktin maqedonaso-shqiptar si pasqyrim të luftës globale mes qytetërimeve.

Autori i këtyre rreshtave, sociolog, bëri një retrospektivë në raportin feja-shoqëria, duke theksuar tipologjinë: shoqëri tradicionale, moderne dhe pasmoderne. Ai theksoi se në të parën kemi patur mbizotërim absolut të fesë, në të dytën atë absolutist të racionalizmit, homocentrizmit në vend të teocentrizmit mesjetar, pozitivizmit shkencor, kurse në shoqërinë relativiste pasmoderne kemi mozaik të elementeve të ndryshme shoqërore disa herë diametrale, përvijim të fetarshmërisë, ateizmit, radikalizmit, panteizmit, nihilizmit etj., thyerje të prangave të monolitizmit modernist, dekonstruktiv të strukturës moderne. Ai në vazhdim foli për prirjen e ringjalljes fetare në korniza globale (ku mjaft simbolik ishte takimi i Papës me Kastron më 1998, të dhënat se vetëm 20 % shi i rusëve janë ateistë, se 90 % shi i amerikanëve i luten Zotit, përdorimi i fotografisë së Jezu Krishtit nga ana e qeverisë meksikane për t'i shpëtuar të rinjtë nga humnera e narkomanisë...) ²⁷ dhe lokale. Lidhur me rritjen e shkallës së fetarisë në planin vendor, paraqiti të dhënat nga hulumtimi shkencor (tezë magjistrature), të cilin e realizoi ndërmjet viteve 1997-98, një studim terreni ose sondazh ky lidhur me fetarinë e rinisë studentore të Maqedonisë. Sipas hulumtimit në fjalë, të realizuar përmes një pyetësoi të shpërndarë 300 studentëve të dhjetë fakulteteve të Universitetit 'Shën Cirili dhe Metodi', 78 % shi i

²⁷ Ali Pajaziti, *Geçës Sürecinde Makedonya, Üniversite Gençliği ve Din Olgusu*, M.Ü., Stamboll, 1998, f. 37, 38.

studentëve besonin në Zot, kurse 76 %-shi në botën e amshueshme, vetëm 8.7 %-shi i tyre asnjëherë nuk kryenin detyrime fetare (ibadete ose rituale), 86.3 %-shi i studentëve besonin se feja nuk kundërvihet me shkencën, 79.3 %-shi i tyre ishin të mendimit se feja është faktor që siguron kohezionin shoqëror, prandaj duhet të mbështetet nga shteti.²⁸

Autori në fjalë përmendi edhe përkufizimin që i bënin romakët e vjetër fesë: *Rex extra commercum!* (Gjë joko-merciale, gjë që s'mund të bëhet objekt tregtie). Tregtimi me idetë fetare është zjarr i rrezikshëm, të cilit me të madhe po i fryjnë qarqet e ndryshme dhe mediat, të cilat duhet të jenë mjet efektiv për informimin e drejtë dhe krijimin e atmosferës së mirëkuptimit e jo nxitëse të turbullirave sociale.

Në fund, të shtojmë se është për t'u përshëndetur hapi i bërë nga ky institucion shkencor dhe shpresojmë se do të jetë një cytje për shkencëtarët e institucionet e tjera për qasje më serioze e objektive dukurive të ndryshme shoqërore, me qëllim të kthimit më të shpejtë shtigjeve të normales, mbizotërimit të tolerancës dhe respektit të ndërsjellë mes njerëzve në përgjithësi, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare, kombëtare etj.

²⁸ Pajaziti, *op. cit.*, f. 88, 121, 124.

Rex publica, kultura dhe morali

I.

Vendi ynë deri në miratimin e ndryshimeve kushtetutore të këtij viti, që pak nga pak jemi duke e përcjellë, *de facto* dhe *de jure* ishte një shoqëri që prirrej të ishte e hapur për botën, ndërsa e mbyllur për një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve të saj, respektivisht e mbyllur ndaj bashkësisë shqiptare të këtyre trojeve. Kjo shoqëri tranzicionale, duke filluar nga niveli më i ulët e deri në instancat më të larta publike, paraqiste një *rex macedonica*, çështje dhe kauzë të maqedonasve, të cilët e bënë ligjin dhe zotëronin, kurse të tjerët duhej vetëm të heshtnin, të punonin e në veçanti të pastronin. Ngulmimi në një qëndrim të këtillë elitist, që favorizonte një grup social kundrejt të tjerëve, dita-ditës po merrte trajtë të një anomie ose dukurie patologjike (Durkheim), që këtë shoqëri e shpuri deri te gjendja e lëkundjeve dhe e konfliktit ndërnacional.

Dhe më në fund, pak si pasojë e gjendjes reale në terren e ca edhe nga “predikimet” e botës që mban fjetet e politikës ndërkombëtare në duart e veta, kolltukofagët ose qarku i krerëve të makropolitikës u bind, se rrugëdalja nga labirinti në të cilin është hyrë gjendet në krijimin e një shoqërie, të cilën ati i teorisë filozofiko-politike të shoqërisë filantropike, Karl Popper, do ta kish quajtur “Open society” (shoqëri e hapur) në plot kuptimin e fjalës, që të

gjithë qytetarëve të vet u jep mundësi për ta kultivuar veten, kulturën, për t'i ruajtur vlerat e veta autentike dhe për të jetuar i lirë në vendin e vet, një shoqëri që nuk do të ëndërrojë vazhdimisht teoritë e konspiracionit, të përgatitura nga pjesëtarët e etnisë tjetër. Pra, u pa se koncepti që këtij vendi i premtonte ditë më të rehatshme është ai i *rex publica*-s, jetësimit të mirëfilltë të idesë për një shoqëri, që do të jetë çështje e të gjithë qytetarëve të saj, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare e fetare, që nuk do të bëjë shkallëzime artificiale e *a priori*.

Me siguri askush prej nesh nuk pret që, përmes formulave magjike të alkimisë, gjendja të ndryshohet përnjëherë, por një ndjenjë e stërholluar prej urtani për t'i ulur tensionet dhe për zbatimim suksesiv të asaj që është nënshkruar e miratuar do t'i pastronte kokat nga traumat disamuajshe, do ta kthente trenin e këtij vendi në binarët e normales dhe vijës natyrore.

II.

Kultura është një fushë e shenjtë dhe prekja e saj është prekje në sedër ose në nervin më të ndjeshëm të organizmit të çdo populli. Në fillim të viteve '90 duke u kthyer prej Shqipërie, në Qafë-Thanë zyrtarët kufitarë maqedonas mua dhe ca kolegëve na konfiskuan një sasi të caktuar të librave, të blerë nëpër libraritë asokohe të varfra të Tiranës, me të cilët synonim t'i pasuronim bibliotekat tona, të cilave deri në atë kohë u vinte erë botimesh të trojeve të ish-Jugosllavisë. Disa prej atyre titujve që na i morën njerëzit, të cilët s'dinin as ta arsyetonin aktin e tillë e le më të flisnin ose të pyesnin diç më thellë për natyrën dhe përmbajtjen e titujve në fjalë, s'kam arritur t'i gjej as sot e këtë ditë.

Këto ditë në një gazetë lexova se organet policore kanë keqtrajtuar disa orë një grup intelektualësh e artistësh shqiptarë, në mesin e tyre dhe njërin nga poetët më të shquar bashkëkohorë shqiptarë, Xhevahir Spahiun, që kishin ardhur si mysafirë për t'u dhënë një ngjyrë tjetërfare "Ditëve të Naimit" tonë të madh. Dikujt sikur s'i shkojnë drejt gllënkat pa bërë diç të zezë e të shëmtuar, matrapazllëqe që do të pezmatojnë edhe më tepër marrëdhëniet ndëretnike. Shkencëtari i njohur anglez Fergusson pohon se njerëzimi, pas fazës së primitivizmit dhe barbarizmit, ka hyrë në atë të qytetërimit. Me sa duket kjo e treta, për disa qarqe të caktuara te ne akoma s'ka ardhur.

III.

Morali me rrjetin e tij të normave është një ndër faktorët më të rëndësishëm për vënien e themeleve të shoqërisë së shëndoshë, kurse antipodi i tij, amoraliteti, është hap prej vigani drejt perandorisë së kaosit.

Në kohën moderne mediat janë një nga mjetet të cilat, pos familjes dhe rrethit, ndikojnë në krijimin e botëkuptimit të njerëzimit. Pra, ato kanë mundësinë që auditorit të vet t'i ofrojnë virtyte e vlera, por gjithashtu kanë mundësinë e përçimit edhe të ligësive, shëmtive dhe të vjellave të shoqërisë globale.

Kohë më parë vendet e afishimit në bulevardin kryesor të kryeqytetit bënë reklamën e një talk show-t të njëfarë "të mirënjohuri" Jerry Springer. Se ç'e ka shtyrë shtëpinë televizive shtetërore që të marrë vendimin për emetimin e këtyre kuadrove bastarduese, s'e kuptoj dot! Tematika, fama e udhëheqësit, forca tërheqëse, pragmatizmi, kthimi i rejtingut ose diç tjetër... Përsikaj të gjithave,

një gjë është shumë e qartë: gjatë minutave të dhënies së emisionit të përmendur, njeriu i shëndoshë ose ai me mendje të kulluar s'gjen dot asnjë fije të pozitivitetit ku mund të kapet. Dobia e këtij show-t qëndron në marrjen mësim se ç'perversitete mund të bëjë njeriu i kohës sonë, gjëra këto të cilat nuk janë për t'u publikuar e ekspozuar, e aq më pak për t'u reklamuar bujshëm. Është shumë keq të nxjerrësh në skenë "të mbathurat e palara" të një shoqërie. Ndërkohë që strukturat dhe institucionet e ndryshme qahen për gjendjen alarmante, për krizën të cilën është duke e përjetuar rinia jonë, dikush ia ofron katalogun djallëzor të imoralitetit, kulturën e promiskuitetit ose të lirisë absolute seksuale (të cilën s'e toleron as bota shtazarake), që shpie deri te degradimi i çerdhes së shenjtë shoqërore të quajtur familje, e me këtë edhe deri te degradimi i shoqërisë në tërësi.

Vallë, në vend të kuadrove të turpfit, a s'do të ishte më e dobishme që të jepeshinn emisione për institucione madhore amerikane me famë botërore, si Universiteti i Harvardit, ai Yale, NASA etj.?

(De)nacionalizimi i shoqërisë dhe paqja

*“Në politikë, marrja s’paraqet ndonjë prapambetje
mendore!”*

Napoleoni

Me përfundimin e epokës së perandorive dhe kalimin në atë të shteteve kombëtare, filloi procesi i lindjes së shumësisë së shoqërive politike, madje edhe syresh të papërcaktuara sa duhet dhe atomike. Shekulli XIX, apo thënë më mirë shekulli i formësimit të kombeve moderne, solli me vete edhe një mori problemesh. Bërthama e këtyre problemeve të shoqërisë bashkëkohore ishte sigla “një shtet - një komb”, e cila me vete solli zëvendësimin e sundimit të perandorëve me atë të kolektiviteteve të përkufizuara në bazë etnike.

Fenomeni i kombëtarizimit ose nacionalizimit të shoqërive është një proces që shtrihet deri në ditët e sotme. Në të katër anët e botës rastisim në tërësi kulturore ose grupime të nduarra shoqërore, që kërkojnë pavarësinë apo, thënë më mirë, bëjnë luftë për t’i vënë konturet e organizimit nacional shoqëror-politik. Shumë sish përpiqen “ta prekin” idealin, i cili ka stolitur mbamendjen kolektive të tyre që prej kohësh. Paralel me fenomenin e brumëzimit si komb, shkon edhe ai i kërkimit të rrënjëve në histori, në mite e legjenda, që shpeshherë kalon edhe në botën e një hipotetizmi imagjnativ e iluzionist.

Ideja për shoqërinë bashkëkohore që pretendon të jetë monolite, ndeshet me shumëngjyrshmërinë natyrore, respektivisht me rrallësinë ose pamundësinë e gjetjes së bashkësive njerëzore tërësisht të pastra etnike e kulturore.

Prej përpjekjeve për përkufizimin njëtrajtësor të shoqërisë pra, fillon *çështja* e amullia. Prej këtu ndihet rrymimi, tensioni e polarizimi që shkakton trazira bren-dashoqërore. Shoqëritë racionale problemin e harmonizimit të jetës sociale e kanë zgjidhur me metoda optimale e të frytshme, që nuk i brejnë as qytetarët e rëndomtë e as instancat më të larta shtetërore.

Vëzhgimi në fjalë për *socializimin e nacionalizmit* nuk është specifikë e një vendi të caktuar, por është problem me përmasa globale. Me të, mes tjerash, po përballen edhe shoqëritë e Evropës Lindore, të cilat po përjetojnë periudhën e tranzicionit social, apo të kalimit nga shoqëria e mbyllur në atë hapur, nga diktatura në demokraci, e ca prej tyre siç u shpreh një mik imi në mënyrë ironike “në demokaturë” (demokraci+diktaturë). Këto shoqëri të mahnitura nga ndryshimet e shkaktuara prej efektit domino, iu rrekën punës për t’u ndryshuar përnjëherë e hë për hë, për t’i realizuar idealet shekullore, për ta bërë atë që paraardhësit s’arritën dot ta bëjnë, për të krijuar shtete kombëtare me simbole e ornamentikë zyrtare, që përjashton multikulturalitetin e multietnicitetin.

Një nga shoqëritë e tranzicionit, e cila për fat të keq s’e zgjodhi rrugën e vendeve që përjetuan një fazë kalimtare pa trauma, si Çekia, Polonia, Hungaria, Sllovakia dhe Sllovenia, është edhe kjo jona, e cila u bë shembull *par excellence* i sistemi(mi)t jofunksional. Me t’u shkëputur nga krijesa titiste e quajtur Jugosllavi, etërit e *fundamentalizmit institucional* megalomakedonas dhe ultranacionalistë me-njëherë iu rrekën punës për ta bërë Maqedoninë një vend “shembull” për të tjerët si krijohet shteti i paqëndrueshëm

dhe si duket në praktikë dukuria e quajtur *torn country* (vend i copëtuar), vend i paragjykimeve, neverisë, mospolerancës, ku vlen simetrikja e botëkuptimit hantingtonian West-Rest, maqedonasit *versus* të tjerët; ku në vend të unit kolektiv sundon ai shovin(ist) e nacional(ist), ku totalisht shpërfilllet *Lebenswelt*-i (bota e jetës ose fusha e përvojës së përbashkët) dhe i jepet përparësi *Selbstverständnis*-it (vetëperceptimit) etnocentrik, ku lëvizja shoqërore (*social mobility*) vertikale ishte dukuri e rezervuar vetëm për “popullin e zgjedhur”, ku himni shtetëror përmend vetëm një etnos, ku parlamenti është i stolisur me piktura që kanë domethënie vetëm për një pjesë të “të zgjedhurve të popullit”, ku thuajse të gjitha institucionet zyrtarepublike janë të titulluara si maqedonase e jo si të Maqedonisë, duke filluar nga telekomunikacioni, posta, radioja e televizioni, kompania ajrore shtetërore etj. Njeriun më tepër e irriton fakti, se një politikë e tillë është ngritur në periudhën kur në botë flitet për bashkim të shteteve, për unione ndërshtetërore, për valutë gjithë evropiane etj.

Mendja politike e sëmurë një vend që akoma s’e ka të përcaktuar identitetin e vet, që ka probleme me emrin, gjë kjo madhore e çdo subjekti në skenën politike ndërkombëtare, që një dhjetëvjeçar thirret me një shkurtim shkronjor (FYROM), që u detyrua ta ndryshojë flamurin, që ka probleme ekonomike të shkaktuara nga korrupsioni brendainstitucional, gjeneroi një krizë serioze që këtij shteti adoleshent i kanosej me shpërbërje. Lidërshipi etnocentrik nga ky vend deshi të krijonte një shtet njënacional dhe teokratik mesjetar, kodet kryesore të të cilit do të ishin sllavizmi dhe krishterimi ortodoks. Ishte shumë paradoksal fakti se *shteti nebulozë*, të tjerëve, e në veçanti shqiptarëve, pamëshirshëm u ofronte parullën: “Ose duajeni këtë shtet ashtu siç e përfytyrojmë ne, ose braktiseni!”

Dhe si çdo padrejtësi, edhe kjo shkaktoi pasoja të njëjta, si moskënaqësia, pezmi, ngritja e adrenalinës... Kryengritja, përleshja, gjaku ishin faktorët përmes të cilëve një grupim shoqëror i shtypur u përpoq t'i arrinte të drejtat e veta legjitime, që mund të realizoheshin në tryezën e bisedimeve nëse (ish)kasta sunduese do të kish ndjenjën për t'i parashikuar pasojat e mundshme, që këtë vend e prunë deri te shkopi i lypësit dhe hyrja në kategorinë e "shoqërive ku ndihet mungesë e artikujve ushqimorë."

Tani kur e gjithë bota është dëshmitare e një faqeje të zezë të ditarit të këtij vendi, inspektimi dhe përmirësimi i gabimeve do të ishin rrugët më të shkurtra për krijimin e një shoqërie qytetare e sociale, ku askush nuk do të etiketohej e atribuohet si armik kujdestar. *Denacionalizimi ose depatronizimi i shoqërisë* është një segment, të cilin e përmban Marrëveshja Kornizë dhe zbatimi i të nënshkruarës është receta e vetme për kthimin e paqes dhe stabilitetit. 'Entuziazmi i fuqishëm', të cilin Max Weber e sheh si kusht të domosdoshëm për racionalizimin e jetës ekonomike e shoqërore, është një pretekst për ritymosjen e oxhaqeve të uzinave, rigjallërimin e fushave, kthimin e buzëqeshjeve... Të gjithë qytetarët, e në veçanti "pastorët", gjithmonë duhet t'i kenë parasysht *pse?*-në e së shkuarës konfliktuale, *si?*-në e gjetjes së shtigjeve të lumturisë dhe largimin nga arena shoqërore e individëve "të shquar me korrupsion dhe gabime trashanike", që vazhdimisht përsërisin refrenin "Show must go on!" (Shfaqja duhet të vazhdojë!). Nëse shoqëria nuk shpëtohet nga "mëkatarët" përgjegjëgjës për anomalitë e pranishtme, do të vërtetohet thënia e cituar e Bonapartit dhe do të vazhdojmë të vuajmë të gjithë, madje edhe në paqe.

Fenomenologjia e bashkëjetesës

“Humaniteti ka humbur. Vallë, ka mundësi t’i kundërvihemi barbarizmit dhe ta rikultivojmë atë që është njerëzore? A thua do të jetë e mundur ta shpëtojmë njerëzinë?”

E. Morin²⁹

Ende pa e mbaruar procesin e tranzicionit shoqëror, vendi ynë po përballet me një proces tjetër, atë të paqimit ose pacifikimit mes qytetarëve të vet, respektivisht gjetjes së rrugës së bashkëjetesës mes dy etnive më të mëdha: shqiptarëve dhe maqedonasve. Kjo shoqëri “e sëmure”, pa humbur kohë duhet ta gjejë ilaçin që do t’i shëronte varrat e krijuara nga dhëmbi i marrëdhënieve të ftohta ndëretnike, nga ndarja e shoqërisë në kampe me ngjyrimet nacionale, të shkaktuara prej politikës së gabuar e periudhës së paraluftës, e në veçanti nga konflikti disamujor që ishte “fryt” i kuazidemokracisë dhe i të menduarit Ku Klux Klan’çe: *Macedonian power!* Ky ilaç mbase do të jetë i hidhur për t’u pirë, por do të jetë faktor i kthimit të ditëve, kur shiriti i jetës lëviz në mënyrë të vetvetishme.

Koncepti i *bashkëjetesës* apo i *koekzistencës* në këtë kohë të pakohë, kur mjegulla të dendura po enden mbi ne,

²⁹ Данило Коцевски, “Едгар Морен-духот на времето”, *Ујирински весник*, 13 dhjetor 2001, f. 19.

kur grupimet e ndryshme janë shndërruar në guaska të mbyllura dhe njëri-tjetrin e shikojnë vëngër, kur shumicën e qytetarëve e ka kapluar plogështia, kur në ndërrijen e shumicës së qytetarëve *tjetri* (në kuptimin nacional) përfytyrohet si armik i pakompromis, me siguri se shumëkujt do t'i tingëllojnë tepër optimiste, ëndërr e shumëçka tjetër, por pa marrë parasysh këto, ia vlen që të orvatemi të vëmë një tullë të vockël, qoftë ajo vetëm përmes fjalës, në murin e ardhmërisë më të mirë.

S'do mend se koncepti i bashkëjetesës është i lidhur ngushtë me varrosjen e stereotipave e klisheve, është i lidhur me atë që W.M. Watt e quan *eirenic interpretation* (interpretim paqendjellës) të ngjarjeve, me ndryshimin e mendësisë, thyerjen e idhujve të krijuar në botën e brendshme të njeriut nga faktorët e ndryshëm shoqërorë negativë, me riprojektimin e shoqërisë, formimin e individëve që nuk manipulohen e indoktrinohen nga fushatat e ndryshme, edhe pse njeriu është qenie, siç cek Hegeli, që shumë lehtë bie nën ndikimin e të tjerëve. Lidhur me këtë, ai sjell shembullin e kalimtarit dhe qenit. Njeriu me ditë të tëra mund të kalojë pranë të njëjtit qen pa i kushuar rëndësi pranisë së tij, por nëse dikush fillon të përshtet se qeni është çartur edhe pse realiteti nuk është i tillë, tek i njëjti person aty për aty ndryshon bindja për atë krijesë dhe në kokën e tij krijohet një mbresë e pashtyeshme për qenin si rrezik i madh, i cili duhet luftuar e zhdukur. Ky shembull pasqyrohet edhe në aspektin social. Shumë bashkësi njerëzore "falë" diktateve të liderëve të vet apo strukturave të ndryshme shoqërore, krijojnë arketipa jo të vërtetë, imazhe e bindje joreale për akëcilën bashkësi tjetër që frymon ndryshe, dhe e konsiderojnë varrmihëse të identitetit të vet.

Sot, kur nën ndikimin e "gjuhës së plumbave" deri diku u thyen apo janë duke u thyer prangat e monolitizmit të

shoqërisë sonë, është mjaft me rëndësi të gjendet formula “magjike”, përmes së cilës do të hapej Dera e Sezamit dhe do të bëhej hapërimi drejt shoqërisë së vërtetë demokratike, ku njerëzit nuk do të maten sipas përkatësisë nacionale e fetare, por sipas të bëmave ose veprave të veta.

Disiplina pasmoderne e quajtur *arkitekturë ose inxhinieri sociale* mund të luajë një rol mjaft të rëndësishëm në vënien e themeleve të shoqërisë së tolerancës. Punëtorë në ngritjen e kësaj shoqërie duhet të jenë të gjithë qytetarët, të cilët dëshirojnë që përsëri të fryjnë puhizat e paqes, stabilitetit dhe mirëqenies. Mjafton që ata t’i ndryshojnë koordinatat e shikimit të gjërave, t’i flakin paragjykimet, t’i thyejnë lëvozhgat e radikalizmit, spekulimeve, halucinacioneve etj. dhe ta kuptojnë realitetin, të binden se jeta pranë njëri-tjetrit është domosdoshmëri, kurse alternativa e saj është ose largimi nga këto troje i njërit kolektivitet, ose zhdukja totale e tij, gjëra këto rrëqethëse dhe absurde, apo prapë zhdukja e këtij subjekti të ri politik si pasojë e ndarjes konvencionale ose luftarake mes dy tërësive etnike.

Për të arritur deri te shoqëria e qëndrueshme duhet që të mbillet ideja për diversitetet e dallueshmëritë, për multikulturalitetin e multietnicitetin si pasuri e jo si mangësi, duhet kultivuar ndjenja për ngritjen e urave të jetesës me komshiun nën krahët e respektit të ndërsjellë, duhet kuptuar se njëtrajtësia dhe njëngjyrshmëria kanë kuptim vetëm në mesin e shumësisë së trajtave dhe ngjyrave. Gjuhët e shumta dhe dallimet racore janë simbole hyjnore dhe lufta kundër tyre është luftë kundër natyshmërisë.

Në këtë botë shumëçka është e lidhur me ligjin e shkakësisë, duhet vetëm një çikë mençuri për ta kuptuar të vërtetën e varshmërisë së ndërsjellë mes gjërave, duhet vetëm pak urtësi që do t’i qetësonte shpirtërat duke

ia dhënë secilës bashkësi atë që i takon pa bërë rrëmujë. Në këtë kontekst më ka lënë mbresë një ilustrim kuptimplotë lidhur me temën e bashkekzistencës, që e bën Bill Ury. Le ta ndjekim:

“Sfida e bashkëjetesës, me të cilën ballafaqohet njerëzimi sot, më përkujton një tregim mistik lidhur me një njeri që pasardhësve, tre djemve të vet, u kish lënë trashëgimi shtatëmbëdhjetë deve. E kish lënë me fjalë që të parit t’i takonte gjysma e numrit të përgjithshëm të deveve, të dytit një e treta, kurse më të riut një e nënta e tyre. Djemtë u përpoqën t’i ndanin ato, por ç’e do që hesapi s’u dilte, sepse shtatëmbëdhjeta s’pjesëtohej dot as me dyshin, as me treshin e as me nëntëshin. Përnjëherë bashkëjetesa u bë e rëndë, marrëdhëniet ndërvëllazërore filluan të acarohen. Më në fund ata vajtën te një plakë e urtë dhe ia shtruan problemin. Plaka e urtë, pasi mendoj një kohë të gjatë, erdhi te djemtë dhe u tha: ‘S’di a do t’ua zgjidh problemin, por më së paku, nëse doni, mund t’u jap devenë time.’ Pasi e morën devenë e plakës, trashëgimtarët e rritën numrin e deveve në tetëmbëdhjetë dhe i pari mori gjysmën e vet (nëntë deve), i dyti mori një të tretën e vet (gjashtë deve) dhe i treti një të nëntën e deveve (dy syresh). Shuma e deveve të ndara ishte shtatëmbëdhjetë. Mbeti një deve anash, të cilën ia kthyen plakës urtane. Kështu, në saje të urtësisë u zgjidh një problem që dukej i pazgjidhshëm.”

Nëse vetëm për një çast ndalemi dhe mendojmë për rrëfimin në fjalë, do të shohim se i përngjan sfidës me të cilën përballemi, pra bashkekzistenca dhe ngritja e shoqërisë tolerante, që na duken si çështje të pazgjidhshme. Në planetin tonë banojnë mbi gjashtë miliardë njerëz, mbi gjashtë mijë grupe etnike, mbi një mijë fe e disiplina shpirtërore dhe një numër i pakufizuar ideologjish. Jetojmë në kohën me të tmerrshme që njerëzimi ndonjëherë

e ka jetuar. Pyetjet që na shtrohen para janë: Si të mësojmë të jetojmë së bashku edhe përsëri dallueshmëri? Si mund të arrijmë që dallimet t'i kuptojmë si diç afirmative?

Ajo që duhet bërë në drejtim të bashkekzistencës dhe ngritjes së shoqërisë së shëndoshë është gjetja e devësë së tetëmbëdhjetë dhe flakja e paragjykimeve.”³⁰ Në këtë kontekst rol mjaft me rëndësi mund të luajnë edhe fetë, të cilat flasin për gjenezën e njëjtë të të gjithë njerëzve, ngulmojnë në ruajtjen e marrëdhënieve të mira me fqinjin, për mëshirën, tolerancën, respektin, mirëkuptimin, bamirësinë etj.

Nëse njeriu tregon minimum vullnet për vënien në veprim të *mirësisë e urtësisë parake (primordiale)*, pyetjeve të Morinit pa hamendje mund t'u japim përgjigje pozitive!

³⁰ www.co-net.org/what_is_coexistence

Guerrizmi si patologji sociale

Shoqëria më e gjerë, qytetarë të së cilës ishim deri para një dhjetëvjeçari, jetonte nën hijen e “fitores nga lufta antifashiste”. Në të gjithçka ishte e indeksuar me luftën si një e shkuar e largët. Në epokën e “kulmit të socializmit real” i shkruheshin lajlelule e epope sistemit që kish prurë “paqe afatgjatë”. Por me të vdekur udhëheqësi i krijesës artificiale, në të cilën, siç do të shpreheshin malësorët shkodranë “tana të melat ishin mbledhur në një ven(d)”, filluan të fryjnë erëra të lehta të luftës, që më vonë do të shndërroheshin në furtuna, të cilat do të nxinin shumë familje, fise e popuj të tërë. Prej shkrepjes së pushkës së parë në Slloveni e deri më sot trojet e ish-Jugosllavisë dhe banorët e pesë shteteve të reja jetojnë me luftën, në luftë, nën pluhurin, shkrumbin e luftës, nën mjegullnajën e ligjëratës militantiste; shoqëritë e reja politike janë shndërruar në trupa kolektivë që lëngojnë nga sëmundja, të cilën do ta quanim *guerrizëm* ose nga fenomenin, të cilin filozofi frëng Bernard-Henry Levy e emërton si *bellicizëm* (antipod i pacifizmit), ku lufta shihet si kapuç i të gjitha gjërave.³¹

Ndërsa diku derdhej gjaku e virusi rritej, tek ne dhe gjetkë orakujt socialë mbinin si këpurdhat pas shiut me parashikimet e tyre se “do të ketë luftë”, “s’do të ketë luftë”, “do të na kaplojë edhe neve vërshimi”, “do të

³¹ *Ekskluzivë*, nr. 21, janar 2001, f. 61.

shpëtojmë prej thundrave të kataklizmës”, sëmundja gradualisht vinte e zgjerohej edhe në drejtimin tonë, derisa na mbështolli me krahët e vet tmerrprurës. Ndërsa më parë dukuria e luftës ishte vetëm objekt i muhabeteve këmbëkryq, atyre të kafeneve, objekt i diskutimeve pak më të nivelit, tani me të u gjendëm ballëpërballë, ajo tash ishte te ne dhe në ne. Përjetuam shndërrimin nga shoqëria guerriste *in potentio* në shoqëri guerriste *in actum*.

Pas Big Bang-ut social ose pas *armagedonit* të vitit 2001, pritej që gjithçka të ndryshonte kah e mira. Por ç’ë do që gjërat s’rrodhën ashtu siç parashikohej. Ndërsa mendohej që pas Kontratës dalëngadalë do të largohehim nga strumbullari i së keqes të quajtur luftë, qytetarët e këtij vendi u përshkuan nga një *agresion verbal ose diskursiv* i quajtur “psikozë lufte”, i transmetuar në eter nga grahësit e apokalipsit, që paraqesin katastrofë ontologjike, nga politikanët që këtij “arti” i qasen me emocione e jo me arsye të kulluar, nga mediat luftënxitëse, nga qarqet fitimsynuese, nga të pandershmit që s’çajnë kokë për telashet dhe dertet e njeriut të rëndomtë. Klika e farise-njve të kohës, për t’i arsyetuar aktet e veta të pamatura, vazhdimisht e paprerë po trumbeton një herë për aksionin gjithëkombëtar shqiptar krahas zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, të cilën ia do qejfi shumë të mbetet në hartën e motrës Serbi, pastaj lëshon siglën *pranverën e pritur ’02*, thuase flitet për një koncert, manifestim kulturor të pritur... Kjo klikë që ka përjetuar vetëharrim në aksion, që kujton se politika është det ku mund t’i grahësh anijes kah të duash, pa marrë parasysh të vërtetën se shpesh diku paraqiten edhe shkëmbinj që mund ta shkatërrojnë atë, hedh mënjanë tërë kapitalin e mundit e përpjekjeve për ta kthyer jetën në vijën e normales, për ta kthyer paqen e përmalluar, shpërfill atë që mes tjerash e ka nënshkruar edhe “lideri karizmatik”, që vazhdimisht

kërkon eutanazinë e shtetit, kryeministër i të cilit është vetë. Ai dhe apostujt e tij, politikanë të kalibrit sheshelian, s'ngurrojnë as nga thyerja e parimit kushtetutor për laicizmin, d.m.th. ndarjen e shtetit nga feja, dhe mundohen të krijojnë një simbiozë pushtetaro-kishtare duke harxhuar një milion euro për kryqin e mijëvjeçarit, parà këto edhe të myslimanit, edhe të ateistit, duke i vënë trupat speciale nën mbrojtjen e shenjtorëve të ndryshëm kristianë, duke kunguar policët e duke u dhënë pllaka të bekuara nga kryepeshkopi etj. Këta njerëz sikur s'kanë haber apo s'e kanë mësuar leksionin e lidhjes zinxhirore shkak-pasojë, që solli deri te përleshja e armatosur dhe zgjerimi i hendekut të ndarjes së qytetarëve në vija të ashpra të demarkacionit sipas ngjyrimeve nacionale-fetare. Këta helmues të masave të gjera popullore, që s'shohin tej hundës, që i anashkalojnë të gjitha ligjet morale - edhe pse mbahen për fetarë të mëdhenj - në vend të përgëzimit, popullatës i servirin lajme ogurzeza, në vend që qytetarëve t'u japin peshqesh për vende të reja të punës, ofrojnë vende të reja në petkun e forcave speciale, mbyllin fabrikat e bëjnë parada pranë tankeve... Me aktet e veta sikur mëtojnë që këtë vend ta libanizojnë ose ta trettin tërësisht. Krenohen me Lekën e Madh të tyre (?) e s'ndalen pak të mendojnë rreth *multikulturalitetit* si karakteristikë kryesore e shtetit, që kish krijuar kjo figurë e madhe historike.

Tema mbizotëruese në këto troje dhe në instancat ndërkombëtare kur diskutohet për vendet e Gadishullit Ballkanik, tregon qartë për mendësinë ballkanase, për dinamizmin negativ të *homo balkanicus*-sit. Ndërkohë që këtu flitet për çështje të dorës së tretë, bota ekonomikisht e ngritur flet për subjekte futurologjike, si plug-in cities (qytetet prizë), walking cities (qytetet e lëvizshme), intelligent space (hapësirën inteligjente), eko-qytetet të cilat

nuk do të përballen me probleme si ajri i ndotur, çështja e energjisë etj.; ndërkohë që bota mençurake flet për gjëra interesante, si pasqyra nga e cila duke u rruajtur do të mund të ndiqni lajmet televizive, për frigoriferin elektronik që do t'i çojë mesazh vetvetiu supermarketit lidhur me gjërat e mbaruara për të cilat ka nevojë familja, për tabletë e shtëpisë që ndërton Bill Gates-i, të cilat me hapin e parë të mysafirit në të, ndryshojnë sipas ndjenjës ose shijes artistike të tij e kështu me radhë,³² te ne akoma temë madhore janë politika dhe lufta.

Për t'iu larguar kësaj atmosfere dhe për të arritur pozicionin ku do të diskutojmë për çështje, në të cilat i jepet përparësi arsyes, si ato që u zunë në gojë, duhet ta braktisim dialektikën e klanizmit dhe marrëdhëniet feudale-fisnore, duhet t'i mënjanojmë faktorët që krijojnë ambient pasigurie, t'i mbështetemi pikëpamjes përfshirëse (inkluziviste), e cila përqafon dhe afron tjetrin, kundrejt asaj ekskluziviste e cila përjashton, ta largojmë politikën nga shkallarja më e lartë sociale dhe të merremi me vlera të mirëfillta, që e stërhollojnë shijen e njeriut, e nxisin atë ta lodhë kokën me gjëra që e shpien shoqërinë përpara e jo të kemi epiqendër të aktiviteteve ditore shikimin e katër ose pesë edicioneve të lajmeve. Nëse vazhdojmë me avazin e vjetër edhe më tutje, nëse aktrojmë rolin e gladiatorëve romakë, do të jemi në skajet e skenës ndërkombëtare, për ne do të vendosin të tjerët dhe si të mjerë do t'i shikojmë në sy perëndimorët, nëse kanë ni jet të ndajnë ndonjë fond "për rindërtimin e infrastrukturës së shkatërruar për shkak të mendjelehtësisë" dhe për ta zbutur sadopak vobektësinë kolektive.

³² *Beyin Firtması*, TRT 2, 3 janar 2002.

Anomalia e mosleximit, energjia pozitive dhe sitelizimi i mediave

1.

Sot, në kohën e zhvillimeve marramendëse, kur e kemi lënë mbrapa shoqërinë e teknologjisë dhe kemi kaluar në periudhën e 'shoqërisë së diturisë e shkencës', kur brenda 50 viteve të fundit është dyfishuar dituria e grumbulluar me shekuj të tërë, *leximi* si elementi më i rëndësishëm i arsimit dhe niveli i arsimit të çdo individi ose grupimi shoqëror është një nga *conditions humaines*, një nga kushtet e domosdoshme për t'i gjetur vend vetes në skenën e botës së përparuar.

Për fat të keq, vërejmë se ne, shqiptarët e Maqedonisë, çalojmë nga ana e të ushqyerit me fjalën e shkruar, në drejtim të leximit e arsimit, në të qenët në një hap me *bashkëkohësinë pozitive* nga kjo pikëpamje. Këtë më së miri "do ta ilustrojmë" me shembujt e mëposhtëm.

Gjendja është më shqetësuese, kur kemi të bëjmë me lexueshmërinë e librit si margaritar kulturor.

Këndi im më i parapëlqyer për të hedhur një sy kur gjendem në "kryeshehër" janë libraritë, e në mesin e tyre edhe e vetmja (shqiptare) në Çarshinë e Vjetër. Një gjë që e kam vërejtur, është fakti se titujt e rafteve thuajse shumë pak "humbin" që andej. Ndodh të ketë libër që një vit e më tepër qëndron aty, duke pritur dorën e lexuesit të

mundshëm. Ndoshta çmimet janë pak të larta, por edhe kjo nuk është arsye, kur e kemi parasysh të vërtetën se për cigare e kafene kurrë s'na mungojnë paratë.

Në mesin tonë rrallë mund të takoni një të ri, me të cilin mund të flisni për gjëra që kanë të bëjnë me librin, fjalën e shkruar, mendimin etj. Për ta, shumë më tërheqëse janë “calcio liga”, albumet e yjeve të muzikës, chat-i... E libri? Libri është anakroni tek ne. E blejnë dhe e lexojnë vetëm “ata që kanë luajtur mendsh”!

Ditët e para të shtatorit të kaluar, takova një nga arsimtarët e mi që tani është mësimdhënës në gjimnazin Z. L. Marku, me të cilin pas përmendjes së ca kujtimeve me mall nga e shkuara, kaluam në fushën e aktualitetit. Dhe, natyrisht “gjuha shkon aty ku dhemb dhëmbi”. Menjëherë ia filloi përshkrimit sterrë zi të gjendjes në fushën e arsimit. *Mosleximi*, mosinteresimi dhe mungesa e *patosit moral* te nxënësit, si dhe moskokëçarja e prindërve e kishin stërforcuar tek ai ndjenjën e pesimizmit për ardhmërinë tonë si kolektivitet.

Në këtë kontekst vlen të ceket edhe lexueshmëria e paktë e gazetave ditore. Më tronditën fjalët e një të punësuarit në njërin nga të përditshmet tona në gjuhën shqipe, i cili në një tribunë, me pezëm u shpreh se në mëhallën e tij ishte i vetmi që marshon me gazetën nën sqetull. Kur i marrim parasysh të dhënat se njëra prej gazetave tona shet një numër katastrofikisht të vogël të kopjeve, ky përshkrim s'na duket teprim. Shpesh ia shtroj vetes këtë pyetje: Pse në vendin ku studjova shtatë vite çdo mëngjes, rrugës, në autobus, në anije, në pesë gishtat e dorës mundje t'i numëroje njerëzit që nuk ishin “pajisur” me një ditore ose revistë, e këtu te ne lexojnë vetëm “shkollarët”. E kuptojmë të vërtetën se mediat e shkruara deri diku “shprehen” me një gjuhë specifike, të cilën mezi e marrin vesh pjesëtarët e shtresave më të ulëta

shoqërore, por a nuk duhet bërë përpjekje për t'u ngri-
tur, për ta përvetësuar "atë gjuhë allafranga" të gazeta-
risë e të "entelëve" tanë, a s'ka rubrika ku do të mund ta
gjejë veten edhe më i pashkolluari?

Si të shpëtojmë nga kjo letargji?

Le të mendojmë të gjithë! Por, edhe të punojmë...

2.

Se ndër ne ka edhe "punëtorë" plot energji pozitive,
që kanë haber për prirjet frytdhënëse, flet edhe vargu i
tribunave të organizuara në bashkëpunim mes "Komu-
nës së Sarajit" dhe shoqatës qytetare "Klubi studentor"
nga Shkupi. Në këtë kontekst publikut 'botën e tyre të
mendimit dhe diapazonin e diturisë' ia hapën figura nga
lëmenj të ndryshëm, si mjekësia, gazetaria, letërsia, teolo-
gjia, sociologjia, psikologjia etj., duke trajtuar tema me
peshë, si "Devijimet shoqërore dhe rinia", "Familja -
themeli i shoqërisë", "Etika bashkëshortore", "Femra
shqiptare ndërmjet traditës dhe bashkëkohësisë"...

Hallka e fundit e këtij vargu ishte tribuna e titulluar
"Mediat dhe ndikimi i tyre në formimin e opinionit pub-
lik", pra tubim që kishte të bëjë me mas median si faktor
me mjaft ndikim në formimin e kulturës masive.

Në këtë konferencë u fol për karakterin kompleks të
mas medias, për luftën mediatike, për mediat si mbulue-
se të problemeve shoqërore, për ndikimin e "priftërisë
bashkëkohore" (U. Ecco) në krijimin e kulturës alterna-
tive, për mediat si krijuese të mitologjisë moderne (Ho-
llywood, Monroe, Rocky, Pele, Mac Donald's, Coca Cola,
Harry Potter etj.), si krijuese të uniformitetit kulturor glo-
bal, si faktor që të rinjtë i largon nga bota e imazheve, si
element "ndihmës" i sjelljeve antishoqërore dhe dhunës,

por edhe si ndihmës i njerëzores e njerëzimit, kur e kryejnë misionin ashtu si duhet. Njëri nga ligjëruesit për këtë të fundit dha një shembull mjaft interesant. Në sulmin e parë kundër Irakut, kur Sadami i dëboi agjencitë më të njohura botërore si CNN, BBC, Reuters, përfundimi qe tragjik: një milion të vdekur; në sulmin e dytë (1998), autokrati irakian i la të lira të veprojnë në vendin e vet agjencitë e përmendura dhe për pasojë, fotografitë e mjerimit të përcjella përmes objektivit u shndërruan në trysni, që preku ndërgjegjen kolektive të botës perëndimore dhe për dy javë SHBA-të i dhanë fund sulmit, i cili la shumë pak pasoja në krahasim me të mëparshmin.

U theksua se gazetari si “transportues i lajmeve deri te publiku” së pari është njeri, me ndjenja e bindje vetjake, e pastaj gazetar; se ai nuk duhet të qëndrojë indiferent ndaj ndodhisë dhe lajmit, por duhet të jetë objektiv në atë që e nxjerr në eter. U tha se, për fat të keq, objektiviteti, në shumë raste, është një thesar i humbur për gazetarinë. U fol edhe për marrëdhënien mediat-kriza 2001 në Maqedoni, për njëanshmërinë e pjesës dërrmuese të mediave, për manipulimin e tyre me opinionin duke e keqpërdorur penën, tastierën, mikrofonin dhe objektivin e kamerës etj.

3.

Të llafosësh e të shkruash për gjendjen ekonomike në vendin tonë, kur çdo ditë mbyllet e shitet (si dhe sa, mos pyetni, se kot lodheni) nga ndonjë fabrikë ose kooperativë, nuk është ndonjë marifet.

Numri prej afro 400.000 të papunëve është rrëfim në vete. Kur kësaj i shtojmë edhe pasojat e luftës, përpara na del një tablo trishtuese. Dhe në kesi rrethanash

ndihmat e ardhura nga dhurues të ndryshëm janë si mel-hemi për varrën. Mirëpo qarqe të caktuara shtetërore s'çajjnë shumë kokën për hallexhinjtë e 'fukarallëkun' që ka vënë dhëmb mbi të gjithë ne. Mu në kohën kur elita politike përulet e "derdh lot" para institucioneve ndërkombëtare për mbajtje të konferencës së donacionit (e nga ana tjetër bën harxhime marramendëse në SHBA, sikur të ishte udhëheqësi suedeze), në njërin nga pikat kufitare kthehet prapa një dërgesë humanitare 300-tonëshe (nën pretekstin "ndihma kthehet për shkak të lëshimeve procedurale të natyrës thelbësore"), dhuratë kjo e Mbretërisë Saudite, caktuar banorëve të përfshirë nga kriza luftarake e vitit të kaluar. Lë mënjanë dëmin e shkaktuar popullatës së vet përmes privimit nga një shumë e konsiderueshme ndihme, shteti vetëshkatërrues dëmtoi edhe donatorin në vlerën prej 40.000 dollarësh, shumë kjo që duhej paguar për qëndrimin njëmuor në zonën asnjëse. Populli bukur mirë është shprehur: "Nëse s'mund të bësh mirë, më së paku mos bëj keq!"

Të gjithë e dimë se kohëve të fundit janë përdhosur edhe mediat më të moderuara. Shembull *par excellence* për këtë është ai i *Dnevnik*-ut, i cili kohë më parë e me një informacion të bujshëm kishte treguar vendin ku me siguri (?) gjendeshin kufomat e "dymbëdhjetë të grabiturve", e tani më 1 janar auditorit i ofronte një lajm tjetër sensacional, se gjoja organet shtetërore e paskan kthyer një karvan humanitar të al-Kaidës binladiniane. Shembull i qartë i *sitelizimit* të "gazetës më të shitur në Maqedoni", që dikur mëtonte të ishte zëdhënëse e shoqërisë së hapur e demokratike. Të habit fakti që "karvanin binladinian" s'paska arritur ta zbulonte një vend anëtar i NATO-s (strukturë kjo në luftë të drejtpëdrejtë me al-Kaidën) siç është Greqia, e i paskan rënë në të organet e vendit tonë!
Bravo!

Ç'lloj gazetarie është ajo, kur subjektit kryesor të trajtimit të një teme nuk i dihet emri në mënyrë të drejtë (në vend për Merhamet-in, flitet për Merhamed-in), kur pa argumente flitet se shoqata humanitare shpërndarëse e kësaj ndihme për Maqedoninë s'qenka subjekt juridik i këtij vendi, kur biografia e personave përshkruhet kuturu...

Si duket këtu tek ne s'dihet gjë ose s'dëshirohet të merret parasysh *vetëkontrolli mediatik* si një faktor i mbajtjes së drejtpeshimit të çdo medieje, si mjet për ruajtjen prej të rënit në kurthin e gazetarisë sitelçe, ku formulë mbizotëruese është kjo: “çerek gazetari dhe tre çerekët e tjerë: gënjeshtër+spekulime+shpifje”.

Dialogu mes qytetërimeve

Pas 11 shtatorit lëkurërrëqethës të vitit të kaluar, botën e përfshiu vala e dytë (e para ishte në fillim të viteve '90) e refleksioneve të ligjëratës hantingtoniane për përplasjen e qytetërimeve (*clash of civilizations*). Pas kësaj ndodhie, mbështetësit e paradigmës konfliktuale e ngritën zërin edhe më tepër, duke thirrur për hapjen e istikameve të një lufte globale “kundër terrorizmit”, “kundër varrmihësve të vlerave qytetërimore”, madje pati edhe të atillë që “favorizonin” luftën kundër një qytetërimi të tërë.

Por, në këtë drejtim nuk munguan as individët dhe strukturat, të cilat nisen nga pikëpamja për *harmoninë* si determinante e jetës në të gjitha aspektet. Rrezatime të tilla pozitive e optimiste, disa ditë më parë u përqendruan edhe në kozmopolisin euroaziatik, në vendpuqjen e kontinenteve, në Stambollin e famshëm, ku gjithherë janë takuar fetë, kulturat e qytetërimet e ndryshme.

Më 12 dhe 13 shkurt, në “kryeqytetin shpirtëror të Turqisë”, nën patronazhin e Organizatës së Konferencës Islame dhe Bashkimit Evropian, u mbajt Forumi i titulluar “Qytetërimet dhe Harmonia: Dimensioni Politik”. Tubimi në Bosfor, në një kohë kur po shënohet *inflacioni i polemikës e dialektikës ndërqytetërimore*, në momentet më kritike, siç tregon edhe motoja, arrin me mesazhin se shumë më e lirë, më e shkurtër dhe më përparuese është rruga deri te harmonia dhe mirëkuptimi, sesa ajo që

shpie deri te fërkimi e mosmarrëveshja. Ky fluid paqtues i trajtësuar nga mendimtarë, shkencëtarë e politikanë të shumtë të botës, pati për qëllim të jepte një mesazh dhe vizion për tolerancën ndërmjet vlerave e botëkuptimeve, për solidaritetin dhe miqësinë ndërmjet tërësive kulturore të ndryshme. Titujt e gazetave lidhur me këtë ndodhi e ilustrojnë më mirë natyrën e këtij forumi, ku morën pjesë me përfaqësues të vet 72 vende të ndryshme islamike dhe evropiane: “Vallja e qytetërimeve”, “Dialogu si domosdoshmëri”, “Urë e paqës”, “Shpirti i Stambollit kundrejt 11 shtatorit” etj.

Ky tubim dyditor si përbërje dhe ambient, me të vërtetë ishte mjaft domethënës e mbresëlënës. “Simbolizmi politik” i këtyre ditëve haptas shpalli se konceptet për “tjetrin” dhe “ata” si antikrisht, adresën e të cilëve e kish dhënë orientalisti i mirënjohur Edward Said, nuk do të mund kollaj-kollaj të vazhdojnë mbisundimin e vet në botën e shekullit XXI, kur pasojat e përplasjeve i përjeton gjithë njerëzimi.

Përkufizimi që bëri ministri frëng i punëve të jashtme, Hubert Vedrine, lidhur me forumin në fjalë, “Fryma e Stambollit”, e cila është metaforë e multikulturalitetit dhe shumëngjyrshmërisë, paraqet një platformë krijuese, në veçanti në drejtim të afrimit të dy qytetërimeve madhore: atij islam dhe atij perëndimor.

Interesant ishte fakti se tubimit, ndoshta me qëllim të mbrojtjes prej keqinterpretimeve për “forumin si ekuilibrim strategjiko-politik të BE-së kundruall Shteteve të Bashkuara”, iu dha një frymë joformale, jozyrtare. Përpjekjeve për institucionalizmin e konferencës së zënë ngojë, një zyrtar i lartë perëndimor iu përgjigj: “Sot s’kemi nevojë për burokraci. Fryma e Stambollit do t’i hapë udhën një dialogu të bazuar në respekt të ndërsjellë. Pas 11 Shtatorit jemi të detyruar ta fillojmë një dialog të këtille.

Mosmarrëveshjet historike ndërmjet Islamit dhe Perëndimit kanë krijuar disa armiqësi por, në ndërkohë kanë sjellë edhe mirëkuptim. Keqkuptimet mund t'i tejkalojmë në saje të tubimeve të kësaj natyre”.

Sipas disa analistëve, ky forum bëri me dije se qoftë nga motive pragmatike (bota islame që numëron mbi 50 shtete me mbi një miliardë e gjysmë banorë-konsumatorë është një treg mjaft tërheqës e fitimprurës) qoftë nga syresh idealiste-humaniste-filantropike, dalngadalë është duke ndryshuar paradigma për të ashtuquajturën “botën e tretë” si statistë dhe anësore e faqes së romanit botëror. Njëri nga pjesëmarrësit e forumit, shkencëtari i mirënjohur Bernard Lewis, u shpreh se një zhvillim me peshe është fakti se “tanimë nuk flitet për një qytetërim, por për qytetërime(t)”, për faktorë, qoftë edhe vetëm formalisht, të barabartë, të cilët pa komplekse ulen e diskutojnë për një ardhmëri më të mirë të njeriut.

Fjalët e Lewis-it janë mjaft kuptimplota dhe sfidojnë e vënë në shënjestër pikëpamjen, e cila qytetërimin e kufizon(te) brendapërbrenda gjeografisë Los Angeles-Londër, kurse pjesën tjetër e cilëson(te) si dekadente, joracionale, barbare etj., shprehje këto që edhe më tepër e zgjeronin largësinë mes tërësive civilizuese.

Përvoja historike, e cila është mësuesi më i mirë, ka treguar se mendësia konfliktuale sjell vetëm dëm, se “dy gurë të ashpër s’e bluajnë dot drithin”, se shikimi i gjërave nga prizmi i asaj, që F. Bacon e quan idhulli i shpellës (*idola specus*),³³ sjell vetëm subjektivizëm, puritanizëm mesjetar, dogmatizëm jakobinian, njëanshmëri, polarizim e pasiguri ekzistenciale, kurse hapja e horizonteve dhe respekti i ndërsjellë janë dërrasë kërcimi deri te *mirëqenia dhe paqja*.

³³ Frensis Bejkën, *Atlantida e Re*, përkth. Sulejman Drini, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 21.

Me sa duket, tubimi më tepër ka qenë i prirë nga arsyeja e *think tank*-ëve, pra ka qenë ideim i elitës intelektuale, por fjalori i përdorur më tepër ka patur bojë politike. Kur kemi parasysh se në epokën e bashkëkohësisë janë politikanët ata që vendosin për fatin e bashkësive etnike e kulturore, mund të themi që nëse ata (politikanët) me të vërtetë janë ndikuar nga fryma e intelektualëve të mirëfilltë e qëllimmirë, nëse ky organizim nuk mbetet vetëm një ndodhi e rëndomtë historike por paraqet ngritje e spirancës së anijes së mirëkuptimit, botën dhe njerëzimin i presin ditë më të mira.

Duhet theksuar se Forumi i Stambollit ishte verifikim i tezës, se një nga tiparet kryesore të këtij shekulli, kur bota është “zvogëluar e ngushtuar”, është domosdoshmëria e bashkëjetesës së kulturave dhe feve të ndryshme, se faktorët si teknologjia e sofistikuar, transaksionet ndërkombëtare, migrimet, etj. e kanë bërë të pashmangshme “rrjetën e të jetuarit me tjetrin”.

Edhe pse ky tubim nuk ishte i pari i kësaj natyre, kur kemi parasysh gjendjen e tensionuar në korniza globale, në veçanti mes botës islame dhe asaj perëndimore, mund të cilësohet si ngjarje me rëndësi me gjasa për të sjellë shtendosje dhe freski në marrëdhëniet ndërqytetërimore dhe ndërnjerëzore.

Harry Potter: libri i shfryrjes së fantazisë

“Truri im ndonjëherë më befason edhe vetë mua!”
J.K. Rowling³⁴

Shoqëria moderne prej tradicionales dallohet me racionalitetin e vet. Sociologu i njohur gjerman Max Weber, si një nga tiparet kryesore të kësaj shoqërie kishte theksuar procesin e eliminimit të bestytnive dhe marginalizimin e asaj, që është pjesë e botës magjike. Por faktet flasin që edhe në kohën e teknologjisë më të sofistikuar, njeriu shpesh kalon në ujërat e imagjinatës e fantazisë, në sferën e irracionales, di të abstragohet nga imantentja. Madje përshkrimet e shoqërive të ashtuquajtura primitive animiste, ataviste, të bëra nga antropologët dhe etnologët e ndryshëm, gjejnë vend të merituar në mejdanin e shoqërive më të përparuara ekonomikisht, ku flitet për racionalitet skajor. Ekzotika e Orientit është një simbol, i cili ka lëshuar rrënjë të thella në frymën e botës bashkëkohore. Këtu duhen përmendur edhe mitologjia dhe legjendat e shumta, si ato greke, hinduse, jugamerikane, afrikane etj., që shpesh na shpien në një univers tjetër.

Dikur, por edhe sot deri diku, në qarqet e letërsisë e artit diskutohej për qëllimin e krijimit artistik. Dikush

³⁴ J.K. Rowling, *Хари Поттер и каменой мудростіа*, прев. Благородна Богеска-Анчевска, Култура, Shkup, 2001, f. 254.

pohonte se art bëhet vetëm për hir të artit, kurse disa të tjerë shpreheshin se arti bëhet për shkak të leverdisë. Sot, kur dizgjinat e sundimit i mban *homo economicus*-i, pikëpamja idealiste për artin, e në këtë kontekst edhe për letërsinë, e shprehur në sintagmën *l'art pour l'art* (arti për art) me sa duket, është marginalizuar dhe zbehur tepër. Tanimë mbretërinë e saj e ka kurdisur arti i komercializuar, letërsia që bashkëpunon me industrinë botuese e filmike, e cila edhe atë më të ndjeshmen, më shpirtëroren e bën gurrë të bankënotave jeshile.

Kohëve të fundit anakënd botës po bëhet fushatë e madhe mediatike për bestsellerin e J. K Rowling-ut, të titulluar *Harry Potter and Philosopher's Stone* (Harri Poteri dhe guri i filozofit), i cili tani për tani ka arritur të ngrihet në vendin e dytë në listën e filmave financiarisht më të leverdishëm (afro një miliardë \$).

Të përfshirë nga kjo rrëmujë edhe ne, pasi trajtës së shkruar gjithherë i japim përparësi ndaj versionit filmik, ku shikuesit për shumë shkaqe i ngushtohet horizonti i të menduarit, pas të futjes në dorë të veprës në fjalë, iu rrekëm leximit të saj, kureshtarë për brendësinë, në veçanti të nxitur nga pjesa e dytë e titullit ku përmendet guri i urt(ës)isë.

Në këtë roman, të cilin Wendy Cooling e quan të çuditshëm, kryepersonazh është një djalosh bonjak, për të cilin kujdeset teza me të shoqin, që kanë një fëmijë lazdran, Dadli (Dudley), i cili s'do ta shohë me sy Harritin. Fëmijën jetim ata e ruajnë në një dollap muri, e ushqejnë në mënyrë jokorrekte, e veshin me rroba të mëdha e të vjetra të trashuqit të vet, Dadlit.

Gjithçka fillon me një letër, e cila i vjen Harrit nga një hut. Kujdestarët e marrin letrën dhe mundohen të mos ia tregojnë djaloshit, të cilit fillojnë t'i vijjnë shumë letra të tjera nga të gjitha anët. Shpëtimin e gjejnë në një

hotel, por edhe atje i pret rrëmuja e letrave të tjera. Ikin në një ishull, ku vjen një rojtar i një shkolle të magjistarrëve, i cili ua tregon historinë e vdekjes së prindërve të djaloshit dhe arrin “ta bindë” familjen që ta lejojnë të shkollohet në Hogwarts, një kështjellë me shumë kulla e kupola, në shkollën e magjisë. Harri arrin në vendin e caktuar, fillon të mësojë, por edhe atje e presin sfida të shumta. Gjen kundërshtarë dhe dashamirë, me të cilët i kalon ditët. Fillon të mësojë zanatin e magjisë, atë të fluturimit me fshesë, sportin e kvidiçit, interesohet për gurin e urtësisë, i cili mineralet i shndërron në ar dhe njeriun e bën të pavdekshëm, përfshihet në një dyluftim të rrezikshëm. Pas shumë peripecive, arrin ta kuptojë të vërtetën për prindërit e vet dhe gurin magjik, të cilin “e fiton vetëm ai që e do ta gjejë, e jo ai që e do ta shfrytëzojë”³⁵, ngadhënjën si pjesëtar i ekipit të vet sportiv, si personazh përballë forcave negative dhe e ruan linjën e famës familjare.

Ajo që përnjëherë na ra në sy në këtë libër përplot me befasi është përpjekja e autorit, që lexuesin ta largojë nga realiteti e ta shpjerë në një botë tjetër, ku nuk vlejné ligjet e përditshmërisë sonë, në një botë ku ballafaqohemi me gjëra jo të zakonshme, si biseda me shtazët, fluturimi i njeriut në saje të fshesës, mure që lëvizin, dyer që me të lutur hapen, figurat e shahut që flasin, libra që piskasin, qeni me tre kokë, zogj që shndërrohen në çelësa dyersh, copë bezi që të bën të padukshëm, shtriga, pasqyra ku në vend të vetvetes mund të shohësh prindërit e vdekur etj.

Rowling-u me një stil paksa të ngjashëm, si ide, me atë të *Utopisë* dhe *Atlantidës së Re*, e shpie lexuesin në një ishull ku arrihet me varka, në një botë parajsore ku i gjen

³⁵ Роулинг, *op.cit.*, f. 254.

të gjitha ushqimet më të shijshme të shtruara në pjata dhe pijet në kupa floriri..., por edhe në një ambient të shoqërisë së ashtuquajtur arkaike-totemiste: dhëmbë gjarpërinjsh, qime të njëbrirëshit, pupla të bishtit të feniksit, damarë të zemrës së kuçedrës etj.

Libri ka karakter rrëfyes të bujshëm, por vuan nga mungesa e mesazhit të çiltërsuar. Në të s'arritëm të shënojmë më tepër se dy-tri fjali që të bëjnë të lodhësh kokën e të urtësohesh. Autori këtë ndoshta e ka bërë me qëllim për të mbetur në nivelin e mocanikëve të Potter-it si lexues të mundshëm më të pasionuar të kësaj vepre.

Shikuar nga prizmi i pedagogjisë, lexuesit të ri i ofron edhe idenë pozitive, edhe atë negative: kryerja e detyrave të shtëpisë vetë³⁶, endja nëpër bibliotekën e madhe, konsultimi i librave, mësuesi që mundohet ta vjedhë thesarin e fshehtë³⁷, familja që fëmijën e huaj e keq-trajton, e përçmon... Shikuar sociologjikisht, autori jep një pikturë të një shtresimi social, i cili të kujton atë të hinduizmit; në pozitë të brahmanëve janë magjistarët. Në libër, pra, përvijohet ideja elitiste e trupëzuar në magjistarët si simetri e inteligjencies bashkëkohore dhe magjia si kryeshkencë. Rowling-u, i prirë nga fakti shoqëror për sportin si një faktor mjaft tërheqës për të rinjtë e kohës sonë, shumë përtej hobit, i cili i bën që javën ta programojnë sipas ndeshjeve të ndryshme, një pjesë të konsiderueshme të veprës ia kushton një loje me shtatë lojtarë e me disa topa, të cilët duhen gjuajtur në portat e caktuara. Ajo luhet duke fluturuar lart mbi tokë në saje të fshesave, ndërsa publiku i stadiumit deri në përfundim të veprës e ndjek me frymëmarrje të përshpejtuar. Autori ka përshkruar një kampionat vjetor, që të kujton kampionatet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, mes

³⁶ *Op.cit.*, f. 154.

³⁷ *Op.cit.*, f. 155.

katër ekipeve kundërshtare - të emërtuara sipas emrave të kafshëve – të cilat luftojnë për të fituar kupën e madhe si kulm i prestigjit dhe kënaqësisë në një rreth të tillë.

Në vijën e odiseadës së Harrit, në një atmosferë ku nuk përmendet fare elementi fetar, na paraqitet edhe një ngjyrë kristiane, kremtimi i kërshëndellave (refleksion i “reduktimit” të fesë në shoqërinë laike) si element mjaft tërheqës, në veçanti për botën e virgjër të fëmijëve.

Në librin në fjalë, në vend të fantastikës shkencore aktualizohet ajo tradicionale, në vend të anijeve kozmike, multimedias e të ngjashmeve, na paraqiten shkopinjtë magjike, pijet e ndryshme ekzotike dhe mjeshtëritë e magjistarisë.

Nëse lexuesi do të përpiqej të mendonte një çikë më hollë, në këtë roman do të gjente elemente të shumta të një aksiologjie jetike (e drejta çdoherë ngadhënjën), ontologjie (kush jam unë?), gnoseologjie (çështja e dijes), metafizike (shpirtërat), atë të eklektizmit e sinkretizmit (ngjizje e pjesërishme me stilin gaardarian dhe atë coelhoian), të enciklopedistëve islamikë/el-ihvanu’s-safa/ (biseda me kafshët) etj.

Radhitja e *Harry Potter*-it ndër veprat më të shitura dhe filmat më të shikuar deri diku flet për veprën në fjalë, të bën kureshtar ta lexosh, të shpie në një udhëtim të çuditshëm, por nuk të lë përshtypjen e një kryevepre që me çdo kusht dhe çdokush duhet ta lexojë. Sidoqoftë, guri alkimik si metaforë e arritjes së pasurisë së pafundme dhe përjetësisë, si dy çështje të filozofisë jetike të shumëkujt dhe si bërthama e veprës, edhe një herë nxisin në drejtim të së pamundshmes, në drejtim të një idealizmi që ka herë e shoqëron këtë krijesë enigmë (A. Carrel), e cila përpiqet të gjejë enigmën e jetës dhe balsamin e lumturisë, ca herë me sukses e ca herë duke u rrokullisur në humbëtirë.

Tranzicioni i dytë: më tutje si?

Maqedonia, pas rrënimit të sistemit monist kaloi nëpër një periudhë kohore të *transformimit*, apo thënë më mirë, të tranzicionit social të pasuksesshëm thuajse në të gjitha sferat jetike, si në politikë, ashtu edhe në ekonomi, kulturë etj., periudhë kjo e *tranzicionit të parë shoqëror*. Gabimet strategjike, në veçanti ato të bëra në sferën e marrëdhënieve ndërnacionale, çuan te konflikti i vitit të shkuar, që i ka stërftohur marrëdhëniet edhe ashtu të ftohta ndërmjet dy bashkësive më të mëdha etnike të vendit tonë. Madje mund të thuhet se përplasja disamujore e ka zbehur edhe atë pak konsideratë që ekzistonte për *tjetrin* në “botën” e çdo pjesëtari të dy etnive më të mëdha. Tani edhe njeriu më kozmopolit dhe më zemërgjerë vë gishtin në kokë dhe i kredhur në mendime, i shtron vetes disa pyetje: Më tutje si? Si do të jetohej pa e lënduar ose pa e dëmtuar atë cipë të hollë, e cila na ndan nga përplasja rishtazi? A mund të ndodhë që diç e vogël, akt i pamatur ose provokacion me frymë nacional(ist)e, e cila e prek kolektivitetin tjetër, të shkaktojë trazira të përmasave të mëdha? Vallë, a është e mundur nga kokat e qytetarëve të fshihet e gjithë ajo që ka ndodhur në historinë pak më të largët, si dhe në atë aktuale? Dhe kështu vazhdon vargu i pyetjeve...

Tani kur jetojmë nën hijen e Marrëveshjes së Ohrit, e cila është simbol dhe pikënisje e një procesi, që nga prizmi sociologjik mund të quhet *procesi i tranzicionit të dytë*

shoqëror, pra, tranzicioni nga shoqëria njënacionale dhjetëvjeçare në shoqëri të hapur, shumëkombëshe dhe demokratike të mirëfilltë, një gjë është më se e qartë: nëse banorët e këtyre tokave duan të jetojnë edhe më tutje pranë njëri-tjetrit pa kokëçarje e në rehati, nëse duan të krijojnë ardhmëri me ditë më të bardha se këto të sodit, duhet të ndalen dhe të trazohen, të çlirohen nga do kallëpe ataviste e klanore, duhet t'i flakin disa tabu, t'i eliminojnë "viruset" e mendësisë ballkanase ku, siç shprehet një dijetar malazias, "konsequenca në devijim konsiderohet virtyt".³⁸

Një gjë tepër me rëndësi është edhe ajo, që grupi etnik i cili veten e konsideronte 'baba' të këtyre trojeve, duhet ta kuptojë të vërtetën se patriotizmi dhe krenaria kombëtare nuk ndërtohen duke i shtypur ose nëpërkëmbur grupet etnike dhe kulturat tjera, por duke e mbrojtur vendin nga tensionimi dhe mosmarrëveshjet, të cilat çojnë deri në humnerë, se atdhedashuria më e madhe është ruajtja e vendit nga vetëshkatërrimi. Faktori maqedonas duhet t'i shpëtojë kompleksit "të fitores së penguar nga të huajt", kompleksit për "hakun që duhet marrë për komplotin, të cilin ia bënë shqiptarët këtij vendi në vitin 2001", atij "një pushkë më tepër, rritje e nivelit të sigurisë dhe mbrojtjes nga separatistët/terroristët", duhet që fjalorin e vet zyrtar dhe të përditshmërisë ta pastrojë nga etiketimet e ndryshme të pamatura e fyese.

Shteti si një institucion ombrellë, duhet të zgjedhë një politikë të arsyeshme, një politikë e cila do të mbrojë *cilësinë e jo përkatësinë* e as ngjyrat ideologjike, fetare, kombëtare, e cila në vend të pyetjes "kush është?" do të shtrojë atë "çka mund të kontribuojë?".

Politika shtetërore e baraslartësisë ndaj grupeve sociale, e demokracisë institucionale, është një vijë që i shton pikat

³⁸ Intervistë me Novak Kilibarda, *BH Dani*, nr. 248, 15 mars 2002.

e optimizmit për stabilitet dhe zhvillim, nga i cili do të kishin dobi të gjithë qytetarët. Inteligjencia dhe institucionet shtetërore duhet të merren me punë thelbësore, që këtë vend do ta nxirrnin prej qorrsokakut në të cilin është gjendur, e jo me hipoteza e parashikime duke u përzier në “punët e nënjorganit”, duhet t’i flakin nga koka qëndrimet demografike maltusiane për varfërinë tonë si pasojë e rritjes së numrit të popullatës, duhet të shpëtojnë nga ankthi për “natalitetin shqiptar në rritje të vazhdueshme” si element social mbizotërues në të ardhmen.

Organet shtetërore duhet ta mënjanojnë filozofinë e gabuar për keqpërdorimin e identitetit fetar të shqiptarëve të këtij nënqielli, shumica dërrmuese e të cilëve janë të përkatësisë fetare islame. E vërteta, përgjatë periudhës disamujore pas rastit “WTC & Pentagon” gjithmonë i ka shkëlmuar përpjekjet e politikës maqedonase për t’i paraqitur shqiptarët si pjesë e ndonjëfarë rrjeti terrorist. Shembulli më i kthjellët lidhur me këtë ishte ai i “shpjegimeve” zyrtare lidhur me rastin “Vreshtat e Rashtakut”, të cilave s’u besoi askush, as tek ne, e aq më pak jashtë.

Maqedonisë s’mund t’i sjellin dobi as arti filmik mañevskian plot pluhur, kulturëfytes e nacionalist, as dhuna dhe provokativizmi lubeian, as politika segregacioniste e ASHAM-it, as demagogjia e kryeministrit, e as “fetaria e inatit” me vendosje të kryqeve në çdo kodrinë e shkëmb, as zvarritja e punës lidhur me arsimin e lartë në gjuhën shqipe, as qërimi i hesapeve me adoleshentët shqiptarë...

Një pikë me rëndësi për daljen nga labirinti aktual mund të jetë favorizimi i njohjes më të mirë reciproke ndërmjet dy etnoseve. Në këtë drejtim duhet mobilizuar edhe institucioni i shkencës me degë të ndryshme të saj, si historia objektive, sociologjia, filozofia sociale, politikologjia, etika etj.

Këto ditë shohim se “po bëhet dasmë” lidhur me 307 miliona eurot e dhuruara prej donatorëve të huaj. Duhet theksuar se nëse vazhdohet me pikëpamjen “më ngjat gusha se fusha”, me një “politikë të këtillë ekonomike” të korrupsionit, nëse vazhdohet me shkurtpamësinë mikro dhe makroekonomike, këtë vend s’do të mund ta shpëtojnë as miliarda euro dhe trazirat, ka gjasa të kalojnë nga ujërat ndërnacionale, në ato të raportit klasa udhëheqëse që jeton në bollëk - masat e gjera popullore me xhepa dita-ditës më të cekët.

Për të jetësuar një tranzicion më të suksesshëm se ai i viteve ’90, të gjithë qytetarët e këtij vendi, në veçanti ata që udhëheqin me strukturat shtetërore, duhet ta kenë parasysh faktin se tani përgjegjësia është më e madhe në çdo lëmi të jetës, dhe se do matur mirë çdo hap që bëhet. Përndryshe “koshi” prapë mund të fillojë të mbushet me shëmtira, të cilat sjellin vetëm sherr, madje mund që, ruana Zot, të na përsëritet historia.

Tragjedia dhe intelektual i mirëfilltë

I.

Të trajtosh një tematikë me konotacion negativ, siç është elementi tragjik nga jeta jonë, është mjaft e rëndë, sepse ke të bësh me gjëra prekëse, rrëqethëse, me dhembje e vuajtje, me tronditje të brendshme, me zemra të thyera...

Koncepti tragjik si pjesë e historisë është një skajshmëri që me mugëtirën e vet kaplon individë, familje, grupe, madje edhe shoqëri të tëra. Vija e tragjikes dhe tragjedisë është shoqëruese e fatit të qenies njerëzore që nga mini-bashkësia e parë, që nga bijtë e Ademit (a.s.), Kabili dhe Habili, të cilët qenë aktorët e tragjedisë së parë në historinë e njerëzimit, duke u bërë simbol i gjakderdhjes dhe vëllavrasjes. Dhe, kjo linjë e përplasjes, fërki-meve, divergjencave, kontradiktave e mosmarrëveshjeve vazhdon me mijëvjeçarë të tërë deri në ditët e sotme. Kur hedhim sytë prapa, doemos na shtrohet kjo pyetje: Vallë, mos është ky fati i ekzistencës së krijesës? A ka gjasa që të realizohet ndonjëherë një metahistori pa mëkate, ku nuk do të ekzistojë kundërtia e dualiteteve: e mira-e keqja, e bukura-e shëmtuara, gëzimi-pikëllimi, ku do të mbretërojnë vetëm e mira, e bukura dhe gëzimi? Kur dhe ku?

Filozofët e mëdhenj thonë se disa nga tragjeditë kanë prejardhje nga tejfizikja ose mbinatyrorja, siç janë

kataklizmat natyrore, si p.sh. tërmetet, vërshimet, epidemitë etj., disave prej tyre s'u dilet para, madje edhe me forcën më të madhe që njeriu mund ta sigurojë; e te disa tragjedi rolin e vet tragjik e ka faktori njeri, i cili me hapat e vet të pamatur bëhet shkaktar i zymtësisë, i gjakderdhjes, rrënimeve, terrorit etj. Një mendimtar është shprehur se “tragjedia nuk është një ‘katastrofë’ që i vjen njeriut, por një përfundim i dhimbshëm, të cilin njeriu e ka zgjedhur me veprën, apo aksionin e vet”. A s'i shkaktoi vetë njeriu dy luftërat botërore të shekullit që e përçollëm, ku pësuan me dhjetëra miliona njerëz, shumica dërrmuese e të cilëve të pafajshëm? Lirisht mund të themi se tragjeditë e llojit të dytë, që ndodhim me “vullnetin” e njeriut, janë më tronditëse!

Ne, shqiptarët, si kolektivitet i vjetër i këtyre trojeve shpesh jemi përshkuar nga grushti i kontradiktës tragjike, ndonjëherë kemi lotuar si pasojë e varrave të shkaktuara nga të huajt, e ndonjëherë vetë e kemi dëmtuar indin tonë kombëtar, kemi ditur që me mjeshtëri t'i ulim dhe t'i ngremë lart njerëzit që meritojnë dhe ata që s'e meritojnë një gjë të këtillë, kemi ditur që heronjve t'u thurrim epope e më pas “t'i batisim”, të gjallë a të vdekur, në thellësitë e tokës, t'i nxijmë me të zezën e katra-nit, kemi ditur që ta mundim dushmanin e më pas të kacafytemi mes vete për gjëra anësore e cikërrima, kemi ditur të ekskomunikojmë “mendje të mëdha”, kemi ditur që për një çast, me një fjalë goje ose të rënë të lapsit, t'i humbim pikët e fituara me mund të madh, me djersë e gjak përgjatë viteve, dhjetëvjeçarëve e shekujve.

Vëllavrasja e ditëve të shkuara që na futi në të pikëllim të gjithë, së pari i çoi në ekstazë ata që s'arritën të na vënë dorë gjatë konfliktit dhe tani i kënaqen vuajtjes sonë e me të mundohen ta kompensojnë disfatën e përjetuar si para nesh ashtu edhe para të huajve. Dhe kjo

mjafton për të na e bërë tragjedinë edhe më të dhimbshme! Po ç'ti thuash asaj, nëse në mesin e familjeve të kapluara nga tragjedia ka nëna, që bijtë e vet i patën dërguar para tytave të pushkëve dhe deshi fati i paracaktuar që njëherë iu gëzuan kthimit të tyre shëndoshë e rehat në gjirin familjar, e tani ikën në botën tjetër nga dora jonë shqiptare? Kush mund të arsyetohet para nënave, para dëlirësisë së lotëve dhe tiktakeve të zemrave të tyre të përvuajtura, para ëndrrave të etërve që kanë bërë hesapet e dasmave të djemve të vet? Sikur të kishim menduar pak, para se ta hiqnim gishtin që vjell barut dhe merr shpirt tonin! Sikur të çliroheshim nga emocionet e çastit dhe të kishim parasysht urtësinë solomoniane, e cila thotë se “ai që sundon vetveten, egon e vet, është më i fortë sesa ai që sundon shumë vende e shtete”!

II.

Kohë më parë na gëzoi shumë lajmi se këtë muaj në kryeqytetin tonë, do të organizohet panairi i librit shqiptar, i cili vitin e kaluar nuk u mbajt për shkak të gjendjes që mbretëroi. Dhe në kuadër të veprimtarisë botuese të një shtëpie të librit, e cila synon të shndërrohet në një fanar që do t'i bëjë dritë hapësirës në të cilën jetojmë por edhe më gjerë, na u desh që disa herë të takohemi e të diskutojmë me një profesor universitar, me një filozof dhe mendimtar të shquar të këtij nënqielli, i cili bëri recensionin dhe shkroi parathënien e një vepre të përkthyer nga ne.

Nga bisedat me të, arritëm të përfitojmë shumë nuanca të pasqyrimeve të një mendjeje të ndritur, të një truri i cili di që edhe “nga pusi më i thatë të nxjerrë ujë që të freskon”, që di të bëjë abstraksione ideore nga më

të shkëlqyerat dhe të të drejtojnë në horizonte, të cilat s'i ke përfytyruar kurrë. Nga ky njeri-enciklopedi përveç shkëndijave të shkencës e diturisë, shënuam dhe lidhshmërinë e tij të fortë ndaj parimeve të kodit moral-etik, ndaj rregullave të ndershmërisë e njerëzshmërisë. Vlera e këtij personaliteti më tepër del në shesh kur kemi parasysh vargun *shumë dijetarë zotërojnë dituri, por ç'e do kur s'kanë fije njerëzi*, i cili flet për inteligjencien që di të arsyetojë, që i njeh parametrat e paradigmën shkencore, por që hiç nuk trazohet kur kemi të bëjmë me botën e ndërjegjes, të subtile e sublimes, për të cilën morali është vetëm kategori e menduar. Me këtë duam të themi se çdo shkollar dhe intelektual nuk e nënkupton *a priori* pozitiven. A nuk qenë intelektualë edhe akademikët e ASHA-së të Serbisë, që projektuan memorandum, i cili drejtpërsëdrejti ose tërthorazi vrau me qindra mijëra njerëz me përkatësi kombëtare të ndryshme, a nuk qenë dijetarë profesorët e Universitetit të Sarajevës të cilët diku në rrethin e Foçës loznin "futboll djallëzor" me kokat e prera të bosnjakëve etj.? Pra, të qenët intelektual është një tërësi, shkencëria është vetëm një pjesë e dijetarisë.

Intelektuali i nderuar për të cilin bëjmë fjalë këtu, na pushtoi me fjalët përfundimtare të bisedës së fundit që e zhvilluam me të: "Më kanë ftuar përsëri si profesor mysafir në një nga universitetet më me emër të Malajzisë ku kam ligjruar dy vjet, dhe përgjigjen akoma s'ua kam dhënë. Për fat të keq, për shkaqe të ndryshme do t'u përgjigjem me 'jo', por këtë s'mund t'ua kumtoj përmes telefonit e aq më pak përmes postës elektronike (e-mailit). Me harxhimet e mia do të shkoj deri atje e do t'ua jap përgjigjen dhe do t'i falënderoj për konsideratën që kanë për mua! Mosvajtja deri në këtë vend më duket sjellje prej bukëshkali dhe jokorrektësi!" Për individin që përveç arsyes së kulluar ka edhe shpirt, paraja dhe largësia

gjeografike prej mijëra kilometrash janë gjëra relative, për të prehje nuk paraqet vetëm kënaqësia vetjake, por edhe e tjetrit.

Dijetarët në një mënyrë janë artistë, në duart e të cilëve - siç thotë poeti romak Ovidi - edhe kocka e elefantit e humb ashpërsinë, zbutet nën gishtat e tyre! (*Tentatum mollescit ebur, postique rigore subsedit digitur!*). Dijetarët idealistë sot janë një gjë e rrallë, s'i gjen shpesh. Por edhe të rrallë qofshin, janë të vlefshëm. Edhe gurët e mineralet e çmuara si diamanti, ari etj. në krahasim me gurët e rëndomtë të zhavorit janë shumë shumë të rrallë, por e ruajnë vlerën e vet ndër shekuj, duke stolisur me shkëlqimin e vet njerëzit dhe këndet më të dukshme e më të çmuara të objekteve të ndryshme! Pas gjërave të çmuara të rralla duhet vrapuar!

Këto dy pjesë përbërëse të artikullit kanë pika të prekjes mes vete. Intelktuali i mirëfilltë është ai që popullit të vet dhe njerëzimit i ofron të mirën dhe ndikon në shmangien e së keqes. Ai nuk është botë më vete e ndarë nga realiteti, por pjesë e jetës. Ai përmes penës, logosit dhe sjelljeve paprerë e ruan *geist*-in e së mirës dhe e mbron vetveten e shoqërinë nga rënia në greminën e tragjikes.

Bota bashkëkohore në udhëkryq

“Si në spektrin natyror të botës, i cili është ndryshuar rrënjësisht nga qytetërimi modern, ashtu edhe në të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore ‘shkretëtira’ pak nga pak po shkon duke u rritur.”

John R. Snyder³⁹

Kohëve të fundit, kur flitet për botën bashkëkohore menjëherë del fjala “krizë”, e cila është bërë identitet shoqëruës i bashkëkohësisë. Semantika e fjalës “krizë” në vete ngërthen gjendje jonormale, gjendje të lëkundjeve, çekuilibrit, trazirave dhe traumave të ndryshme brenda një “organizmi” të caktuar në mikro dhe makroplan. Njerëzimi i periudhës së bashkëkohësisë gjendet në një udhëkryq, ku përplasen me të madhe fuqitë rrënimtare, antihumane, botëshkatërruese, djallëzore, nga njëra anë, dhe ato krijuese, pronjerëzore, shtytëse përpara të kauzës humane, por me sa duket, për fat të keq, këto të parat janë më aktive dhe më “efektive”.

Humanizmi, Rilindja, Iluminizmi dhe pozitivizmi absolut i shek. XIX paraqesin pika kyçe, kur u përpiluan plane dhe projekte për “shpëtimin e njerëzimit nga kthetrat e prapambetjes, regresivizmit, teokracisë, autarkisë mesjetare.” Këto plane e projekte bazoheshin në filozofinë për

³⁹ Gianni Vattimo, *Modernliğin Sonu*, çev. Şehabettin Yalçın, İz Yayıncılık, Stamboll, 1999, f. 8.

rrjedhën progresiviste dhe linear(ist)e të kohës. Sipas këtij botëkuptimi, u bë ndarja ose copëtimi i kohës në faza dhe periudha të ndryshme, në kohë të kaluar, të sotme dhe të ardhme, në parahistori dhe histori. E kaluara ose e shkuara symbyllazi u konsiderua ose, thënë më mirë, u etiketua si diç negative, e përshkuar me zymtësi, ankthe dhe kob, kurse ardhmëria si diç pozitive, e ndritur. Pra, ky ishte një polarizim teorik-ideor, që do të ketë pasqyrimin e vet në përditshmërinë e njeriut.

Pikëpamjet e ndryshme në kuadër të *filozofisë sociale* ose *inxhinierisë shoqërore* përmes skicave të ndryshme, si ajo e Comte-t për fazën teologjike, metafizike dhe pozitive, e Fergusonit për periudhën e primitivizmit, barbarisë dhe qytetërimit, e Marks-it, Renan-it, Weber-it etj., i premtënin njeriut një ardhmëri më të pasur dhe më të ndritur. Por në fakt ç'ndodhi? Njerëzimin e kaploi një krizë e llahtarshme, që dita-ditës shkon duke marrë përmasa më serioze. Veç janë bërë të zakonshme debatet dhe shkrimet për fundin e botës, apokalipsin para të cilit gjendemi, pohimet se “gjërat kanë arritur një pikë ku është koha e fundit të reagohet.”⁴⁰

Dihotomia progresi(vizmi)-regresi(vizmi) ose modernizmi *versus* tradita

Evropën (Perëndimin) dhe në mënyrë të tërthortë (sipas disave edhe të drejtpërdrejtë) tërë botën dy-tre shekujt e fundit e mundon një polarizim, një dilemë, një dihotomi ose ambiguitet mjaft i rëndësishëm, para të cilit

⁴⁰ Rene Guenon, *Kriza e botës bashkëkohore*, përkth. Vejsel Nuhiu, Drita e jetës, Gjilan, 1997, f. 63.

nuk mund të mbyllen sytë. Pra, bëhet fjalë për dihotominë progresi-regresi, modernizmi-tradita (tradicionalizmi). Teorizimet e shumta ideore për pasojë kanë patur lindjen e fërkimeve dhe përplasjeve shoqërore. Nga njëra anë, pala që mbron retrospektivën historike, që nisët nga një sfond real në ngritjen e aktualitetit dhe ardhmërisë, respektivisht pala konservativ(ist)e tradicionaliste, e nga ana tjetër ato progresiv(ist)e, të ndara në krahun liberalist dhe atë marksist, të cilat ardhmërinë e shohin nga dylbitë e një darvinizmi social, ku mbizotëron teza filozofike-sociologjike e konfliktit (*theory of conflict*), në të cilën me luftën ndërmjet gjërave ose palëve arrihet deri te rezultatet e duhura. Ndërsa teoria e parë (tradicionale) bazohet në konceptet: harmoni, kohezion, koherencë dhe pëlqim ndërmjet elementeve të ndryshme në mikrokozmos dhe makrokozmos, e dyta (teoria moderniste) duke u nisur prej konceptit *konflikti*, nga i cili lindin opoenca dhe konkurrenca, është kah e çon botën bashkëkohore në një drejtim të panjohur. Teoria e dytë si shembull *par excellence* e ka rastin e Prometeut, i cili është në *kundërti* të pandërprerë me zotat dhe si përfundim dënohet prej tyre. Pikëpamja ekonomike, e cila u bë mbizotëruese në botën bashkëkohore, është konkurrenca ndërmjet faktorëve të ndryshëm, ku “peshqit më të mëdhenj i përpijnë më të vegjëlit.”

Pikëpamja progresiviste i shpalli luftë natyrës dhe “duke përjashtuar Zotin”, i Cili në botëkuptimin tradicional është sundues i natyrës, i kozmosit-ekzistencës në tërësi, në vend të Tij e vuri njeriun (njeriu epiqendër e kozmosit dhe, siç thotë Protagora, “kriter i gjithçkaje” = humanizmi). Dhe, në eter u hodh premisa: “Njeriu sundon natyrën.”⁴¹ Njeriu tashmë mëmë natyrën nuk e shihte

⁴¹ Shih: Ahmet Davutogllu, *Vetëperceptimet e qytetërimeve*, përkth. Ali Pajaziti, Logos-A, Shkup 2002.

si ushqyese dhe muke të tij, por si objekt të shfrytëzimit. Në kuadër të kësaj pikëpamjeje antropocentriste “njeriu nuk është pjesë e natyrës, por sundues i saj”, ai lules nuk i merr erë dhe nuk e përkëdhel atë si një *reflectia Dei* (texhel-lí), siç vepronte njeriu tradicional, por e këput atë dhe ia çon dashnores së vet. Ai edhe bukurinë, e cila është objekt i kënaqësisë shpirtërore, e shndërron në objekt të përfitimit.

Nga soteriologjia shekullariste në epokën e krizologjisë pasmoderne

Nocioni soteriologji, i cili është pjesë e nomenklaturës fetare ose teologjike, nga aspekti leksikor ose etimologjik ka kuptimin “dituria mbi shpëtimin”, kurse në atë terminologjik ka kuptimin e diturisë mbi shpëtimin e njerëzimit në saje të një shpëtimtari ose mesie të pritur, të zgjedhur nga bota hyjnore.

Me zbulimet e mëdha gjeografike dhe lëvizjen e humanizmit, e posaçërisht me zhvillimin e shkencave të përpikëta (ekzakte), rolin e shpëtimtarit të njerëzimit e mori treshi i njohur “racion-shkenca-progresi.” Ky tresh (ose trinitet profan si paralelizëm i atij kristian Ati, biri dhe shpirti i shenjtë) i bazuar në desakralizmin e njeriut, në laicizimin dhe shekullarizimin e tij, njeriut do t’i sjellë shumë dobi sipërfaqësore, por në prapaskenën e vet do të fshehë fytyrën e vet të zezë, të cilën njerëzimi e shpallosi dhe e pa në shek. XX. Tashmë nuk ka njeri me mend në kokë, i cili nuk vëren se zinxhiri i procesit të individualizimit-egoizimit dhe industrializimit dalngadalë është duke e lidhur në pranga vetë njeriun.

Shfrytëzimi i pamëshirshëm i burimeve natyrore “për të plotësuar nevojat e pafundme të njeriut me anë të pasurive të fundme natyrore”, siç përkufizohet ekonomia bashkëkohore, e ka prurë këtë qenie buzë greminës. Mund të gjykoni se ç’grykësi dhe pangopësi nënkupton ky përkufizim. Njeriu na paska nevoja të pakufishme dhe natyra, me te gjitha dhuntitë për të cilat në fenë qie-llore thuhet “nëse përpiqeni t’i numëroni dhuntitë, nuk do t’ua kishit gjetur numrin”⁴², na qenka e pamjaftueshme për të plotësuar aspiratat e antroposit modern (*homo economicus*). Pra, kemi të bëjmë me përmbysje të idesë për “njeriun e kufizuar dhe dhuntitë e mirësitë e panumërta.”

Duke synuar plotësimin e nevojave të pakufishme, njeriu dita-ditës është duke e shkatërruar ambientin e vet jetësor, është kah e shkurton degën mbi të cilën qëndron vetë. Problemi i ekologjisë është një ndër problemet që kërkojnë zgjidhje të ngutshme, përndryshe ka gjasa që bota, e cila i është lënë në emanet njeriut, të shndërrohet në një megadeponi. Fabrikat, uzinat, të cilat sipas Com-te-t do të ishin tempujt e fesë pozitiviste, janë duke vjellë helm vdekjeprurës për shumë lloje të shpezëve, shtazëve, bimëve, por edhe për vetë njeriun. Në përmirësimin e gjendjes nuk mund të ndihmojnë as shoqatat e ndryshme ekologjike, Green-Peace, të gjelbërtit politikë e as fondacionet e shoqatat e ndryshme shtetërore e as ato të iniciativës së lirë-qytetare. Varrat e shkatërrimtarisë janë aq të mëdha, saqë është vështirë të shërohen me veprimtari shekullariste, ato mund t’i shërojnë vetëm një revolucion ose shndërrim shpirtëror, përmes logosit të mirëfilltë, i cili do t’i prekë telat e ndërgegjes njerëzore.

Gjeologët bashkëkohorë pohojnë se për formimin e rezervave të naftës së tokës janë dashur 400 milionë vjet,

⁴² *Kur’ani*, XIV:34, XVI:18.

që sipas tyre janë plotësuar në vitin 1976. Nëse shikohet sasia e tyre e tashme, sipas parashikimeve të bëra, konsumimi i tyre nuk zgjat më tepër se 400 vite.⁴³

Njeriu bashkëkohor i pangopur, luftërat më të mëdha dhe më të përgjakshme i ka bërë për hir të pasurisë, për hir të arritjes së thesareve të pasurisë së tundshme dhe të patundshme. Edhe sot e këtë ditë problematikë më e madhe e qarqeve botërore mbizotëruese është mbi-sundimi në burimet energjetike dhe në këtë drejtim janë themeluar qendra, institute që përpilojnë strategji e projekte afatshkurtra dhe afatgjata për përfitimin nga pasuritë e ndryshme të rajoneve anekënd botës.

Politika e dehumanizuar me prapavijën e vet ekonomike i solli njerëzimit dy luftëra botërore, në të cilat humbën jetën me dhjetëra miliona njerëz, si dhe shumë luftëra e përleshje lokale, me të cilat ballafaqohemi edhe sot e këtë ditë. Sot edhe pse flitet se demokracia është regjimi politik më i mirë dhe më i drejtë, prapëseprapë diskutohet për një problematikë të re: *demokracia që nuk qeveris*.

Mendimtarët e mëdhenj botërorë pohojnë se shkak i përmasave të ndryshme të krizës së botës moderne apo *fundit të modernizimit* qëndron në “krizën morale.” Njeriu i bashkëkohësisë është i stërngopur me materie, madje ka filluar që ta vjellë atë. U vërtetua se lumturinë të cilën ai e kërkoi, nuk e gjeti dot në rrugën të cilën e kish marrë. U vërtetua gabueshmëria e parullës “lumturia e njeriut është në pasurinë materiale të tij.” Shembullin më konkret lidhur me këtë kemi në atë që Durkheim-i e quan *anomi*. Vendet e ashtuquajtura më të përparuara në veçanti (dhe të tjerat në përgjithësi) po digjen në flakën e sjelljeve anomike të qytetarëve të vet, kërkojnë receta për

⁴³ Sejjid Hossein Nasr, *Islamic Science*, World of Islam Festival Pub. Co., Angli, 1976, f. 233.

mënjanimin e anomalive shoqërore. Suedia, shtet mjaft i zhvilluar ekonomikisht, është ndër vendet e para në botë me përqindje të vetëvrasjeve. Koncepti *familje*, të cilën sociologët dhe profilet e ndryshme të dijetarëve e quajnë “njësi themelore, strukturale dhe funksionale (qelizë) të shoqërisë”,⁴⁴ në vendet e zhvilluara pothuajse është duke kaluar në histori (lexo: duke u zhdukur). 45,7 % e qytetarëve të kryeqytetit të Gjermanisë, Berlinit, jetojnë në familje (nëse të njëjtat mund të quhen familje) njëanëtarëshe.⁴⁵ Vallë, mos kemi arritur epokën e tmerrshme të parashikuar nga librat e shenjtë të Indisë, kur “as familjet nuk do të ekzistojnë”? Divorci, dukuri kjo që në të kaluarën është shikuar dhe trajtuar me mjaft seriozitet, sot është shndërruar në lojë, ka mbetur vetëm ana formale-juridike e tij dhe mosmarrëveshjet lidhur me pasurinë. Madje çiftet candidate për bashkëshortë ende pa lidhur aktin e kurorës, firmosin kontratën se kujt do t’i takojë filan malli ose prona, kujt do t’i takojë banesa e kujt teknika e bardhë në rast të ndarjes, e cila është shumë afër kur në ujërat martesore hyhet me paragjykime dhe kush-tëzime. Pra, martesë nga një institucion i dashurisë dhe respektit të ndërsjellë, është shndërruar në një institucion të interesit reciprok. Kohë më parë një gazetë shkruante se artistja P. Anderson do të martohet me një x person në një ishull të pabanuar. Më trishtuese në këtë martesë ishte se nusja dhe dhëndri do të ishin të xhveshur e poashtu duhej të ishin edhe të gjithë të ftuarit!!!

Qeveria britanike planifikon të organizojë një fushatë të vlefshme 60 milion sterlina, përmes së cilës do t’u

⁴⁴ Shih: Zeki Arslantürk & Tayfun Amman, *Sosyoloji*, M.Ü. İFAV, Stamboll, 1999; Ali Dida, *Fillet e Sociologjisë*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1977; Neil S. Smelser, *Sociology: An Introduction*, John Wiley & sons, New York-London-Sydney-Toronto, 1973 etj.

⁴⁵ Sky News, 1 gusht 2000.

drejtohet tinejxherëve, të cilët sipas hulumtimeve të bëra hyjnë në marrëdhënie intime qysh në moshën njëmbëdhjetë ose dymbëdhjetëvjeçare. Porosia ose motoja e kësaj fushate do të jetë: “Është në rregull të jesh virgjëreshë?”⁴⁶ Shtrohet pyetja: si do të ketë sukses një gjë e tillë, kur diku tjetër në Evropë (Stokholm) inçizohet film porno në metronë me qarkullim përplot udhëtarë.⁴⁷

Sot janë themeluar fondacione, shoqata të ndryshme për luftën kundër dy kuçedrave të mëdha të aktualitetit: narkomania dhe AIDS, të cilat po bëjnë kërdi të paparë, duke mos njohur kufij, kombësi, ngjyrë, moshë etj. Ç’të thuash për ata individë ose grupime, që drogat e ndryshme dhe seksin i kanë shndërruar në burime të përfitimit?!

Nuk janë të rralla as rastet e pedofilisë, vrasjeve të shkaktuara nga fëmijët në mjedisin e bankave shkollore. Psikologët pretendojnë se shkaqet e rritjes së agresivitetit të fëmijëve janë mbushja e trurit të fëmijëve me heronjtë nga filmat e ndryshëm, ku thuaja në çdo kuadër “flasin” plumbat dhe gjaku.

Njëra nga temat më të diskutuara në qarqet e ndryshme sot është edhe inxhinieria gjenetike ose kopjimi i llojeve të ndryshme të gjallesave. Njeriu, i cili dikur në histori frikohej se “kunjat e ngjitur në tokë i shkaktojnë asaj dhimbje” (mendim i aborigjenëve, kur kolonialistët evropianë zbarkuan në tokat e Australisë), sot është në gjendje të bëjë eksperimente edhe me njeriun. Ky njeri mizantrop pretendon që vetë të zotërojë procesin e krijimit, gjë e cila është specifike vetëm e të Lartmadhëruarit.

Vallë, si të interpretohet pretendimi i Etien Mahçupjan-it, se ilaçi kundër kancerit është zbuluar para tridhjetë e ca viteve, por është fshehur dhe akoma fshihet

⁴⁶ *Dnervik*, 10 tetor 2000.

⁴⁷ *Op. cit.*

nga disa qarqe të caktuara që bëjnë atletikë të fitimprurjes? Në një emision televiziv ai citoi fjalët e një onkologu të famshëm, i cili paska thënë se “përfitimi më i madh material në shekullin e fundit është moszbulimi (mospublikimi) i ilaçit kundër kancerit.”⁴⁸ Këto fjalë mund të na duken si thashetheme dhe hipotetike, por ç’është themi për rastin e Jim Shapiro-s, i cili mori një telefonatë nga një fondacion mjekësor privat, ku i bëhej një ofertë për të marrë pjesë në një program shkatërrues sekret të inxhinierisë gjenetike, duke e shpërblyer me para të majme? “Kjo bisedë më tronditi!” ka pohuar Shapiro, duke shtuar: “Kjo tregonte se një grup shkencëtarësh të etur pas fitimit dhe adhurues të kënaqësive, ishin në gjendje që duke e fshehur prej popullit, ta grabisnin një degë të biologjisë, e cila shoqërisë mund t’i shkaktonte probleme morale dhe politike nga më seriozet”.⁴⁹

Kjo që u tha këtu nuk është një tablo e zezë dhe pesimiste e botës, por realiteti i kohës sonë, përmes saj janë shpalosur vetëm disa fenomene dhe raste nga ajo me të cilën po përballohem në përditshmërinë tonë, që dikush mundohet ta retushojë me kuaziromantizëm dhe ditirambe pa shije.

Përfundim

Bota e sotme gjendet në një pështjellim të madh. Dita-ditës shtohen zërat se njerëzimi gjendet para një katalizme me përmasa universale. Nëse nuk bëhet një ndryshim i kursit të anijes, mund të vijë deri te fundosja

⁴⁸ İskele Sancak, Kanal 7, 20 tetor 2000.

⁴⁹ Bernard Dixon, *What is Science for*, Penguin Books, 1976, f. 222.

e saj... Rrugëdalja nga kjo krizë është në brendësinë e njeriut. Në kthimin e vlerave moralo-etike. Në të kuptuarit prej njeriut të pozicionit dhe rolit, që ai duhet të luajë në sipërfaqe të tokës. Në çlirimin nga idhujt, nga hyjnitë e rrejshme të shekullarizmit, në kthimin e vlerave të përhershme, që nuk bazohen në të përkohshmen. Bota nuk mbahet me mite dhe legjenda artificiale, me teori dhe (hipo)teza me prapavijë pragmatiste e utilitariste.

Në kohën kur është vërtetuar se modernizmi ose industrializimi me mesianizmin e tyre shekullarist nuk arritën ta bëjnë të lumtur njeriun dhe kur flitet për një neologjizëm interesant “krizologjia”, njeriu duhet të vërë gishtin në kokë dhe të kujtojë mirë për pasojat e shkujdesjes së kësaj qenieje, për rebelimin e saj kundrejt natyrës, për degradimin shpirtëror, për dehumanizimin, për grindjet në arenën ndërkombëtare, për bombën bërthamore, si dhe për shumë çështje të tjera me rëndësi thelbësore për ekzistencën në tërësi.

Duke u bazuar në atë çka u tha deri këtu, vijmë në këto përfundime:

1. Soteriologjia shekullariste nuk e ka jetësuar pretendimin e vet për shpëtimtari. Shkaqet e mospasjes qendrojnë në të privuarit e saj nga parimet universale.

2. Njeriu i bashkëkohësisë, nëse nuk ndërmerren masat e duhura, ka gjasa të shndërrohet në mankurt, figurë e njeriut të çoroditur me memorje të humbur, që nuk e njih as nënën e vet, madje më në fund e vret atë.⁵⁰

3. Teoritë e konfliktit duhet të zëvendësohen me botëkuptimin për harmoninë në rendin kozmik.

4. Duhet që të bëhet ripërkufizimi i njeriut dhe raportit të tij me atë që e rrethon, qoftë ajo e shfaqur ose e fshehtë, imanente ose transcendente.

⁵⁰ Shih: Xhengiz Ajtmatov, *Legjenda mbi varrezat e Ana Beit*, përkth. Selim Sylejmani, Drita e Jetës, Gjilan, pa vit botimi.

5. Duhet të bëhet rishqyrtimi dhe riformulimi i rrethit “prodhim-konsumim-prodhim” dhe i devizës “hiperkonsumim për hiperproduktivitet.”

6. Gjendja e krijuar, siç thotë edhe Guenon-i, “duhet të shikohet ashtu siç është, pa optimizëm por edhe pa pesimizëm”, çdo individ duhet të bëjë mirësi dhe ta urdhërojë atë, të largohet nga e keqja dhe ta pengojë atë.

7. Duhet të përparojë edukimi i njeriut në bazë të parimit: Relativja është e pakuptimtë dhe e pamundshme pa absoluten, e rastësishmja pa të domosdoshmen, ndryshimi pa të pandryshueshmen dhe shumësia pa unitetin (njëshmërinë).

Misioni i universitetit *versus* përplasjeve të “elitës së miletit”

*“Kultura është faktori që jetën e njeriut e shpëton nga të
qenët e saj katastrofë.”*

Ortega y GASSET⁵¹

Universiteti si vatër e kulturës, si një det prej ku nxirren perlat më të çmuara që e plotësojnë mozaikun e sferave të ndryshme të jetës, zë vend tepër të rëndësishëm në hierarkinë e vlerave të çdo shoqërie. Në këtë institucion “gatuhen” kokat e ndritura, intelektualët dhe ekspertët, të cilët do t’i shërbejnë ardhmërisë së popullit, madje edhe njerëzimit në përgjithësi, sepse dituria e shkencat nuk njohin kombësi e as kufij gjeografikë. “Shtëpia më e lartë e dijes” luan rol mjaft me peshë në fatin e çdo bashkësie, aty përgatiten brezat që do ta bartin barrën e jetës në kohë dhe hapësira të ndryshme.

Universiteti është një univers, një botë më vete (në ndërveprim të vazhdueshëm me “botët” e tjera), ku qarkullojnë fjala, pena, arsyeja dinamike, ku i flitet mendjes së kulluar, ku zhvillohen debate e polemika, ku realizohen projekte, ku zhvillohen metodologji të reja të kërkimit, ku shtrohen teza, bëhen sinteza e analiza, në saje të të cilave synohet ngacmimi i ndjenjës krijuese të të riut -

⁵¹ Ortega y Gasset, *Universitetin Misioni*, çev. Bülent Üçpınar, Birleşik Yayıncılık, Stamboll, 1997, f. 78.

po edhe të më të vjetrit - dhe arritja deri në përfundime e kontribute të reja shkencore.

Për popullatën shqipfolëse të këtyre trojeve kalaja e arsimimit të lartë një kohë të gjatë ka qenë e papushtueshme, ka qenë ëndërr e kahmotshme kolektive, ka qenë një kategori e përfytyruar që një ditë pritej të bëhej realitet. Prindërve, familjeve por edhe vetë të rinjve - që pas një ose dy vitesh e disa si absolventë për shkak të “objektivitetit” të mësimdhënësve, si dhe për shkaqe të natyrave të tjera, detyroheshin t’i braktisnin studimet në tërësi ose t’i vazhdonin në ndonjë vend tjetër - dita-ditës u ngrihej adrenalina, u shtohej mosdurimi dhe pezmi ndaj sistemit, që s’çante kokë për ngritjen arsimore të shqiptarëve,⁵² të cilit i shkonte për shtati që bota intelektuale shqiptare të ishte e thelluar në kulturën sllave deri në dërrë të përdorimit të trajtës sllave për filozofin nga tokat latinofone (Toma Akvinski?!), të emërtimeve të politikanëve me shprehjen “politiçarë”... Arshinët e dyfishtë të universiteteve vendase dhe lotderdhjet gjatë përcjelljes së të rinjve që vijonin mësimet e larta në Prishtinë, Beograd, Zagreb, Sarajevë etj., po madje edhe jashtë trojeve të tanimë ish- Jugosllavisë, në mënyrë të vazhdueshme lidhnin nyje të panumërta gordiane, të cilat një ditë në këtë ose në atë mënyrë do të duhej të zgjidheshin.

Por ç’ë do që shteti me prirje *status quo*-iste të cilit shqiptarët si gjithë qytetarët tjerë ia lanin borxhin në të gjitha lëmenjtë jetësorë me arbitrarizmin e mbrapshtë dhe politikën arsimore inatçore, arrinte në përfundimin se “arsimimi i lartë duhet të jetë në gjuhën e shumicës, në gjuhën zyrtare”, se hapja e universitetit shqip paraqet hapjen e derës për shkëputje-secesionizmit, e kështu vazhonte të radhiste edhe shumë “arsyetime të tjera” boshe.

⁵² Shih: Hasan Jashari, *Konteksti sociologjik i shkollës*, Flaka, Shkup, 1999, f. 118-123.

Dhe pas baticave e zbaticave të shumta, erdhi dita kur shqiptarët thanë “mjaft më” dhe vendosën që vetë ta themelojnë universitetin e vet, ku do të mësojnë dhe do të bëjnë shkencë pa stres, në gjuhën e vet, ku do t’i kultivojnë vlerat e veta që janë specifike për këtë bashkësi. Mirëpo pala tjetër akoma s’ishte çliruar nga idetë fikse, ende s’i kish thyer barrierat e unit nëpërkëmbës, dhe zgjodhi më të keqen, deshi që vizionin e një populli ta thyente me forcë, derdhi gjakun e dëlirë të mbrojtësve të çështjes së arsimit. Dhe me këtë shkaktoi kundërefekt, edhe më tepër e përforcoi vendosmërinë shqiptare për të pasur vatrën e vet të arsimit të lartë.

Se historia nuk rrjedh gjithmonë në vijë të drejtë - dhe ashtu siç ia do qejfi dikujt - por di të bëjë edhe hope përmes të cilave “realizohet drejtësia”, flet rasti se “gjëja që te një popull jetonte vetëm në aspektin subjektiv-psikologjik” nuk u bë vetëm realitet, por realitet i dyfishtë. Pas Universitetit të Tetovës (UT), shqiptarët e Maqedonisë më vonë do të shënojnë edhe hapjen e një universiteti tjetër shqiptar (Universiteti i Evropës Juglindore-UEJL) dhe tanimë ata që ishin “pa fëmijë të vet diturorë, u bënë me binjakë”.

Por për fat të keq “dukuria e dualitetit universitar” përveç gëzimit dhe kënaqësisë, solli edhe mosmarrëveshjet mes grupimeve të ndryshme, mes partive politike, shoqatave, madje ndodhi edhe më e keqja: “i tërë populli u vu në hutë”. Tani, pas kundërshtimeve të elitës, në kryet e çdo shqiptari lindi pyetja, a thua “simboli i unitetit” po bëhet vegël e përçarjes, lindi dilema provokuese cili është universiteti, cili duhet mbështetur?! Tollojnë edhe më tepër e shtojnë intervistat e pakripura të disa prej pjesëtarëve të elitës sonë, të publikuara nëpër mediat, që akuzojnë “kolegjin” ose “universitetin pa ardhmëri”, që flasin për kalime, kthime dhe rikthime të

studentëve, sikur të bëhej fjalë për ndonjë mrekulli. Është mjaft lemeritës fakti i marrëdhënieve të ftohta mes dy institucioneve simotra, i këndelljeve dhe dialogjisë permanente. Nëse në politikë fërkimet, mosmarrëveshjet dhe dialektika pa pardon “janë të lejuara” (?), në sferën e arsimit, ku kemi të bëjmë me delikatesë e etiketë, me ndjenja të stërholluara dhe racionalitet, s’mund të arsyetohen fare, në veçanti në korniza brendakombëtare. Këto prapësi elitiste bien ndesh edhe me misionin e vetë universitetit, i cili nënkupton kohezionin e jo turbullirat dhe disharmoninë. Përderisa të mos shpëtojmë nga çështja e diversiteteve të kota, as trupi mësimdhënës e as studentët s’do ta kenë kokën gjithaq të qetë për t’u përqendruar aty ku duhet.

Sidoqoftë, një gjë është e sigurtë, gjendja e purgatorit verbal një ditë do të jetë e shkuar, kurse universiteti si mbjellës i farës së diturisë do t’i kapërcejë të gjitha këto lëkundje dhe do të mbetet të jetojë e të ndriçojë me dritën e vet.

Atyre që mbajnë timonin e universit akademik, profesorëve, ligjëruesve por edhe studentëve, u mbetet t’i ndjekin standardet e larta të arsimit, ta kenë parasysh faktin se vlerësimi dhe prestigji nuk janë të indeksuar as me përvjetoret e jubiletë, as me numrin e studentëve e as të mësimdhënësve, as me bukurinë dhe pamjen tërheqëse të godinave, as me sasinë e kompjuterëve, por me punën e palodhshme, me atë që Hegel-i në veprën e tij *Filozofia e historisë* e quan “përgjegjës për të gjitha sukseset në historinë botërore” - pasionin, të cilin e përkufizon edhe më qartë “pasioni që e sundon vetveten”⁵³ dhe me sukseset e arritura në sferë të shkencës.

⁵³ Gasset, *op. cit.*, f. 58.

Dëshira e flaktë e të dyja palëve të përfshira në procesin edukativ-arsimor, mësimdhënësve dhe studentëve, për të qenë në hap me kohën, për ta zotëruar sistemin e ideve frytdhënëse dhe për t'i dalë zot çështjes jetike, universitetin shqiptar do ta nxjerrin në skenë më tepër me simpoziumet, konferencat shkencore, librat e promovuar, me ligjëruesit e kërkuar nga katedrat e universiteteve botërore më në zë, me shpërblimet e dhëna nga shoqatat e ndryshme të vendit dhe ndërkombëtare, sesa me deklarata të sforcuara me politikë të ditës, të cilën shpejt e merr era. Bordet udhëheqëse të universiteteve tona me largpamësi duhet të dinë që universitetin ta fusin shtigjeve të suksesit, duke u mbjellë të rinjve tanë gjërat thelbësore, që janë caqe të universiteteve në korniza globale: *kulturën e përgjithshme, njohuritë rreth lëmit gjegjës (edukatë e arsim profesional), shpirtin krijues ose prirjen për hulumtim shkencor dhe formimin pedagogjik.*

Si për të gjitha kolektivitetet, ashtu edhe për shqiptarët e këtij nënqielli, vlen rregulla se duhet që të mësohen hap pas hapi në të gjitha fushat e jetës të ecin me këmbët e veta, pa përjashtuar mbështetjet e huaja. Mendimtari i njohur spanjoll Ortega y Gasset, në një vepër të tij lidhur me reformën e universitetit spanjoll të viteve '20 dhe '30 të shekullit XX, i përkujton fjalët popullore që vazhdimisht përsëriteshin nga Sanço Pança: "Edhe nëse ta japin një lopë, litarin do të duhet ta gjesh vetë!" Mësimdhënësit që vijnë nga jashtë (si ata nga trojet shqiptare, ashtu edhe të huajt) sado cilësorë qofshin ata, janë kalimtarë, prandaj duhen bërë hapa viganë për krijimin e kuadrit cilësor vendas. Donatorët e ndryshëm, populli dhe fondacionet e huaja, i kanë dhënë mundësitë për ta bërë këtë ose atë, kurse përgjegjësia më e madhe bie mbi krahët e elitës, e cila duhet të dijë të menaxhojë drejt.

Në fund dëshirojmë ta shpalojmë të vërtetën, pse fjalën ‘universitet’ në titullin e këtij shkrimi e kemi përdorur në njëjës: sepse të dy universitetet tona i konsiderojmë si pjesë të një trupi, dëmtimi i njërës prej të cilave e shqetëson tërë organizmin. Më kujtohet një shkrim i eseistit të shkëlqyer turk Ismet Ozel, që bën trajtimin e nocioneve “alternativë” dhe “allmashëk” (përkthimin e këtij të dytit s’e gjeta dot në asnjë fjalor). Sipas tij, alternativa ka kuptimin e dy gjërave që mund ta zëvendësojnë njëra-tjetrën, pra njeriut i mbetet të zgjedhë: “ose këtë, ose atë”, kurse shprehja e dytë ka kuptimin “këtë dhe këtë”. Koha do të tregojë se cili prej këtyre dy koncepteve do të peshojë më rëndë në kontekstin e universitetit tonë. Pa marrë parasysh a do të vazhdojnë të ekzistojnë të dy (universitetet) ose do të shkrihen në një, mendojmë se më me rëndësi është e vërteta, se sa do të arrihet të ndryshohet gjendja, të ecet përpara, të krijohen personalitete të shumanshme, që përveç se do të mund të konkurrojnë në tregun global të diturisë,⁵⁴ do ta çmojnë edhe indin e vet kulturor, që do të krijojnë duke u nisur nga vlerat që s’perëndojnë dhe nesër nuk do ta kthejnë mënjane kokën nga veprat e veta shkencore, e as që do të duhet që bibliotekat e veta t’i hedhin në Shkumbin dhe t’ia fillojnë nga e para. Jeta është tepër e shkurtër për të bërë aventura botëkuptimore që përfundojnë me kolaps, apo jo?! Latinët e vjetër kanë thënë: *ignorantia non est argumentum*.

⁵⁴ Shih: İsmail Doğan, *Sosyoloji - Kavramlar ve Sorunlar*, Sistem Yayıncılık, İkinci Basım, Ankara, 1998, f. 305 e në vazhdim.

Sarajeva, atje ku dikur ka qenë?

*“A është Sarajeva atje ku ka qenë më parë...
Uji i Miljackës vallë, mos është tharë?”*

Këto janë dy vargje paksa të modifikuara të një kënge të pop-këngëtarit të njohur boshnjak Dino Merlin; fjalë të cilat më rrotulloheshin nëpër kokë qysh prej nisjes së paradoditshme të autobusit, që do të na shpinte atje ku i kisha kaluar dy vjet e gjysmë të jetës sime studentore, që do të na shpinte në Bosnjën e dhimbjeve dhe lotëve, në metaforën e tmerrit, në tokën e larë me gjakun e qindra mijë njerëzve të pafajshëm, me gjakun e dëshmorëve që s’iu nënshtruan fuqive djallëzore, në vendin që përjetoj një natë të gjatë trevjeçare të Shën Bartolomeut, në vendin një pjesë e popullatës së të cilit për të nëntën herë e përjetoj gjenocidin, por që nuk u dorëzua, që qëndroi dhe mbeti në këmbë. U bëri ballë sfidave të shekullit, të cilin Eric Hobsbawm-i e quan “më vrasësin në historinë e njerëzimit”.⁵⁵

Me t’u nisur drejt pikësnyimit, menjëherë dolën në shesh teknefesllëqet e ballkanoidit. Së pari, mësojmë se duhet të hyjmë në Serbi që të mund të dalim prej këtij vendi, përndryshe nëse kalohet nëpër Kosovë, s’mund të arrijmë atje ku duam. Vendi që për shkak të mendjelehtësisë së udhëheqësve të vet të pesëmbëdhjetëvjeçarit të

⁵⁵ *Ekskluzivë*, nr. 24, maj 2002, f. 58.

fundit ka rënë në atë derexhe, kur as në vulat e pasaportës s'e shkruan emrin e vet sepse s'i dihet e nesërmja (në vulë s'figuron as Jugosllavia e as Serbia), që bën akte të këtilla makabre, i përngjan njeriut që është duke u mbytur në ujë dhe mundohet të kapet për kashte e të shpëtojë. Me mospranimin e vulave kosovaro-ndërkombëtare gjoja se e mban Kosovën brenda kufijve të vet. Ja edhe një "manierë" e asaj që quhet "prishje e demokracisë": kufitari maqedonas, edhe pse të gjithë udhëtarët të pajisur me dokumente udhëtimi, në të cilat nuk ka kurrfarë kufizimi se ku duhet shkuar e ku jo, pyet ku shkojmë, te kush shkojmë në Sarajevë? Prekje në një nga të drejtat themelore të njeriut, fjolla të totalitarizmit komunist të jetësuar në disa shtete, kur njerëzit për të udhëtuar prej një qyteti në tjetrin është dashur të kenë leje të shkruar nga Partia mëmë. Nejsë. Vazhdojmë dhe... dhe në Ferizaj arrijmë pas katër orë e gjysmë të plota. Udhëtim që në drejtimin tjetër bëhet më së shumti për një orë. O Zot, ç'hata ka ky nënqiell që përjetojmë kësifarë nonsensesh? Rrugës dalin edhe shenjat e para të pasojave të kryeneçisë serbe: ura e rrënuar mbi Ibër. Detyrohemi të kalojmë nëpër një rrugë anësore të hapur me buldozer e të paasfaltuar, thuajse rrugë dhish.

Vendkalimi kufitar i nëntë me radhë: hyrje në Bosnjë. Në republikën e pagëzuar Sërpska, të ngritur në saje të terrorit, etnocidit dhe kulturocidit. Në krahun e policit emblema me katër S-të e folklorit klanor-fisnor. Makina e policisë Zastava, disa prej bashkudhëtarëve thonë se edhe "Figo"-ja është në përdorim dhe bëjnë krahasime me Crysler-ët tanë, të jep përshtypjen e milicëve të shekullit të kaluar, të milicisë së Jugosllavisë titiste. Dhe disa orë qëndrim aty kot së koti, derisa merret haraçi "i vockël".

Duke kaluar nëpër malin Romanija, arrijmë në periferinë e Sarajevës. Serbomëdhenjtë për ta kënaqur veten

se kanë hise edhe në kryeqytet, nja dhjetëra shtëpive ua kanë ngjitur emrin Sarajeva Serbe. Ç'qytet i bukur?

Pamjet e para të Sarajevës. Kalaja mbi kodër që qëndron mburrshëm. Bembasha në hyrje të 'qytetit të vrarë' me ambientin e vet piktoresk. Biblioteka Kombëtare e djegur nga bibliofobët, piromanët dhe maniakët shajkaçëbartës. Bashçarshia e famshme që tanimë frymon lirshëm, simboli i "Stambollit të dytë". Pëllumbat para se bilit me ujin akull, që fluturojnë e bien në tokën e lirisë së gatuar me gjakun e dëshmorëve. Buzëqeshja, pritja dhe bujaria e sarajevasve, të cilat s'ka mundur t'i fshijë as shtettrëthimi e as baruti. Zhurma e tramvajit, tëk-tëket e çekanëve të zanatçinjëve klasikë, era e qebapëve dhe e byrekut... Xhamia e Gazi Husref Beut, çezma në avllinë e saj me ujin e kristaltë, për të cilin është thënë se "kush vetëm një herë pi ujë në Bashçarshi, rëndë e ka të kthetet në të veten shtëpi", kulla e sahatit, pazari i kimit që e trishtoi botën dhe e zgjoi nga plogështia e gjumi, vlon nga njerëzit. Lumi Miljacka si simbol i gjallërisë së qytetit të përvuajtur. Rruga e dikurshme "Vase Miskina", që më ka mbetur në kujtesë si pasqyrë e shpirtgjerësisë dhe naivitetit të boshnjakëve, të cilët "tjetrin e donin më tepër se vetveten". Një ditë kur shëtisja në këtë rrugë më të rrahur, rastisëm në një ceremonial të pjesëtarëve të sektit Hare Krishna, me ç'rast kalimtarët gostiteshin me ushqim vegjetarian, toptha të orizit. Kur një student, për shkaqe të ndryshme, nuk deshë ta pranonte të merrte prej tyre dhe hyri në bisedë me pjesëtarët e këtij riti, një boshnjake e moshuar iu kthye atij me këto fjalë: "Ç'sjellje është kjo? Sikur Izetbegović-i të ishte i këtillë si ti, do të kishim luftë". E shkreta, s'e kishte paramenduar se lufta do t'ia fillonte pas disa muajsh.

Simbolet e "vëllazërim-bashkimit" të rremë, rrokaqiejt binjakë Momo dhe Uzejri qëndrojnë të dëmtuar pranë

njëri-tjetrit. Të prekur në sedër dhe në trup, të bërë shkrumb e hi. Shenjat e miliona predhave, që vranë 10 000 qytetarë sarajevas dhe po aq lanë sakatë, në godinën e ish-Komitetit Qendror. Kazerma gjigante e shndërruar në pjesë të universitetit. Varrezat e reja përballë stadiumit Koshevo flasin me zërin e heshtjes, predikojnë urtinë e mosharrimit, vigjilencën dhe zgjuarsinë e pasardhësve... Pallati i shtypit "Oslobodjenje", që s'pushoi së punuari as gjatë zjarrit të luftës; disa kate të ndërtesës të rëna njëri mbi tjetrin tamam si flia jonë tradicionale. Të paprekur fare, ndoshta do të mbeten përkujtues të tragjedisë më të madhe të fundshekullit.

"Alamete" të zgjimit kombëtar boshnjak: (ri)formësim i një gjuhe specifike, që do të dallojë nga ajo e dy popujve të tjerë, shtëpите botuese që botojnë libra lidhur me identitetin dhe kulturën boshnjake, gazeta e revista që synojnë ruajtjen e vlerave autentike... të gjitha si pararojë kundër tëhuajësimit e shkrirjes, që do të pasonte sikur mos të ishte lufta. Një parantezë lidhur me librin: këtu hasa në veprën më të shtrenjtë që kam parë ndonjëherë. Një krestomaci disavëllimëshe e filozofisë kush-tonte as më pak e as më shumë, 1000 marka të kthyeshme (KM), që do të thotë 500 e ca euro.

Policët nga kantoni i Sarajevës me zambakun dhe "shahovnicën", të japin përshtypjen e një kurorëzimi artificial mes dy popujve, boshnjakëve dhe kroatëve; e përdorim mbiemrin "artificial", sepse këta të dytët bënë punë të ngjashme me ato të serbëve. Nga ana tjetër flamuri pa kurrfarë "manaje", njësia monetare, pasaporta dhe targat e makinave që vlejnë për gjithë territorin, si *collective representatives* të japin idenë se bëhet fjalë për një shtet unitar.

Bosnja pasdejtiane të lë përshtypjen e një mjegullnaje të vërtetë, të një lëmshi të ngatërruar, të cilit është e

shumë vështirë t'i gjendet fija. Disa analistë janë shprehur se realiteti i Bosnjës është futur në frigorifer dhe është ngrirë. Ardhmëria e këtij vendi - një paqartësi, një labirint. Shtrohet pyetja, si do të mbillet ndjenja e solidaritetit shoqëror, si do të realizohet bashkëveprimi i mirëfilltë ndërmjet bashkësive të armiqësuar, si do të fshihen nga mbamendja e tyre "kuadrot e filmit tragjik"? Si do të shërohen të gjitha varrat e shkaktuara nga etnoromantizmi dhe megalomania e skajshme antiboshnjake, si do të zhduken recidivat e mostolerancës?

Akademik Hamit Beqja një libër të vetin e ka titulluar *Edhe engjëlli edhe djalli janë brenda te i gjalli*.⁵⁶ Le të shpresojmë se fuqitë engjëjllore do të ngadhënjëjnë mbi ato djallëzore dhe se "vendin e gjelbërimit dhe sevdalinkave" e presin ditë më të mira, se historia nuk do t'i përsëritet më.

⁵⁶ Hamit Beqja, *Tranzicioni demokratik dhe psikologjia e shqiptarëve të sotëm*, Mësonjtorja e parë, Tiranë, 2000, f. 20.

Sociologjia e sportit

Sociologu i shquar amerikan me prejardhje kroate Stjepan G. Meshtroviq, në veprën e tij *Shoqëria tejemocionale* flet për një ambient të krijuar në epokën e pasmodernes, kur njerëzit tashmë pak nga pak po zbehen nga ana e ndjenjave, po bëhen të pandjeshëm ndaj ngjarjeve e dukurive edhe më rrëqethëse, nuk çajnë kokë shumë për gjërat që e prekin njeriun e kohës sonë, thënë shkurt nuk emocionohen, nuk trazohen emocionalisht. Sado që ky konstatim i tij në masë të madhe është real, nga ana tjetër sociologët dhe psikologët flasin për një emocionalitet të bujshëm në një drejtim tjetër, atë të emocionimit kundrejt gjërave, të cilat lirisht mund të quhen të dorës së dytë ose anësore, si p.sh. sporti, në veçanti degët e tij më të popullarizuara si futbollit, basketbolli etj., por të cilat kohëve të fundit në saje të mediave po bëhen përcaktuese të veprimtarive ditore, javore e vjetore të miliona njerëzve anekënd botës. Sporti si njëfarë kulture popullore (*popular culture*) dhe alternative është shndërruar në një fuqi sekrete/magjike, që ngre në këmbë me miliona njerëz, i shpërndan ata nëpër sokake e rrugë, i shtyn që të përleshën me njëri-tjetrin, u ofron atyre një ndjeshmëri dhe kondensim emocionesh, të cilin s'e gjejnë në përditshmërinë e tyre të rëndomtë, shkakton ankthe e vuajtje ose gëzim e festë, shpesh bën një bujë dhe e ndërpret jetën normale.

Sporti, neopaganizëm ose kuazireligjion!

Dukuria shoqërore e quajtur sport njerëzit i kthen në një ambient të shoqërisë komunale, te ithtarët e flaktë ngjall ndjenjën e identitetit specifik të shoqëruar me instrumente, simbole dhe ikonografi të veçantë neopagane (emblema, afishe, daulle, flamuj, fanella), atë të ndarjes dhe abstragimit nga “tjetri”, respektivisht nga “adhuruesi” i bashkësisë (klubit) tjetër, i cili në saje të një ligjërate të ulët dhe meskine, që s’kalon përtej onomatopeve e më së shumti dhjetë fjalëve (uuu, oleee, fiuu, gool, we are the champions...), tjetrin poashtu e shpall armik (e jo konkurrent), me të cilin duhen qeruar hesapet.

Është domethënëse se kur bëhet fjalë për ata që simpatizojnë akëcilin klub sportiv, përdoret termi “adhurues”, pra “adhurues i x ngjyrave të x klubit”, “adhurues i këtij apo atij futbollisti”. Këto shprehje paraqesin një trajtë të shekullarizuar të fjalorit fetar. Janë mjaft interesante shënimet e një psikologu, i cili bën krahasim mes stadiumit e palestrave sportive me tempujt, mes futbollistit që bartet në krahë nga bashkëlojtarët ose publikut dhe totemit të shoqërive primitive të bartur nga pjesëtarët e bashkësive fisnore-klanore, mes emblemave e flamujve të klubeve sportive dhe ikonografisë fetare, mes futbollistëve dhe figurave të traditës fetare.

Në këtë lëmi shkohet aq larg, saqë tifozët e Manchester United-it në fanellë të klubit me numrin 7 me të cilën luante yllin francez Eric Cantona, kishin shkruar shprehjen *dieu* (7-shi zot). Si student më kujtohen fjalët e tifozëve të Zheljeznicar-it sarajevas që përsërisnin fjalët “Željo je drugi bog!” (Zheljeznicar-i është zoti i dytë!). Një gazetë greke pas fitores së Turqisë në çerekfinalen e Kupës Botërore, kishte vënë këtë titull: “Turqia, njëri nga katër zotat e futbollit”

Ithtarët e sportit aq shumë janë të lidhur pas “idoleve” të veta, sa që në çaste të caktuara kalojnë në trans (veti kjo e misticizmit), e humbin vetëkontrollin dhe bëjnë gjëra, me të cilat ndonjëherë vënë në rrezik edhe jetën e vet. Shpesh nga kutia magjike (TV) mësojmë për dhjetëra të mbytur prej rrëmujave të shkaktuara nëpër stadiume. Para do ditësh në një gazetë lexuam lajmin për një të ri nga Shqipëria, i cili ditën që kish planifikuar t’i gëzohej ndeshjes futbolistike të botërorit, përfundoi në varr. Ai, pasi kishte konstatuar se ishte ndërprerë rryma elektrike, ishte munduar t’i lidhte telat e vet me ata të një shtyllë tjetër, të cilët, për fat të keq, e bënë qymyr.

Duhet theksuar se edhe ata që veten e mbajnë më larg këtij religjioni të rremë ose neopaganizmi, siç e emërtojnë sociologët sportin, që e ndjekin sportin por janë të qëndrueshëm dhe më të përmbajtur, prapë e fusin në qark fenë. Një klerik i lartë anglez para ndeshjes Brazili-Anglia i ishte drejtuar Zotit, që ta mbronte ekipin anglez nga Ronaldo-ja dhe Ronaldinho-ja! Fenë në sport e inkuadrojnë edhe vetë aktorët sportivë, që para hyrjes në lojë ose pas shënimit të golit, bëjnë ritual fetar me të cilin i luten ose e falënderojnë Perëndinë. Qoftë edhe trajtësore, ndërthurje interesante, apo jo!

Sporti i ekonomizuar

Ekonomia dhe racionalizmi ekonomik janë dy veçori mjaft me peshë të shoqërisë bashkëkohore. Njeriu i kohës sonë nuk njeh kufij kur është në pyetje përfitimi material, kështu që mes të tjerash, fushat sportive dhe sporti në përgjithësi, i cili në fakt duhet të jetë pjesë e kalimit të

kohës së lirë (*leisure time*), është shndërruar në shou-biznes dhe instrument të superfitimit. Firmat prodhuese të televizorëve para botërorit 2002 kanë shënuar rritje të madhe në shitjen e aparateve TV me ekranë gjigantë, korporatat të tjera të famshme kanë harxhuar sasi të mëdha të produkteve të veta, duke organizuar fushata përmes të cilave kanë zgjedhur “fatmirët” që do të shkonin në Kore dhe Japoni. Përkujtoni për një çast arenat sportive “të përkryera”, kalimet e sportistëve prej një klubi në tjetrin që kushtojnë dhjetëra miliona dollarë, reklamat dhe marketingu i produkteve të ndryshme (Coca Cola, Pepsi, Hyundai, Fuji...) që bëhen përmes fytyrave të shquara të sportit botëror a organizimeve, si kupa evropiane ose botërori, miliona dollarët që qarkullojnë nëpër shtëpitë e bastit. Klubet e mëdha botërore tashmë i kanë kaluar kufijtë nacionalë dhe janë shndërruar në markë gjithëbotërore, rekuizitet e ndryshme atyre u sjellin para të majme. Konsumatorë të lajmeve dhe imtësirave të yjeve të klubeve evropiane ndoshta më tepër gjeni në Azi dhe Lindje të Largët, sesa në vetë Europën. “Sportdashësit e humbur” bien e zgjohen para postereve të të adhuruarve të vet, siç shprehet një mendimtar, kryejnë ritualin e vet dhe blejnë gjithçka që ndërlihet me idhujt bashkëkohorë. Rrëmuja e ekonomizimit të çdo gjëje i ka përfshirë në veçanti të rinjtë, të cilët jetën e vet e programojnë sipas itinerarit të ndeshjeve sportive dhe për pasojë, çalojnë nga ana e arsimit. Që nga e hëna pritet e marta dhe e mërkura (Liga e Kampionëve), e enjtja (Kupa e Uefa-s), e shtuna dhe e diela (ligat e njohura si ajo calcio, primera division, premier league...), pritet botërori i ardhshëm, play-off-i i NBA-së. Në të gjithë këtë shou vërtiten miliarda dollarë, krijohen klube gjigante ekonomike, që vazhdimisht rriten në bursën ndërkombëtare, krijohen legjenda dhe mite të reja. Ndërlidhja

mes sportit dhe ekonomisë ndihmohet edhe nga **moda**, e cila është shndërruar në *modus vivendi* (stil jetësor) të të gjitha grupeve moshore e në veçanti të të rinjve, të cilët tanimë nuk i marrin si shembull poetët, filozofët, shkencëtarët, por yjet e sportit. Korporatat me famë botërore “Adidas” dhe “Nike” u dëshpëruan tepër prej eliminimit nga garat e mëtutjeshme të futbollistëve të famshëm, si Zidane, Figo, Beckham etj., të cilët janë *trade mark* i tyre. Kjo për arsye të rënies së shitjes së produkteve të hedhura në tregun global nën reklamën e këtyre fytyrave të njohura madje edhe për fëmijët.

Sporti dhe dhuna

Organizimi bashkësinor i tifozëve sportivë sjell me vete edhe njëfarë subkulture puritane, një “kulturë” të agresivitetit ose të dhunës. Amigoizmi ekstrem është një fenomen që ka depërtuar edhe nëpër rrethet më të ngri-tura, ku mund të hasni në grupim maniakësh sportivë, që veten e quajnë “hordhia e së keqes”, “bad blue boys”, “delije” (të marrët), “maniacs” (maniakët), “devils” (djajtë), “hooligans” (huliganët) ... Këto “bashkësi”, natyrisht edhe sjelljet i kanë paralele me emrat që mbajnë, janë mbjellës të farës së të keqes, vjellin vrer ndaj lojtarëve dhe tifozëve të ekipeve kundërshtare, thyejnë, prishin, djegin, ndonjëherë madje edhe vrasin. Pothuajse para çdo ndeshjeje të rëndësishme futbollit organet e sigurimit konfiskojnë sasi të konsiderueshme të mjeteve dhe veglave, që e vënë në rrezik jetën e njeriut (brisqe, thika të madhësive të ndryshme, lëndë shpërthyesë etj.). Huliganizmi nëpër objektet sportive por edhe jashtë është një

problem mjaft i rëndë, që i kanoset frymës së vërtetë të sportit për miqësimin e njerëzve. Dëmet e shkaktuara nga huliganët nëpër lagje të ndryshme të qyteteve rëndojnë xhepat e qytetarëve të rëndomtë, të cilët s'kanë lidhje me sjelljet anomike të "tifozeve ekstremistë", që gjërat i shohin vetëm nga një prizëm. Nga gojët e gërmadhave që mbushin stadiumet madhështore dëgjohet refreni *You will never walk alone!*, i cili paraqet një mbështetje siushtarake idhujve që luftojnë në fushë, një kohezion brenda-grupor i tifozeve që janë në gjendje të bëjnë gjithçka.

Sporti dhe nacionalizmi

Në kohërat e vjetra individët dhe bashkësitë e kanë treguar veten nëpër arenat e ndryshme (si Koloseu), nëpër fushat e luftës, dhe fitoret ose disfatat kanë qenë faktor i prestigjit ose zhgënjimit. Sot si individët ashtu edhe shoqëritë, mes të tjerash veten e paraqesin edhe në fushën e sportit. Një publicist pohon se garat e ndryshme sportive janë një pasqyrim i garave luftarake të kohërave të lashta. Tragjedia e mbytjes së kundërshtarit është shndërruar në shkaktim të tragjedisë emocionale te tjetri dhe kënaqësi vetjake. Kjo vlen si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv.

Realiteti shoqëror na shpie në konstatimin se ekziston një lidhje mjaft interesante mes sportit dhe nacionalizmit. Në çastet kur ekzekutohet himni kombëtar dhe kur ngritet flamuri nëpër arenat sportive, thuajse i gjithë kombi këndellet dhe "papra u ndihmon shpirtërisht heronjve që mbrojnë nderin kombëtar". Fitoret e kombëtareve madje për një çast ose për disa ditë e bëjnë popullin

t'i harrojë problemet me të cilat ballafaqohet. Para botërorit 2002 në futboll e tërë Argjentina pikë satisfaksioni mes vuajtjeve ekonomike shihte fitoren e skuadrës së vet në këtë garë globale. Euforia e kalimit në gjysmëfinale të skuadrës turke ndikoi që edhe në pikat më nevralgjike të Turqisë (Juglindja) të mbushen rrugët përplot me tifozë dhe t'i harrojnë problemet ditore. Ato ditë gazeta *Financial Times* shkruante se suksesit të kombëtares turke i janë gëzuar edhe kurdët!

Në sport shpesh përfshihet edhe elementi shovinist e barbar. Të freskëta i kemi fotografitë e përleshjeve të tifozëve ultranacionalistë serbë dhe kroatë nëpër stadiume e palestra, të cilat ishin uverturë e shëmtuar në luftën e përgjakshme të viteve '90 mes këtyre dy popujve. Histerinë nacionaliste e hasim edhe nëpër arenat sportive të vendit tonë, ku tifozllëk më i lezetshëm konsiderohet fyerja e pjesëtarëve të kombit tjetër.

Ndoshta ju kujtohet paradoksi dhe marria kur në Beograd, në ndeshjen futbollistike mes Jugosllavisë e Maqedonisë, tifozët maqedonas shanin shqiptarët edhe pse nuk luanin kundër shqiptarëve, edhe pse ngjyrat e kombëtares së kësaj të dytës i mbronte edhe shqiptari. Irracionalizmi i tifozllëkut di të shkojë aq larg, sa që preket edhe në "shenjtëritë" e popullit tjetër, si figurat e mëdha historike, flamuri, banknota etj. Këtyre të fundit, për të treguar patriotizmin vetjak, shpesh u vihet zjarri.

Përfundim

Mund të themi se sporti, i cili sipas të gjitha vëzhgimeve dhe sondazheve shkencore është shndërruar në

një shenjtëri shekullore, në thelb përmban elementin e nxitjes për zhvillimin fizik të njeriut, afrimin mes njerëzve dhe lehtësimin e ndjekësve, kuptohet nëse perceptohet në korniza të racionales. Të konsideruarit e tij *raison d'être* dhe të krijuarit me të të lidhjeve ontologjike është absurd. Fitorja dhe humbja në sport janë simotra, disfata e pësuar në sport nuk është fundi i dynjasë. Po edhe fitorja nuk paraqet idealizim të gjithçkaje. Kalimi i çastit nga bota e realitetit në botën e ëndrrave, ku gjithçka është në rregull, arritja e kohezionit shoqëror për një periudhë të shkurtë kohore në saje të sportit, ngadhënjimi i vogëlanëve mbi fuqitë e mëdha ekonomike dhe krijimi i iluzionit egalitarist është fitore e Pirros, nëse nuk arrihen fitore (rezultate kulmore) edhe në sferat e tjera të jetës. Njeriu i mençur në kokën e vet e ka të formuar hierarkinë e vlerave dhe nuk lejon që elementet sipërfaqësore të kulturës moderne, siç shprehet Jean Baudrillard, ta privojnë prej idealeve të larta.⁵⁷

⁵⁷ Yusuf Kaplan, "Futbol Pratiğinin Teorisi: Futbol Paganizmi", *Ummran*, qershor 2002, nr. 94, f. 59.

E shenjta dhe profania në opusin sociologjik të Durkheimit

“Nevoja e adhurimit është vëlla i njeriut. Sado që të kthehemi në histori, nuk do të gjejmë popull të ketë jetuar pa fe.”

Max Müller

Emile Durkheim-i (1853-1917) zë një vend të posaçëm në përgjithësi në sociologji, dhe në veçanti në sferën e sociologjisë së besimit. Ai konsiderohet “themelues i shkollës frënge të sociologjisë.”

Veprat kryesore të tij janë: *La Division du Travail Social* (Mbi ndarjen e punës shoqërore), *La Suicide* (Vetëvrasja), *Les Formes Élémentaires de la Vie Religieuse* (Trajatat themelore të jetës fetare) dhe *Les Regles de la Methode Sociologique* (Rregullat e metodës sociologjike).

Ajo që e karakterizon Durkheim-in është pikëpamja e tij sociologjike. Në vend të postulateve metafizike ai vendos parimet objektive dhe me këtë ndahet nga doktrina e pozitivistëve, të cilët nga prizmi i metodës vënë shenjë barazimi mes filozofisë së historisë dhe sociologjisë.⁵⁸ Parimin kryesor të sociologjisë së këtij sociologu të famshëm e përbën sintagma “ndjenja kolektive”, që ka domethënien “tërësia e përfytyrimeve kolektive shoqërore”.

⁵⁸ Ünver Günay, *Din Sosyolojisi Dersleri*, Kayseri, 1996, f. 88.

Sipas tij, faktori që e mban të bashkuar popullin janë zakonet dhe traditat. Ndërmjet fenomeneve feja, e drejta, morali dhe ekonomia ekzistojnë lidhshmëri dhe marrëdhënie reciproke (ndërveprim). Për pasojë, shpjegimi i tyre duke i abstraguuar nga njëri-tjetri është gabim.⁵⁹

Libri i tij lidhur me sociologjinë e religjionit *Trajtat themelore të jetës fetare* është një nga veprat klasike ose kryeveprat e këtij lëmi. Sipas Aronit, bëhet fjalë për veprën më të rëndësishme, më të thellë dhe më origjinale të Durkheimit dhe në të cilën më së qarti pasqyrohet sistemi ideor i këtij mendimtari. Objektivi i kësaj vepre është që, duke u nisur nga hulumtimi i institucioneve më të thjeshta dhe më primitive, të arrihet deri te një teori e përgjithshme lidhur me fenomenin e quajtur religjion (fe).⁶⁰ Sipas Durkheimit, si përmbajtja ashtu edhe forma e mendimit tonë janë shoqërore, respektivisht fetare. Feja luan një rol shumë të rëndësishëm në formimin e koncepteve si koha, vendi (hapësira) dhe shkakësia, ajo është burimi i përfytyrimeve të para që i fiton njeriu lidhur me botën.⁶¹

Durkheimi fenë e përkufizon kështu: “Feja është një sistem i ndërlidhur i besimeve dhe praktikave lidhur me gjërat e shenjta ose të ndaluara.” Ajo i bashkon ata që i pranojnë këto besime dhe zbatime në një bashkësi shpirtërore.⁶²

Ky sociolog i njohur lidhur me fenë përdor nocionet “e shenjta” dhe “profania”. Para se të kalojmë në diskutimin teorik të sociologut në fjalë rreth tyre, le të ndalemi dhe të shohim se si përkufizohen ato në fjalorët e ndryshëm.

⁵⁹ Günay, *op. cit.*, f. 88.

⁶⁰ Raymond Aron, *Sosyolojik Düşüncenin Evreleri*, Bilgi Yayınevi, Ankara, 1986, f. 243.

⁶¹ Günay, *op.cit.*, f. 90.

⁶² Nurettin Şazi Kösemihal, *Sosyoloji Tarihi*, Fakülteler Matbaası, Stamboll, 1955, f. 191.

“E shenjta” (fr. sacré, angl. sacred): Gjëja që zë vendin qëndror në realitetin ose dukurinë shoqërore të quajtur fe.”⁶³ “Besime, institucione dhe qenie, të cilave feja u përshkruan elemente transcendentale dhe i madhëron.”⁶⁴ “Tipare kulturore dhe sociale që nuk bazohen në sfond racional ose utilitar, që në asnjë mënyrë nuk mund të bëhen subjekt i gjykimit, kundrejt të cilave ndihet një respekt i madh dhe u përshkruhet vlerë e lartë.”⁶⁵ “Gjëra të cilat lartësohen në një shoqëri ose në një grupim shoqëror dhe për të cilat mendohet se kanë një cilësi (për)mbipunët e kësaj bote; gjëra për të cilat besohet se zënë vend në një rend të veçantë.”⁶⁶

“Profania” (fr. angl. profane): Gjëja që nuk ka ndonjë kuptim simbolik jashtë praktikës së përditshme të racionalizuar.⁶⁷

Sipas Durkheimit, esenca e fesë është ndarja në fenomene të shenjta dhe jo të shenjta (profane) e jo besimi në një Fuqi Supreme ose Zot. Domethënë, fenë nuk mund ta sqarojmë as me idenë për mbinatyroren e as me idenë për Zotin, sepse këto nuk janë elemente që mund të gjenden në çdo fe. Në budizëm, xhainizëm nuk ekziston as koncepti i Zotit e as ai i fuqisë së adhuruar. Në fetë primitive si totemizmi, nuk ekziston gjë që mund të cilësohet si mbinatyrore.⁶⁸

Sipas tij, kategoria fetare është formuar nga dihotomia e botës: e shenjta dhe ajo që është profane. Sacré dhe profane janë dy kategori kryesore të mendimit shoqëror.

⁶³ Allan G. Johnson, *The Blackwell Dictionary of Sociology*, Cambridge Massachusetts, 1995, f. 232.

⁶⁴ Omer Demir-Mustafa Acar, *Sosyal Bilimler Sözlüğü*, Agaç Yayıncılık, Stamboll, 1992, f. 295.

⁶⁵ *Op.cit.*, f. 223.

⁶⁶ Özer Ozankaya, *Temel Toplum Bilim Terimleri Sözlüğü*, Cem Yayınevi, Stamboll, 1995, f. 87.

⁶⁷ Demir-Acar, *op.cit.*, f. 295.

⁶⁸ Kösemihal, *op.cit.*, f. 190.

“E shenjta përbëhet nga tërësia e objekteve (sendeve), besimeve dhe riteve (ceremonive). Nëse ndërmjet sendeve të shenjta ekziston një integrim i caktuar dhe nëse janë të sistematizuara dhe të lidhura mes vete saqë mos të hyjnë në asnjë sistem tjetër, atëherë tërësia e besimeve në to formon një fe. Domethënë feja është identitet i besimit në të shenjtën, pastaj organizimit të besimeve lidhur me të dhe më në fund, ritualeve dhe praktikave që pak a shumë janë logjike.”⁶⁹ Kjo dihotomi (e shenjta-profania) ekziston në të gjitha fetë. “Me të vërtetë të gjitha fetë botën e ndajnë në të shenjtë dhe profane, urdhërojnë që të mos vijë deri te përzierja e tyre. Të gjitha fetë e llogarisin mëkat aktin e përzierjes së këtyre dy botërave.”⁷⁰ Për shembull, është e ndaluar që në vendet e shenjta (në tempuj) të kryhen punë jo të shenjta, gjegjësisht punë të përditshmërisë njerëzore. Kësisoj, vendi është ndarë në të shenjtë (brenda tempullit) dhe jo të shenjtë (jashtë tempullit). Edhe koha i është nënshtuar një tipologjie të këtillë. Në kohërat, ditët që janë ndarë për punët fetare është e ndaluar që të merresh me punë të rëndomta jetike. Shembull lidhur me të sipërthënë kemi në ditët e shenjta ose në festat fetare. Ceremonitë e ndryshme fetare bazohen në themelin për mospërzierjen e botës së shenjtë me atë profane. Për shembull, në kristianizëm ceremonitë e kungimit (eucharistia) dhe pagëzimit (baptism) bëhen për njerëzit që nuk janë të shenjtë. “Confession” (rrëfimi ose pranimi i gabimeve) kryhet për t’u shpëtuar mëkateve.⁷¹

Romakët e vjetër të shenjtën e përkufizonin si “res extra commercum” (gjë që nuk mund të jetë objekt tregtie). Ajo është e rrethuar me fortifikatën e respektit. “Shenjtëria nuk është cilësi specifike vetëm për zotat.

⁶⁹ Aron, *op.cit.*, f. 245.

⁷⁰ Kösemihal, *op.cit.*, f. 191.

⁷¹ Shih: *op.cit.*

Çdo gjë mund të jetë e shenjtë. Kufijtë e shenjtërisë dallojnë prej feje në fe. Njeriu synon që të shenjtën dhe jo të shenjtën t'i shpjegojë me idenë e një zinxhiri të shkallshmërisë së karakteristikave, që e dallojnë njërin nga tjetra. Ai kujton se shenjtëria mund të jetë tipar vetëm i qenieve më të larta se vetë ai. Kurse realitet është se të qenët princ nuk mund të lindë shenjtërinë. Robi është i lidhur ndaj të zotit, por kjo nuk do të thotë se ai (i zoti) është i shenjtë.⁷² Profane është ajo gjë, mbi të cilën mund të ngremë dorë, të cilën mund ta ndryshojmë, ta ndërrojmë me diç tjetër, ta shesim dhe ta shkatërrojmë pa ndier pendim.⁷³ Këto dy botë nuk janë oponente por konkurrenca të njëra-tjetrës. Në botën e dytë mund të dillet vetëm pas ndarjes së prerë nga e para. Ja, prej këtu ka lindur asketizmi. Qëllimi i asketizmit është dëbimi i gjërave jo të shenjta, që kanë mbetur në shpirtin e njeriut. Pika e fundit e kësaj është mohimi fetar. Njeriu mendon se në saje të kësaj rruge patjetër do ta arrijë shpëtimin. Gjërat e shenjta mbrohen me ligje të ndryshme.

Pas këtyre shpjegimeve mund të kalojmë në karakteristikat objektive të ceremonialeve besimore dhe fetare:

“Bindjet fetare” janë parafytyrime, që na njoftojnë lidhur me thelbin e gjërave të shenjta.

“Ceremonialet fetare” janë norma të sjelljes, të cilat na njoftojnë se si të sillemi ndaj gjërave të shenjta.

Siç pamë, sipas opusit mendimor të Durkheimit, në jetën e njeriut ekzistojnë dy fusha, kufijtë e të cilave janë të prerë. Kjo ndarje mund të na shpjegojë deri te filozofia mbi laicizmin (dhe shekullarizmin), sepse siç dihet në laicizëm, themelor është parimi për ndarjen e çështjeve fetare nga ato të botës (jofetare). Mirëpo është gabim të pretendohet, se një gjë e tillë vlen për të gjitha fetë, sepse

⁷² Kösemihal, *Durkheim Sosyolojisi*, Remzi Kitabevi, Stamboll, 1982, f. 102-103.

⁷³ Gaston Bouthoul, *Toplumbilimin Tarihi*, Varlık Yayınları, përkth. Cemal Süreyya, Stamboll, f. 128.

ekzistojnë edhe fe, ku ky kufi nuk është i qartë ose nuk ekziston fare. Sidoqoftë, përsëri dallimeve në pikëpamjet dhe praktikën lidhur me konceptin “e shenjtë”, mund të themi se i njëjti ushtron një ndikim bukur intensiv nëpër shoqëritë e ndryshme (përfshirë edhe ato islame) dhe është i pashlyeshëm nga mendja e antroposit, madje edhe atij modern e pasmodern. Refleksionet e tij vërehen edhe në momentet, kur njeriu mendon se është duke bërë diç që nuk ka fare lidhje me të shenjtën ose fetaren.

Nga ajo që Durkheim-i trajton lidhur me subjektin në fjalë, mund të vijmë deri te përfundimet në vijim:

- Kategoria “e shenjtë” është më e ulët se kategoria Zoti, ajo është emanacion i hyjnitetit dhe Durkheim-i bën gabim kur një nus-produkt e vë si *differentia specifica* të fesë, duke u bazuar në atë, se në disa tërësi bindjesh siç i quan ai fetë, e ne do t'i kishim quajtur ideologji ose deviacione fetare, nuk ekzistojnë koncepti Zot.

- Me sintagmën “fetë primitive” Durkheim-i pretendon për parësinë temporale (kohore) të animizmit; natyvizmit e totemizmit kundrejt monoteizmit. Ky koncept i bazuar në evolucionin e imagjinuar të fesë, respektivisht në iluzionin (ose projeksionin) për progresin linear, më tepër ka të bëjë me atë, që në historinë e feve quhet “fetë e bastarduara”, sepse “fetë primitive” janë trajtë e deformuar e monoteizmit të pastër, pra gjithçka ka filluar me monoteizëm, e pastaj me kalimin e kohës kanë pasur animizmi, natyvizmi etj.

- Ndarja e hapësirës jetike në të shenjtë dhe profane nuk është aq kategorike sa thekson Durkheim-i. Ekzistojnë gjëra të cilat në syrin tonë duken si profane, të cilat në fakt janë të shenjtë, kurse nga ana tjetër ka gjëra që konsiderohen të shenjtë që në esencë nuk kanë të bëjnë fare me të; madje ca herë kjo dihotomi humbet tërësisht, dmth bëhet amalgamimi i këtyre dy koncepteve sa që është rëndë të bëhet dallim mes tyre.

Elita, elitizmi dhe shoqëria

Është një fakt i pakontestueshëm se në çdo shoqëri, duke filluar nga ato të historisë së lashtë (nuk duam të themi shoqëri primitive, sepse fjalës “primitiv/e” - që në fjalorët e ndryshëm gjuhësorë shpjegohet: *of the earliest times* - i/e kohëve më të hershme - me Rilindjen e këndeje, posaçërisht me daljen e teorisë së evolucionit dhe zhvillimin e antropologjisë, i janë dhënë kuptime negative), ekzistojnë dy grupime ose shtresa kryesore shoqërore: *masat*, turmat ose grumbulli nga njëra anë, dhe *elita*, ajka ose inteligjencia, në anën tjetër. Kjo është një ndarje natyrore e pashmangshme. Të menduarit e të kundërtës është iluzion.

Elita është një term, të cilin e hasim edhe në literaturën fetare. Në literaturën e feve të Ibrahimit (hebraizmi, krishterimi dhe Islami) i hasim konceptet e *bariut* dhe *kopesë*, përkatësisht udhëheqësit dhe popullit. Në këtë rast bariu simbolizon elitën, kurse kopeja popullin.

Grupimi i elitës edhe pse si sasi më i paktë se i pari (masa), pretendohet se cilësisht është më i lartë, më i ngritur, e më i pajisur dhe më i merituar. Konsiderohet se elita ka nivel më të lartë kulturor, se zotëron njohuri dhe finesa më të shquara nga sfera të ndryshme, si politika, ekonomia, filozofia, arti, letërsia etj., për këtë arsye ajo meriton të udhëheqë. Pra, ky term në literaturën bashkëkohore përdoret me një konotacion pozitiv, madje të absolutizuar.

Si sinonim i elitës në përditshmërinë tonë përdoret edhe termi inteligjencia (*intelligentsia*), i cili është përfutur në Gjermani në vitet '40 të shekullit XIX. Për herë të parë është përdorur në Rusi në vitet '60 të po atij shekulli si antinom *vis a vis* shtresave të paedukuara (të pashkolluara) shoqërore. Termat 'elitë' dhe 'inteligjencie' dallojnë midis veti, sepse i pari është më i gjerë, nën "flatrat" e tij mund të gjejnë vend edhe individë që nuk janë nga radhët e inteligjencies. Kurse tipar dallues i inteligjencies është dija, dituria, niveli i lartë arsimor-kulturor. Do të ishte një hap vigan, hap drejt ideale, sikur elita e çdo shoqërie, ashtu siç thekson Platoni në *Republikën* e vet dhe Farâbiu *el-Medînetu'l-fâdila*, të përbëhej nga urtanët, filozofët, dijetarët, intelektualët, shkollarët...

Elita në shoqërinë tradicionale dhe në atë moderne

Në shoqërinë tradicionale, në jetën e përditshme gjithmonë rol kyç duke filluar nga ritet dhe ceremonitë e ndryshme fetare deri te vendimi për paqe ose luftë me fiset, fratritë ose kombet, ka luajtur elita klerikale. Në këtë shoqëri *differentia specifica* e së cilës është lidhshmëria e ngushtë me hyjnoren, të shenjtën dhe *lingua sacra*-n, elitën e ka përbërë grupi i prijësve karizmatikë, të cilët janë "të prekur nga dora hyjnore." Elita e kësaj periudhe, në botën perëndimore ka qenë e paprekshme, temë tabu për masën e rëndomtë, nuk ka qenë e lejuar të kritikohet, sepse "ka qenë e pafajshme, nuk ka gabuar." Klikën e *clerge* (klerikëve) ose teokratëve nuk ka patur të drejtë ta kritikojë askush nga *laikos*-ët (shuma e njerëzve jashtë

priftërisë). I njëjtë është rasti edhe në sistemin e kastave në Indi.

Kur vijmë te shoqëria moderne, e cila dallohet me “largim nga boshti dhe qendra” (S.H. Nasr), me shekullarizëm të dukshëm, me të qenët e pajisur me kulturë profane, posaçërisht me kulturë shkencore të bazuar në eksperiment dhe vëzhgim, hasim në një pikëpamje më liberale rreth - nëse mund ta quajmë ashtu - anëtarësimin në elitë, sepse kriter i pjesëmarrjes në elitën bashkëkohore është *edukata* (në kuptim të nivelit të arsimimit), si ashensor social. Por në shumë raste kriter i pjesëmarrjes në elitë janë edhe *pasuria e modus vivendi* (stili jetësor), faktorë këta që nëse janë të unifikuar me të parin janë frytdhënës, por nëse u mungon kultura ose edukata, shumë shpejt mund të shpien në turbullira ose çekuilibër shoqëror.

Lirisht mund të themi se në kohën aktuale ekziston një shkëputje në marrëdhënien elita-masa. Elita shumë rrallë komunikon me masën, ajo ka krijuar një *kulturë elitiste*, e cila fare ose shumë pak ka të bëjë me populloren. Flet një gjuhë të cilën populli vështirë ose hiç s’e kupton, jeton në shtëpi ose rezidenca ku mund të hyjë vetëm pjesëtari i shtresës së vet, organizon ballo ose ahengje ku “shporr” stresin e përditshmërisë, dëgjon një muzikë nga e cila “i plasin veshët” katundarit, nuk njih faktore, shenjtëri, tradita, doke, zakone (të cilat ruhen në gjirin e masës), me një fjalë, është zvetënuar e tëhuajësuar prej tërësisë, pjesë e së cilës është edhe ajo vetë. Shumë të dhimbshme janë pamjet, kur me rastin e ndonjë feste fetare ose varrimi (zaten në këto dyja më së tepërmi marrin pjesë), intelektualit thjesht hutohet ose mundohet të luajë rol në skenarin për të cilin s’ka haber. Burokratizimi dhe krijimi i zyrave ku qarkullojnë pjesëtarët e elitës, e kanë bërë shumë të zymtë tablonë e ndërveprimit ndërmjet këtyre dy qelizave të rëndësishme të indit shoqëror.

Anglezët edhe sot e këtë ditë habiten se si një njeri i rëndomtë dhe i thjeshtë (nuk duhet harruar niveli i tij i lartë arsimor) si Gandhi arriti që “ta rrëzojë karrocën e kolonializmit anglez në Indi.” Me siguri se sekreti qëndron në të qenët e tij i mbërthyer fort me popullin dhe kulturën lokale, në mburrjen e tij me atë që ka qenë, në mosimitimin e së huajës.

Lidhja organike në marrëdhënien elita-masa

Nuk janë të rralla rastet, kur prijësinë shpirtërore dhe lëndore e kanë në duar njerëzit më perversë, më të pakulturuar dhe më gjakpirës. Ky është një fenomen i rëndë, i cili na shpie në përfundimin se nuk duhet gjykuar a priori që çdo elitë është e shkëlqyeshme, iluministe, mirësisjellëse, se nuk duhet krijuar në kokë një aksiologji e paragjykuar. Gjithmonë për të duhet gjykuar sipas kriterëve parake të së vërtetës. Këto kriterë, me përjashtim të gjendjeve traumatologjike, në çdo vend dhe kohë janë të njëjta: **e vërteta, e mira, e drejta, e bukura** në çdo shoqëri dhe në çdo etapë të historisë njerëzore janë e vërtetë, e mirë, e drejtë dhe e bukur. Pra, përderisa elita e ruan atë që Hegeli e quan *geist* (shpirt) të parakes, të *sophia perennis*, të *el-hikmetu'l-hâlîde* dhe të *sanatana dharmâ*, kemi sinjale se ajo është e shëndoshë dhe meriton të mbetet në kolltukun e prijësisë, i cili askujt nuk i është garantuar. Shumë njerëz shkatërrimtarë janë llogaritur nga të “elitës”, por njerëzimit i kanë sjellë vetëm zjarr, gjak, vuajtje, kanibalizëm, gjenocid, etnocid, kulturocid...

Ndodh që shumë herë rolin qenësor në ruajtjen e indit kombëtar, fetar, e luajnë grumbujt e njerëzve, respektivisht masa. Shembull konkret për këtë e kemi rastin e berberëve në Afrikën Veriore të kohës së kolonializmit freng. Sikur të mos ishte populli i rëndomtë, e në veçanti gruaja, sot në ato troje gjuha vendase (arabishtja) do të ish harruar në tërësi dhe do të vinte deri te asimilimi kulturor total i tyre. Elita veriafrikane nuk çante kokë për gjëra si gjuha, feja, tradita, kultura lokale etj.

Pra, elita dhe masa duhet të jenë të lidhura njëra me tjetrën, e para mos të “fluturojë nëpër qiell” dhe të kujtojë se njerëzit e rëndomtë janë një lëndë ose objekt i manipulimit, por një subjekt i cili duhet të udhëhiqet drejt së vërtetës dhe mirëqenies. Ajo duhet të ruajë afërsinë me popullin, të krijojë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe të pashkëputshme me të.

Për fat të keq, në shumë raste elitat e sotme janë grupe njerëzish me sy të pangopur për para, famë dhe autoritet, që synojnë të arrijnë shkallën e plutokracisë e aristokracisë, të jetojnë një jetë mondane dhe “pa bren-ga.” Sot njerëzit e ajkës shoqërore i nënshtrohen lehtë snobizmit e dandizmit, bëhen zhdanovistë që s’ua gjen shoqin, në vend që të ndriçojnë masën, të bëhen pish-tarë që do t’i jepnin ndihmesë prosperitetit të përgjithshëm shoqëror. Elita dhe masa janë si gishtërinjtë e dorës, vetëm një gisht nuk mund ta kryejë funksionin e dorës, të gjithë gishtërinjtë të bashkuar mund të bëjnë punë të mëdha për vetë individin, shoqërinë e ngushtë të tij dhe shoqërinë *in tutti* (njerëzimin).

Elitizmi⁷⁴ i shndërruar në vetëvrasje kombëtare

Në shoqërinë shqipfolëse, në të kaluarën e afërt historia shënon elitën e cila ia kishte rezervuar vetes të drejtën e manipulimit me masën. Në monizëm shqiptarët kanë patur një elitë dhe ideologji antikombëtare, që vazhdimisht i ka rrëzuar urat të cilat populli me shekuj është munduar t'i ndërtojë. Së pari i është dhënë grusht i fortë elementit fetar, i cili është i pashkëputshëm nga trangu i shoqërisë. Janë bërë përpjekje boshe për këputjen e “zinxhirit më të fortë të shoqërisë” (*Religio praecipuum vinculum societatis*) siç e përcakton Francis Bacon-i fenë. Me luftën kundër fesë indi kulturor shqiptar është varfëruar deri në mjerim, edukata i është lënë në duar partisë dhe inteligjencies (të udhëhequr nga ideologjia ultra-marksiste) e cila - çdo respekt individëve të papërzier në këtë fushatë - e ka ndotur tepër “ambientin”, saqë “do të duhen vite e dekada që të dilet nga kjo kataklizmë.”

Me kalimin në sistemin pluralist filloi një luftë e ashpër ndërmjet “taboreve politike shqiptare”, e cila vazhdon deri në ditët e sotme. Kjo luftë pa pardon ndoshta dikujt i duket normale, duke u nisur nga paradigma liberaliste (*laissez faire*) e pluraliste, por nuk duhet harruar se nëse kjo luftë fiton ngjyra të makiavelizmit dhe bajraktarizmit politik, pasojat janë katastrofike. Me fjalitë e fundit ndoshta vumë shenjë barazimi ndërmjet politikës dhe elitës, tezë kjo që deri diku edhe është realitet, sepse në shoqërinë bashkëkohore politika është institucioni mbi-zotërues shoqëror.

⁷⁴ Sipas Ukshin Hotit elitizëm do të thotë gjallërim i “elitës për hir të elitës”. (Hoti, *op. cit.*, f. 186.

Sot janë tragjike skenat e debateve ndërmjet pjesëtarëve të elitës shqiptare, të cilat do s'do reflektohen edhe në masë me pasoja tragjike.

Me sa na duket, akoma nuk kemi arritur të krijojmë një elitë koherente, e cila do të dijë të pozicionohet drejt dhe të shohë kah horizontet e largëta, të kuptojë se grindja nuk sjell kurrfarë të mire, se dashuria dhe respekti i ndërsjellë janë baza e mirëkuptimit, një elitë e cila do të hartojë plane dhe programe afatshkurta e afatgjata autentike, që këtij populli të vuajtur ballkanik do t'i sjellin ditë më të ndritura në të gjithë lëmenjtë e jetës.

Elita është ajo që duhet të jetë pjesa më e mirë e shoqërisë, dhe më e keqja e të këqijave është kur vjen deri te degradimi, tjetërsimi, çrrënjësimi dhe prishja e saj. Një fjalë e urtë latine thotë: *Corruptio optimi pessima* (Më e keqja është prishja e më së mirës). Lexuesi le të gjykojë nëse këto fjalë kanë të bëjnë edhe me realitetin tonë. Nëse përgjigjja është "Po", nëse nuk duam që të na përsëritet historia e hidhur, atëherë na mbetet që të gjithë të mobilizohemi, të marrim mësim nga gabimet e bëra, të veprojmë palodhshëm secili në fushën e vet dhe rezultatet do të pasojnë, nëse jo sot, nesër.

Bibliografia

- Ahmet Davutoglu, *Vetëperceptimet e qytetërimeve*, përkth. Ali Pajaziti, Logos-A, Shkup 2002.
- Ali Dida, *Fillet e Sociologjisë*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1977.
- Ali Pajaziti, *Geçiş Sürecinde Makedonya, Üniversite Gençliği ve Din Olgusu*, M.Ü., Stamboll, 1998.
- Ali Sheriati, *Ç'duhet bërë?*, përkth. Vullnet Poshka, Rumi, Tetovë, 1999.
- Allan G. Johnson, *The Blackwell Dictionary of Sociology*, Cambridge - Massachussets, 1995.
- Bernard Dixon, *What is Science for*, Penguin Books, 1976
- *Beyin Furtması*, TRT 2, 3 janar 2002.
- ДАНИЛО КОЦЕВСКИ, "Едгар Морен-духот на времето", *Уџрински весник*, 13 dhjetor 2001.
- David Knowles, *The Evolution of Medieval Thought*, Longmans, 1965.
- *Dnevnik*, 10 tetor 2000.
- *Doğudan Batıdan Uluslararası Konferanslar Dizisi III*, Stamboll, 1998.
- Edgar Morin, *Avrupa'yı Düşünmek*, Afa Yayınları, 2. Baskı, çev. Şirin Tekeli, Stamboll, 1995.
- *Ekskluzive*, nr. 21, janar 2001; nr. 24, maj 2002.

- Ерик Хобсбаум, *Нациите и национализмот*, прев. Мето Јовановски, Култура, Shkup, 1993.
- Fatih Okumuş, *Malik bin Nebi – Yirminci Asrın Şahidi*, Denge Yayınları, Stamboll, 1998.
- Ferhat Polisi, “Mendime filozofike të rilindësve shqiptarë”, *Jehona*, 2000/1.
- Frensis Bejkën, *Atlantida e Re*, përkth. Sulejman Drini, Rilindja, Prishtinë, 1982.
- Gaston Bouthoul, *Toplumbilimin Tarihi*, Varlık Yayınları, përkth. Cemal Süreyya, Stamboll.
- Gianni Vatimmo, *Modernliğin Sonu*, çev. Şehabettin Yalçın, İz Yayıncılık, Stamboll, 1999.
- Gordon Marshall, *Sosyoloji Sözlüğü*, çev. Osman Akınhay-Derya Kömürcü, Bilim ve Sanat Yayınları, Ankara, 1999.
- Hamit Beqja, *Tranzicioni demokratike dhe psikologjia e shqiptarëve të sotëm*, Mësonjtorja e parë, Tiranë, 2000.
- Hans Freyer, *Din Sosyolojisi*, çev. Turgut Kalpsüz, Ankara, 1964.
- Hasan Jashari, *Konteksti sociologjik i shkollës*, Flaka, Shkup, 1999.
- Henry Bergson, *Ahlak ve Dinin İlk Kaynağı*, çev. Mehmet Karasan, Ankara, 1962.
- Husejin Gjozo, *Islami në kohë*, Meshihati i BI të Maqedonisë, Shkup, 1993.
- Immanuel Wallerstein, *Liberalizmden Sonra*, Metis Yayınları, Stamboll, 1998.
- Intervistë me Novak Kilibarda, *BH Dani*, nr. 248, 15 mars 2002.
- İskele Sancak, Kanal 7, 20 tetor 2000.
- İsmail Doğan, *Sosyoloji - Kavramalar ve Sorunlar*, Sistem Yayıncılık, İkinci Basım, Ankara, 1998.

- Ismet Ozel, *Tri çështjet*, përkth. Ali Pajaziti, Logos-A, Shkup, 1998.
- Jostein Gaarder, *Sofi'nin Dünyasi*, 11. Basım, çev. Gülay Kutal, Stamboll, 1996.
- Карл ШМИТ, *Политичка теологија*, прев. Светлана и Димитар Гелеви, Култура, Shkup, 1993.
- Kösemihal, *Durkheim Sosyolojisi*, Remzi Kitabevi, Stamboll, 1982.
- *Kur'ani*
- Neil S. Smelser, *Sociology: An Introduction*, John Wiley & sons, New York-London-Sydney-Toronto, 1973
- Nurettin Şazi Kösemihal, *Sosyoloji Tarihi*, Fakülteler Matbaası, Stamboll, 1955.
- Omer Demir-Mustafa Acar, *Sosyal Bilimler Sözlüğü*, Ağaç Yayıncılık, Stamboll, 1992.
- Ortega y Gasset, *Kütlelerin İsyanı*, çev. Nejat Muallimoğlu, Bedir Yayınları, Stamboll, 1992.
- Ortega y Gasset, *Üniversitenin Misyonu*, çev. Bülent Üçpınar, Birleşik Yayıncılık, Stamboll, 1997.
- Özer Ozankaya, *Temel Toplum Bilim Terimleri Sözlüğü*, Cem Yayınevi, Stamboll, 1995.
- Paulo Coelho, *Simyacı*, çev. Özdemir İnce, Can Yayınları, 32. Basım, Stamboll, 1997.
- Raymond Aron, *Sosyolojik Düşüncenin Evreleri*, Bilgi Yayınevi, Ankara, 1986.
- Rene Guenon, *Krişa e botës bashkëkohore*, përkth. Vejsel Nuhiu, Drita e jetës, Gjilan 1997.
- Samuel Huntington, "The Clash of Civilisations", *Foreign Affairs*, 1993, vëll. 72, nr. 3.
- Sejjid Hossein Nasr, *Islamic Science*, World of Islam Festival Pub. Co., Angli, 1976.
- Sky News, 1 gusht 2000.

- Ukshin Hoti, *Filozofia politike e çështjes shqiptare*, Rozafa, Tiranë, 1995.
- Ünver Günay, *Din Sosyolojisi Dersleri*, Kayseri, 1996.
- WAMY, UN, *CLA World Facts Book*.
- www.co-net.org/what_is_coexistence
- www.yenisafak.com
- Ц.К. Раулинг, *Хари Потер и каменои на мудросија*, прев. Благородна Богеска-Анчевска, Култура, Shkup, 2001.
- Xhengiz Ajtmatov, *Legjenda mbi varrezat e Ana Beit*, përkth. Selim Sylejmani, Drita e Jetës, Gjilan, pa vit botimi.
- Ylli Pango, *Amerika*, Korbi, Tiranë, 1996.
- Yusuf Kaplan, “Futbol Pratiğinin Teorisi: Futbol Paganizmi”, *Umrân*, qershor 2002, nr. 94.
- Zeki Arslantürk & Tayfun Amman, *Sosyoloji*, M.Ü. İFAV, Stamboll, 1999.
- Френсис Фукујама, *Крајот на историјата и последниот човек*, прев. Драган Јакимовски, Култура, Shkup, 1994.

Indeksi

A

aborigjenët, 131
Ademi (a.s.), 119
AIDS-i, 131
akademikët, 122
albkultura, 58
Aligieri, 75
Alkimisti, 39
alternativa, 140
amigoizmi, 150
animal metaphysicum, 40
anomia, 129
antropologjia, 160
antroposi modern, 128
apokalipsi, 125
arbitrarizmi, 136
arenat sportive, 149, 151, 152
aristokratët, 44
arketipi, 43
armagedoni, 97
Aron, Raymond, 155
arsimi, 17, 33, 100, 101,
137, 138, 149
arti, 97, 111, 117, 160
Atlantida e Re, 46, 112
autokratët, 44

B

Bacon, F., 44, 74, 108
Bangu, Big, 97
Ballkani, 25, 26, 31, 78
bashkëkohësia, 100
Bashkimi Evropian, 70, 106
Baudrillard, Jean, 153
bellicizmi, 96
Beqja, Hamit, 145, 168
Bergson, Henry, 76, 168
besimet, 155, 157
bindjet fetare, 158
bota e tretë, 108
botëkuptimi hantingtonian,
89
botërorizimi, 60, 67
brahmanët, 113
burokrati, 41, 162

C

cargo cult, 18
Camus, 45
Carrel, 114
ceremonialet fetare, 158
civitas, 61
Cooling, Wendy, 111
Coelho, 39, 169

Comte, 74, 125, 128
conditions humaines, 100

D

dandizmi, 164
Defo, 75
degradimi shpirtëror, 133
dehumanizimi, 133
demagogjia, 117
demokracia, 15, 16, 17, 18,
129
denacionalizimi, 90
devijimet shoqërore, 102
De Benoist, Alain, 65
dialektika, 99
dialektika ndërqytetërimore,
106
dihotomia, 125, 157, 159
dituria, 100, 127, 135, 161
diversitetet, 60, 93
doket, 162
dukuria patologjike, 83
dukuria shoqërore, 147
Durkheim, 83, 129, 154,
158, 159, 169
Džozo, Husejin, 79

E

e shenjta, 154
e Vërteta Absolute, 47
Ecco, Umberto, 19
edukata, 17, 162, 165
egocentrizmi, 62
ehl-i sunneti, 78
eklektizmi, 114
ekonomia, 17, 33, 76, 128,
155, 160

eko-qytetet, 98
elementi shovinist, 152
el-hikmetu'l-hâlîde, 163
elita, 7, 12, 27, 34, 44, 45,
46, 104, 109, 135, 137,
139, 160, 161, 162, 163,
164, 165, 166
emanacioni, 46, 159
enciklopedistët islamikë, 114
erozioni shpirtëror, 57
etika bashkëshortore, 102
etnocentrizmi, 62
Evropa, 13, 125

F

familja, 76, 99, 113
fantastika shkencore, 114
Farâbîu, 161
feja, 17, 59, 74, 76, 81, 98,
155, 156, 157, 164
fenomenet, 13, 155
Fergusson, 85
fetaria, 117
fetë e Ibrahimit, 160
fetë primitive, 156, 159
filantropikët, 83, 108
filozofia e historisë, 138
filozofia e religjionit, 76
filozofia sociale, 117
Financial Times, 152
fjala e Zotit, 62
fjalori teocentrik, 40
folklori klanor-fisnor, 142
formimi pedagogjik, 139
Freyer, Hans, 21, 74, 168
fshati global, 23, 67
Fukuyama, 52, 63

fundamentalizmi islam, 78
fundi i botës, 52, 125
fundi i historisë, 50
fundi i modernizmit, 129
futurologjia, 98

G

Gaarder, Jostein, 37, 44, 169
Gandhi, 59, 163
gazetaria, 19, 20, 50, 102, 105
geist, 47, 123, 163
Gellner, 16, 31
Gëtja, 75
global village, 67
globalizmi, 20, 59, 64, 67, 68
Gobbineau, 63
grupet moshore, 150
grupi etnik, 116
guerrizmi, 96

H

Harvardi, 86
Hegel, 47, 58, 63, 92, 163
Herodoti, 24
hiperkonsumi, 134
Hipokrati, 29
hipoteza, 24, 117
histeria nacionaliste, 152
Hobsbawm, Eric, 141
Homo Balkanicus, 22, 27, 98
homo economicus, 28, 111, 128
homo primigenius, 74
Hoti, Ukshin, 41, 55, 170
huliganizmi, 150
hulumtimi shkencor, 139
humanistët, 108
Huntingtoni, 52, 54, 169

Husref Beu, Gazi, 143

I

ideali, 42, 61, 78, 87, 114, 123, 153
ideologjia jetike, 72
idhulli i shpellës, 108
iluminizmi, 74, 124
imagjinata, 110
imoraliteti, 86
imperializmi, 67
industrializimi, 127
integrizmi islam, 62
inteligjencia, 11, 26, 44, 48, 71, 113, 161, 165
inxhinieria gjenetike, 132
inxhinieria sociale, 93
Islami, 26, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 108, 160, 168
Izetbegović, 143
i Lartmadhëruari, 131

J

Jaspers, K., 26

K

kallëpet ataviste, 116
Kant, 38, 49
kapitali, 46
kapitalizmi, 48
Kastro, 81
kataklizma, 165
Kemal, Yahya, 40
klanizmi, 99
klasa jakëkaltër, 43
Klauzevitz, 41
kodi moralo-etik, 122

koekzistenca, 91
 kohezioni, 17, 126, 151
 kolektiviteti, 93, 101, 120
 kolonialistët evropianë, 131
 kolonializmi, 41, 63, 163, 164
 Koloseu, 151
 kombi, 32, 58, 68, 70, 87
 kombi artificial, 56
 kompanitë shumëkombëshe,
 66
 konkurrenca, 126
 kozmopolitizmi, 63
 krishterimi, 26, 75, 79, 80,
 89, 160
 kriza morale, 129
 kuaziromantizmi, 132
 kujtesa kolektive, 39
 kultura, 17, 33, 46, 57, 76,
 162, 164
 kultura e përgjithshme, 139
 kultura elitiste, 162
 Kur'ani, 128, 169
 Küng, Hans, 63

L

laicizmi, 98, 158
 latinët e vjetër, 140
Lebenswelt, 89
 Leka i Madh, 98
Leviathan, 16, 23
 Levy, Bernard-Henry, 96
 Lewis, Bernard, 108
 Lèger, Hervie, 54
 lidhjet ontologjike, 153
lingua franca, 46
lingua sacra, 161
 linguocentrizmi, 72

logosi, 123, 128
 lufta totale, 54

M

Mahçupjan, Etien, 131
 Marcus, 48
 makiavelizmi, 55
 Malraux, 40
 Marks, 125
 marksizmi, 45
 marrëdhëniet
 ndërqytetërimore, 109
 Marrëveshja Kornizë, 69, 90
masat, 16, 48, 49, 118, 133,
 160
 matricat globale, 64
 mediat, 19, 20, 38, 50, 82,
 85, 97, 101, 102, 103,
 104, 137
 mendësitë ballkanase, 116
 mendimtari i lirë, 47, 48
 mendjet e mëdha, 120
 mesianizmi, 133
 Meshtroviq, Stjepan G., 146
 metafizika, 114, 125, 154
 metodologjia, 43, 135
 migrimet, 109
 Milosz, 38
 misticizmi, 148
 mitologjia, 110
 Morin, 60, 70
 moda, 150
 moderniteti, 22, 23
 modernizmi, 125, 126, 133
modus vivendi (stili jetësor), 150
 monolitizmi modernist, 81

morali, 16, 17, 39, 49, 64,
71, 83, 85, 98, 101, 122,
129, 132, 155
Muhamedi (a.s.), 77
multikulturaliteti, 98, 107
Müller, Max, 154

N

nacionalizmi, 18, 22, 23, 88,
151
nacional-romantizmi, 32
Naim, 85
Napoleoni, 29, 87
Nasr, S.H., 162
ndjenjat kolektive, 154
ndryshimet demokratike, 56
ndryshimi social, 34
New World Order, 51, 63
Newsweek, 41, 67
ngjyrat ideologjike, 116
Niçe, 63

Nj

njerëzshmëria, 122
njeriu bashkëkohor, 129

O

objektiviteti, 103, 136
ontologjia, 114
organizimi bashkësinor, 150
Orienti, 110
Gasset, Ortega, 68, 135,
139, 169
Ovidi, 123
Ozel, Ismet, 40, 140, 169

P

Panta Rei, 33
Papa, 81
paradigma liberaliste (*laissez
faire*), 165
paradigmat, 45, 63, 108, 165
parafytyrimet, 158
paragjykimet, 72, 93
patosi moral, 101
patriotizmi, 152
Pax Americana, 51
pellgjet kulturore, 63
Perandoria Osmane, 61
Perëndia, 148
perëndimi, 23, 36, 108
Perestrojka, 45
përfitimi material, 148
përfytyrimet, 155
përkatësia kombëtare, 36,
57, 84
përplasja e qytetërimeve, 50
perspektivizmi, 68
pikëpamja përfshirëse, 99
Platoni, 33, 161
Plutarku, 24
polis, 61
politika, 17, 20, 28, 33, 97,
99, 117, 160, 165
politika e dehumanizuar, 129
politika ndërkombëtare, 83
politika segregacioniste, 117
Popper, Karl, 83
popular culture, 146
populli i zgjedhur, 62, 63,
72, 89
Potter, Harry, 102, 111, 114
pragmatizmi, 85

priftëria bashkëkohore, 102
prishja e demokracisë, 142
profania, 154
projeksioni, 159
Prometeu, 126
promiskuiteti, 86
Protagora, 126
psikologjia sociale, 74
psikoza e luftës, 97
purgatori verbal, 138

Q

qytetet prizë, 98

R

Garaudy, 48
Guenon, 48
racionali(i)zmi, 148
radikalizmi, 81, 93
raison d'être, 32, 153
realiteti apokaliptik, 53
reflectia Dei, 127
Renani, 125
Revolucioni Francez, 23
revolucioni japonez, 48
rex publica, 84
rilindja, 160
ritet, 157
rizgjimi islam, 79
romakët, 82
romani botëror, 108
Rowling, J.K., 110
Rousseau, 38
Rumi, Mevlana Xh., 25

S

Said, Edward, 107

sanatana dharma, 163
Sarajeva, 141
Schmidt, Karl, 22
Selbstverständnis, 89
semantika, 124
Sezen, Y., 61
simbolizmi politik, 107
sinkretizmi, 48, 114
sjelljet anomike, 151
snobizmi, 164
Snyder, John R., 124
socializmi, 45
socializmi real, 32, 45, 96
sociologjia, 10, 74, 102, 117
sociologjia e sportit, 146
sophia perrenis, 163
soteriologjia, 127
stabiliteti, 19, 117

Sh

Shapiro, Jim, 132
shekullarizimi, 127
sheriati, 78
Sheriati, Ali, 48
shkatërrimtaria, 128
shkenca, 10, 12, 14, 20, 23,
24, 31, 44, 45, 46, 49, 50,
51, 54, 57, 59, 61, 74, 75,
76, 78, 79, 80, 81, 82, 85,
100, 107, 108, 114, 117,
122, 127, 132, 135, 136,
137, 138, 139, 140, 150,
152, 162
shkencëtarët, 150
shoqëria e dijes, 64
shoqëria e teknologjisë, 59,
100

shoqëria kibernetike, 64
shoqëria moderne, 162
shoqëria tejemocionale, 146
shpirti krijues, 139
Shqipëria, 71, 148
shqiptarët, 10, 13, 26, 42,
55, 57, 58, 70, 100, 116,
117, 120, 136, 137, 139,
152, 165
shteti nebulozë, 89
shteti njënacional, 89

T

taksonomia kulturore, 48
tërësia e përfytyrimeve, 154
tërësitë civilizuese, 108
tiparet kulturore, 156
tjetërsimi, 166
Toffler, Heidi, 64
toleranca, 27, 82, 93
totalitarizmi, 142
tradicionalizmi, 126
traditat, 57, 71, 125, 126,
162, 164
tranzicioni, 9, 11, 15, 47, 49,
88, 91, 115, 116, 168
tregu global, 150
tregu global i diturisë, 140

Th

theory of conflict, 126
think tank, 109

U

UEJL, 137

ultranacionalistët, 88, 152
ummetizmi, 62
universi akademik, 138
Universiteti i Tetovës, 137
urtësia parake, 95
urtësia solomoniane, 121

V

vallja e qytetërimeve, 107
vetëkontrolli mediatik, 105
vetëperceptimi, 39, 89
vetëshkatërrimi, 116
vetëvrasja kombëtare, 165
vlerat morale, 15
Volkgeist, 58
Vox Dei, 40
Vox Populi, 40

W

Watt, W.M., 92
Wallerstein, 51, 54, 168
Weber, Max, 48
Welles, Orson, 53
weltanschauung, 17, 46
Wittgenstein, 70

Z

zakonet, 162
Zoti, 17, 29, 71, 77, 78, 126,
156, 159
zvetënimi, 60

Zh

zhdanovistët, 164



Ali Pajaziti

LOGOS-A ■ ESE-SOCIOLOGJIKE



Copyrighted material